



Udhëzues për vëzhgimin dhe promovimin e pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuar në zgjedhje

Udhëzues

për vëzhgimin dhe promovimin
e pjesëmarrjes së personave me
aftësi të kufizuar në zgjedhje



Botuar nga Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike
dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR)

ul. Miodowa 10
00-251 Varshavë
Poloni
www.osce.org/odihr

© OSCE/ODIHR 2017

ISBN 978-83-66089-47-1

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Përmbajtja e këtij botimi mund të përdoret dhe të kopjohet lirisht për qëllime edukative dhe qëllime të tjera jotregtare, me kusht që një riprodhim i tillë të shoqërohet me një shënim ku të thuhet se burimi është ODIHR-i.

Ky Udhëzues është botuar fillimisht në vitin 2014 me titullin *Handbook on Observing and promoting the Electoral Participation of Persons with Disabilities* nga Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR). Ky variant është përkthim. Në rast se në tekst hasen mospërputhje, jeni të lutur t'i referoheni botimit në gjuhën angleze si varianti zyrtar dhe përfundimtar.

Përkthimi i këtij publikimi është financuar nga Projekti i Mbështetjes së Zgjedhjeve në Ballkanin Perëndimor, financuar nga Bashkimi Evropian dhe Agjencia Austriake për Zhvillim.

Fotografitë: Kapaku: OSBE, Hyrja: OSBE/VanjaSkoric, Kapitulli 1: OSBE/Agnieszka Rembowska, Kapitulli 2: OSBE, Kapitulli 3: OSBE, Kapitulli 4: OSCE/Thomas Rymer

Formulimi grafik nga Nona Reuter

Shtypur në Poloni

Përmbajtja

Lista e shkurtesave	5
Parathenia	7
Hyrje	9
A. Rreth këtij Udhëzuesi	9
B. Aftësia e kufizuar vënë në kontekst	10
C. Rëndësia e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave zgjedhore të personave me aftësi të kufizuar	11
D. Si të përdoret ky Udhëzues	11
E. Parimet kryesore për vëzhguesit e ODIHR-it	12
Kapitulli 1: Angazhimet e osbe-së dhe detyrimet dhe standardet e tjera ndërkombëtare	15
A. Angazhimet e OSBE-së	16
B. Instrumentet universale	17
C. Instrumente të tjera rajonale	24
Kapitulli 2: Pengesat për pjesëmarrjen	29
Kapitulli 3: Cikli zgjedhor dhe pjesëmarrja e personave me aftësi të Kufizuar	32
A. Periudha parazgjedhore	33
B. Dita e zgjedhjeve	48
C. Periudha pas ditës së zgjedhjeve	53
Kapitulli 4: Puna e vëzhguesve dhe misioneve të OSBE/ODIHR-it	57
A. Misionet për vlerësimin e nevojave (MVN-të)	58
B. Aktivitetet që lidhen me zgjedhjet	58
C. Vëzhguesit afatgjatë (VAGJ-të)	59
D. Vëzhguesit afatshkurtër (VASH-të) dhe vëzhgimi në ditën e zgjedhjeve	61
E. Raportimi publik dhe rekomandimet	62
F. Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve	63

Shtojca A – Pyetjet për secilin anëtar të ekipit bazë	65
Analisti ligjor	65
Analisti i zgjedhjeve	67
Analisti politik	70
Analisti i medias	71
Shtojca B – Angazhimet e osbe-së dhe detyrimet dhe standardet e tjera ndërkombëtare	72
Dokumenti i Moskës i OSBE-së, 1991	72
Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDKP), 1966	72
Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (KDPAK), 2008	73
Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm	78
Deklarata Interpretuese e Rishikuar e Komisionit të Venecias, 2011	78
Shtojca C – Burime të dobishme	81
1. Dokumente ligjore dhe të politikave	81
2. Hulumtime	82
3. Faqe dhe materiale burimore	83
4. Organizatat përkatëse	83
Shtojca D – Përkufizime të termave kyç	85

Lista e shkurtesave

MAV	Mekanizëm alternativ votimi
KDPAK	Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar
OSHC	Organizatë e shoqërisë civile
ZKiM	Zëvendëskryetar i Misionit
OPAK	Organizatë e Personave me Aftësi të Kufizuar
MVIZ	Misioni për vlerësimin e zgjedhjeve
KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
GJEDNJ	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
OAZ	Organ i administrimit të zgjedhjeve
MVZ	Mision për vëzhgimin e zgjedhjeve
BE	Bashkimi Evropian
ADTH	Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore
PNDCP	Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike
VAGJ	Vëzhgues afatgjatë
MVN	Mision për vlerësimin të nevojave
OSHA	Organizata e Shteteve Amerikane
ODIHR	Zyra për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut
ZKLDNJ	Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut (OKB)
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
APKE	Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës
QV	Qendër votimi
OZHQ	Objektivat për zhvillim të qëndrueshëm
VASH	Vëzhgues afatshkurtër
DUDNJ	Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
UAMI	Udhëzues për aksesueshmërinë e materialeve në internet
W3C	WorldWideWeb Consortium (W3C)

PARATHËNIE


E drejta dhe mundësia që të gjithë qytetarët të marrin pjesë në zgjedhje përbën një komponent thelbësor të angazhimeve të OSBE-së, që lidhen me zgjedhjet. Sipas OKB-së, vlerësohet se mbi një miliard njerëz, rreth 15 për qind e të gjithë popullsisë së botës, jetojnë me një aftësi të kufizuar. Bazuar në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut të vitit 1948 dhe në Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike të vitit 1966, Dokumenti i Moskës i vitit 1991 angazhon shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së që “të garantojnë mbrojtjen e të drejtave të njeriut të personave me aftësi të kufizuar”, përfshirë edhe të drejtat politike dhe ato të pjesëmarrjes në zgjedhje. Me detyrimet e shprehura qartë në Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar të vitit 2006, vitet e fundit është shtuar vëmendja për këtë çështje.

Metodologjia e ndjekur prej Zyrës së OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) njihet gjerësisht për qasjen e saj sistematike dhe gjithëpërfshirëse. Ajo ka shërbyer dhe vazhdon të shërbejë si orientim për organizatat e tjera ndërkombëtare dhe qytetare për vëzhgimin e zgjedhjeve. Me mandatin e dhënë nga shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së, ODIHR-i vazhdimisht përpiqet për të përmirësuar metodologjinë e vet, duke hartuar udhëzues për aspekte të veçanta të zgjedhjeve.

Edhe pse metodologjia e përgjithshme e ODIHR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve përfshin prej shumë kohësh tashmë pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuar, ky Udhëzues synon të vendosë një qasje më sistematike dhe më gjithëpërfshirëse ndaj kësaj çështjeje të rëndësishme. Udhëzuesi ofron informacion dhe një kornizë për të ndihmuar vëzhguesit e ODIHR-it në vlerësimin e pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuar, në kuadër të vëzhgimit tërësor të çdo procesi zgjedhor. Vëzhguesit zgjedhorë luajnë rol të rëndësishëm në monitorimin e pengesave ligjore, strukturore dhe praktike që mund të rezultojnë në përjashtim, si dhe në vlerësimin e shkallës së pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuar në zgjedhje si zgjedhës, kandidatë, zyrtarë zgjedhorë dhe në role të tjera.

Shpresojmë që ky Udhëzues të jetë një mjet i dobishëm edhe për një publik më të gjerë, të interesuar në këtë çështje, përfshirë edhe organet e administrimit të zgjedhjeve, partitë politike, organizatat e shoqërisë civile dhe organizatat ndërkombëtare.

Dëshirojmë të falënderojmë ekspertët dhe organizatat e shumta që kanë dhënë kontribut të çmuar dhe opinione vlerësuese gjatë hartimit të këtij Udhëzuesi, sidomos organizatat e personave me aftësi të kufizuar dhe homologët tanë që kanë miratuar Deklaratën e Parimeve për Vëzhgimin Ndërkombëtar të Zgjedhjeve. Ky Udhëzues u realizua vetëm falë mbështetjes dhe bashkëpunimit të tyre.



*Ingibjörg Sólrún Gísladóttir
Drejtore e ODIHR-it*

Hyrje

A. Rreth këtij Udhëzuesi

Ndonëse pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuar ka kohë që është bërë pjesë e metodologjisë së përgjithshme të ODIHR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve, ky Udhëzues ka për qëllim të krijojë një qasje më sistematike dhe më gjithëpërfshirëse ndaj kësaj çështjeje të rëndësishme. Udhëzuesi ofron informacion dhe një kornizë për të ndihmuar vëzhguesit e ODIHR-it në vlerësimin e pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuar, si pjesë e vëzhgimit tërësor të procesit zgjedhor. Udhëzuesi mund të jetë i dobishëm edhe për një publik më të gjerë të interesuar në këtë çështje, duke përfshirë organet e administrimit të zgjedhjeve, partitë politike, organizatat e shoqërisë civile (OSHC-të) dhe organizatat ndërkombëtare. Ai është hartuar në bazë të kontributeve jashtëbuxhetore të shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së, në kuadër të përpjekjeve të vazhdueshme të ODIHR-it për përmirësimin e metodologjisë së vet për vëzhgimin e zgjedhjeve dhe rritjen e mëtejshme të profesionalizmit të personave që marrin pjesë në aktivitetet vëzhguese të ODIHR-it.

Udhëzuesi gjen zbatim për të gjitha llojet e aktiviteteve të ODIHR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve (misionet për vëzhgimin e zgjedhjeve, misionet e kufizuar për vëzhgimin e zgjedhjeve, misionet për vlerësimin e zgjedhjeve dhe ekipet e ekspertëve për zgjedhjet).¹

¹ Ky Udhëzues plotëson dhe duhet të lexohet së bashku me Udhëzuesin e ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve dhe botime të tjera të ODIHR-it. Të gjitha gjenden në:
<http://www.osce.org/odihr/elections/119893>

ODIHR-i e përfshin pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuar në të gjitha aktivitetet e veta për vëzhgimin e zgjedhjeve dhe synim i këtij Udhëzuesi është që të përdoret nga të gjithë anëtarët e misioneve, përfshirë edhe analistët e ekipeve bazë, vëzhguesit afatgjatë (VAGJ) dhe vëzhguesit afatshkurtër (VASH).

B. Aftësia e kufizuar vënë në kontekst

Sfidat e garantimit të pjesëmarrjes efektive të personave me aftësi të kufizuar janë shumë të përhapura dhe ndërjegjësimi rreth tyre është në rritje. Sipas raporteve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe Bankës Botërore, rreth një miliard njerëz, ose rreth 15 për qind e popullsisë së botës, jetojnë me aftësi të kufizuar. Po kështu, raporti i Këshillit Ekonomik dhe Social i Kombeve të Bashkuara (OKB) për përfshirjen e aftësisë së kufizuar në axhendën e zhvillimit thekson se tendenca globale është që edhe më shumë njerëz të preken nga aftësitë e kufizuar, krahas tendencës së plakjes së popullsisë dhe shtimit të sëmundjeve kronike.

Këto sfida bëhen edhe më të mprehta nga kompleksiteti dhe gama e aftësive të kufizuar që ekziston. Konventa e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (KDPK) thotë se: “Personat me aftësi të kufizuar përfshijnë individët me dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjata të cilat, në ndërveprim me pengesa të ndryshme, mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri njësoj si pjesa tjetër e saj”.² Këto pengesa përfshijnë pengesat fizike, kufizimet ligjore, modifikimet praktike dhe qëndrimet e shoqërisë që, de facto, i përjashtojnë ata ose e pakësojnë pjesëmarrjen e tyre.

UN Enable, pika e kontaktit brenda sistemit të OKB-së për çështjet që lidhen me aftësitë e kufizuar, shprehet se ky përkufizim nuk është shterues, duke vënë në dukje se: “kjo listë bazë e personave që mund të kërkojnë mbrojtje në bazë të Konventës nuk përfshin të gjitha kategoritë e aftësive të kufizuar që janë objekt i saj, dhe as nuk synon të cenojë apo të pengojë përkufizimin më të gjerë të aftësive të kufizuar në kuadër të legjislacionit të brendshëm (p.sh.: personat me aftësi të kufizuar afatshkurtra)”.³ Edhe konteksti është i rëndësishëm. UN Enable konstaton edhe se: “një person me aftësi të kufizuar mund të konsiderohet si person me aftësi të kufizuar në një shoqëri apo në një kontekst, por jo në një tjetër, në varësi të rolit që personi supozohet të marrë në komunitetin e tij. Perceptimi dhe realiteti i aftësisë së kufizuar varen edhe nga teknologjitë, ndihma dhe shërbimet në dispozicion, si dhe nga konsideratat kulturore”.

Duhet pranuar gjithashtu fakti që personat me aftësi të kufizuar nuk janë një grup homogjen. Personat me lloje të ndryshme aftësish të kufizuar mund të kenë nevojë për forma të ndryshme ndihme dhe mbështetjeje për të gëzuar të drejtat e tyre njësoj si të tjerët. Për shembull, për personat me aftësi të kufizuar fizike është shumë e rëndësishme aksesueshmëria në mjediset dhe godinat publike; ndërsa për personat me aftësi të kufizuar intelektuale dhe shqisore, mundësia për të marrë dhe për të dhënë informacion në formate të aksesueshme është jetike. Personat me forma të shumfishta të aftësisë të kufizuar përballen edhe me më shumë sfida, të cilat shpesh janë unike. Të kuptuarit e larmisë së komunitetit të aftësisë së kufizuar përbën hapin e parë drejt garancisë që masat për aksesueshmërinë të ideuara për një shoqëri më përfshirëse u përgjigjen nevojave reale.

2 Gjendet në: <http://www.un.org/disabilities/documents/convention/convoptprot-e.pdf>.

3 Gjendet në: <http://www.un.org/esa/socdev/enable/faqs.htm>.

C. Rëndësia e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave zgjedhore të personave me aftësi të kufizuar

E drejta dhe mundësia e të gjithë qytetarëve për të marrë pjesë në zgjedhje përbën një komponent thelbësor të angazhimeve të OSBE-së. Sidoqoftë, ndërgjegjësimi rreth mangësive në përbushjen e të drejtave zgjedhore të personave me aftësi të kufizuar është rritur vitet e fundit, duke përfshirë edhe mënyrat se si këto mangësi ndikojnë në marginalizimin dhe përjashtimin social. Po kështu, kuadri ligjor ndërkombëtar ka pësuar ndryshime rrënjësore. KDPAK-ja hyri në fuqi në vitin 2008 dhe, për herë të parë, përfshiu detyrime të detajuara në lidhje me të drejtat politike dhe zgjedhore. Për më tepër, miratimi i KDPAK-së shënoi kalimin nga qasja bamirëse/mjekësore në qasjen bazuar në të drejtat e njeriut, ku theksohen parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit. Në momentin e publikimit, KDPAK-ja ishte ratifikuar/pranuar nga mbi 170 vende, përfshirë 54 nga 57 shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së. Ratifikimi nga këto 54 vende mbështetet dhe konsolidon më tej angazhimin e ndërmarrë nga të gjitha shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së në Takimin e Moskës në vitin 1991 “për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të njeriut të personave me aftësi të kufizuar”.

Megjithatë, të dhënat ekzistuese tregojnë se pjesëmarrja në zgjedhje e personave me aftësi të kufizuar si zgjedhës, kandidatë dhe zyrtarë zgjedhorë mbetet e ulët në mbarë rajonin e OSBE-së. Personat me aftësi të kufizuar hasin në një sërë pengesash në pjesëmarrjen e tyre, si kufizimet ligjore, aksesueshmëria e pamjaftueshme në infrastrukturë dhe informacion, mungesa e ndërgjegjësimit për nevojat specifike të personave me aftësi të kufizuar, mungesa e pajisjeve ndihmëse, si edhe stereotipat negative dhe stigma në shoqëri. Për pasojë, personat me aftësi të kufizuar shpesh përballen me rrezikun e marginalizimit në jetën publike dhe mospërfaqësimit sa duhet në postet e zgjedhura dhe në proceset e vendimmarrjes. Pavarësisht evoluimit të së drejtës ndërkombëtare, vazhdon të ekzistojë një hendek mes situatës reale të personave me aftësi të kufizuar dhe zbatimit të parimeve të mishëruara në KDPAK.

Vëzhguesit e zgjedhjeve luajnë një rol të rëndësishëm në monitorimin e pengesave ligjore, strukturore dhe praktike që pengojnë përfshirjen, dhe në vlerësimin e shkallës së pjesëmarrjes aktive të personave me aftësi të kufizuar në zgjedhje si zgjedhës, kandidatë, zyrtarë zgjedhorë dhe në role të tjera. Vëzhguesit kanë përgjegjësinë të evidentojnë se si përbushen marrëveshjet politike dhe traktatet e të drejtave të njeriut dhe ku ka mangësi sa i takon përputhshmërisë, si dhe të rekomandojnë çfarë përmirësimesh të rëndësishme mund të bëhen.

D. Si të përdoret ky Udhëzues

Kapitulli 1 i Udhëzuesit ofron një përmbledhje të angazhimeve të OSBE-së dhe standardeve e detyrimeve të tjera ndërkombëtare, duke u fokusuar te Konventa e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (KDPAK). **Kapitulli 2** ofron një pasqyrë të pengesave për pjesëmarrjen me të cilat ballafaqohen personat me aftësi të kufizuar, dhe të ndërhyrjeve të mundshme për zgjidhjen e këtyre sfidave.

Në **Kapitullin 3** shtjellohen disa këshilla dhe çështje praktike për të nënvizuar pikat kyçe të monitorimit për vëzhguesit e zgjedhjeve. Kapitulli ndahet sipas fazave të një cikli zgjedhor, ku seksionet përqendrohen në periudhën parazgjedhore, ditën e zgjedhjeve dhe në periudhën paszgjedhore. Seksioni për periudhën parazgjedhore trajton:

- Legjislacionin zgjedhor: përfshirë edhe situatën lidhur me ratifikimin e dispozitave të KDPAK-së për zotësinë juridike, kërkesat lidhur me aksesueshmërinë, detyrimet për t'u konsultuar me organizatat e personave me aftësi të kufizuar (OPAK) dhe mbledhjen e të dhënave të ndara sipas aftësive të kufizuar;
- Administrimin e zgjedhjeve: përfshirë edhe trajnimin e komisionerëve të qendrave të votimit, mekanizmat ndihmës të krijuar për të ndihmuar personat me aftësi të kufizuar për të votuar dhe edukimin e zgjedhësve;
- Fushatën zgjedhore: përpjekjet e partive politike për të arritur te personat me aftësi të kufizuar, aksesueshmërinë e ambienteve ku bëhen fushatat, dhe aksesin e barabartë në media.

Seksioni për ditën e zgjedhjeve fokusohet tek aksesueshmëria e qendrave të votimit dhe fletët e votimit për personat me aftësi të kufizuar të ndryshme, ndihma nga një person që ata vetë zgjedhin, dhe mekanizmat alternativë të votimit.

Seksioni për periudhën paszgjedhore trajton çështje si shpallja dhe vënia në dispozicion e rezultateve të zgjedhjeve në formate të aksesueshme, aksesin ndaj mekanizmave të ankimit dhe apelimit dhe roli i vëzhgimit vendor.

Së fundi, **Kapitulli 4** ndalet te metodologjia e ODIHR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve, me fokus të veçantë te respektimi dhe promovimi i pjesëmarrjes në zgjedhje të personave me aftësi të kufizuar gjatë gjithë ciklit zgjedhor. Në këtë kapitull trajtohet misioni për vlerësimin e nevojave para zgjedhjeve, i cili përcakton nëse ODIHR-i do të zhvillojë një aktivitet për vëzhgimin e zgjedhjeve, dhe, nëse po, me çfarë mandati dhe çfarë formati; rolin e analistëve dhe vëzhguesve të ndryshëm pas mbërritjes; si dhe aktivitetet paszgjedhore për mbështetjen e vendeve në ndjekjen e zbatimit të vlerësimeve dhe rekomandimeve të ODIHR-it për zgjedhjet.

Shtojcat përmbajnë pjesë nga instrumentet kryesore ndërkombëtare dhe rajonale në lidhje me të drejtat e personave me aftësi të kufizuar, një përmbledhje të burimeve të dobishme, përkufizime të termave kryesore dhe listën e shkurtimeve.

E. Parimet kryesore për vëzhguesit e ODIHR-it

Kur vlerëson pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuar në zgjedhje, ODIHR-i i kushton vëmendje të veçantë disa parimeve kryesore që renditen më poshtë dhe shtjellohen në kapitujt në vijim:

- Pjesëmarrja e plotë dhe efektive në zgjedhje e personave me aftësi të kufizuar është një komponent thelbësor i angazhimeve të OSBE-së dhe standardeve

ndërkombëtare, që pasqyron të drejtën universale dhe të barabartë të votës. **Barazia dhe mosdiskriminimi** janë parime themelore për pjesëmarrjen në zgjedhje dhe në politikë të personave me aftësi të kufizuara.

- **Konventa e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK) hyri në fuqi në vitin 2008 dhe zbatohet pothuajse në nivel universal.** Konventa e ndryshoi thellësisht qasjen bamirëse/mjekësore ndaj aftësisë së kufizuar në një model bazuar tek të drejtat e njeriut. Tani theksi vihet mbi mundësimin e ushtrimit të të drejtave dhe mbështetjen për gjithëpërfshirjen dhe pjesëmarrjen.
- Personat me aftësi të kufizuar nuk duhet **të konsiderohen si një grup homogjen**. Personat me aftësi të kufizuar të ndryshme kanë nevoja të ndryshme dhe mund të kenë nevojë për forma të ndryshme ndihme dhe mbështetjeje.
- **OPAK-të duhen konsultuar ngushtësisht dhe duhen përfshirë aktivisht** në hartimin dhe zbatimin e legjislacionit dhe të politikave.
- **Është e papranueshme të hiqet dhe/ose të kufizohet e drejta për të votuar apo kandiduar për shkak të** çfarëdo aftësie të kufizuar, përfshirë edhe aftësitë e kufizuar intelektuale apo psikosociale.
- **Vendimmarrje e asistuar** do të thotë që një person mund të marrë ndihmën e nevojshme për të marrë vendime të caktuara në jetë, përfshirë edhe ushtrimin e të drejtës për të votuar. Këto mekanizma duhet të zëvendësojnë mekanizmat e vendimmarrjes me zëvendësim, duke iu dhënë personave me aftësi të kufizuar mbështetjen e nevojshme për ushtrimin e të drejtave të tyre zgjedhore dhe politike pa asnjë kufizim të panevojshëm.
- **Informacioni kryesor për zgjedhjet duhet të vihet në dispozicion në formate të shumëllojshme dhe të aksesueshme**, të cilat mund të përfshijnë versionet në alfabetin Braille, me shkronja të zmadhuara, në audio, lehtësisht të kuptueshme, dhe në gjuhën e shenjave. Këtu përfshihen informacionet rreth mënyrës se si mund të merret pjesë në zgjedhje, si paraqiten ankimet dhe apelimet, si dhe rreth rezultateve dhe përditësimeve nga administrata zgjedhore.
- **Fushata zgjedhore duhet të jetë e aksesueshme** për personat me të gjitha llojet e aftësive të kufizuara. Duhet të bëhen përpjekje që aktivitetet e fushatës zgjedhore dhe materialet zgjedhore të jenë të disponueshme për të gjithë. **Media publike duhet të sigurojë akses të barabartë** ndaj informacionit dhe mundësi të barabarta për dhënie e mesazheve për personat me aftësi të kufizuara.
- **Të gjitha proceset zgjedhore duhet të bëhen të aksesueshme** për personat me aftësi të kufizuara. Kjo kërkon **“projektim universal”**, me anë të të cilit mjediset dhe shërbimet bëhen të aksesueshme në mënyrë proaktive për të gjithë njerëzit, sa më shumë që të jetë e mundur, pa qenë nevoja për përshtatje. Gjithashtu, kjo kërkon që të bëhen “përshtatje të arsyeshme” për nevoja të veçanta, që nuk trajtohen nga projektimi universal, për t’u siguruar personave me aftësi të kufizuar mundësinë që t’i ushtrojnë të drejtat e tyre njësoj me të tjerët.
- **Personat me aftësi të kufizuar duhet të kenë mundësinë ta hedhin votën e tyre pa patur ndihmë**, ose me ndihmën e personave të zgjedhur

prej tyre, **në fshehtësi dhe në qendrat e zakonshme të votimit**. Vetëm nëse kjo nuk është e mundur, duhet të shihet mundësia e metodave alternative të votimit, si votimi i lëvizshëm ose votimi me postë. Metodatat alternative nuk duhet të promovohen si zëvendësuese të masave për përmirësimin e aksesueshmërisë në qendrat e votimit, dhe nëse përdoren, duhet të parashikohen garancitë e nevojshme.

- **Në ditën e zgjedhjeve, vëzhguesit duhet të shqyrtojnë nëse informacioni është i disponueshëm në formate të shumëllojshme, nëse qendrat e votimit janë fizikisht të aksesueshme, nëse disponohen mjete ndihmëse dhe nëse zgjedhësi mund të zgjedhë vetë se kush do ta ndihmojë.** Akses fizik do të thotë që zgjedhësit me aftësi të kufizuara të mund të hyjnë në qendrën e votimit pa ndihmën e askujt, të mund të manovrojnë lehtësisht në të gjithë qendrën e votimit dhe të mund të shënojnë në fletën e votimit dhe të votojnë në fshehtësi dhe me dinjitet. Mjetet ndihmëse për votim mund të përfshijnë shabllonet me relief (të printuara me termoform), shabllonet në alfabetin Braille dhe lupat.
- **Të gjithë anëtarët e misionëve të ODIHR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve vlerësojnë përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara,** përfshirë edhe përmes analizës së legjislacionit dhe praktikës përpara, gjatë dhe pas ditës së zgjedhjeve.
- **ODIHR-i nxit pjesëmarrjen efektive të personave me aftësi të kufizuara përmes vlerësimeve dhe rekomandimeve të tij për zgjedhjet,** si dhe me përfshirjen aktive të OPAK-ve në aktivitetet e tij paszgjedhore për mbështetjen e ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve.



Kapitulli 1: Angazhimet e OSBE-së dhe detyrimet e standardet e tjera ndërkombëtare

Ky kapitull trajton qëndrimet e ndryshme të organizmave të ndryshëm ndërkombëtarë gjatë viteve, në lidhje me përfshirjen politike të personave me aftësi të kufizuara, si dhe shqyrton kuadrin aktual. Fillimisht kapitulli ndalet tek angazhimet e OSBE-së, pastaj hedh një vështrim mbi instrumentet universale të OKB-së dhe më pas analizon instrumentet e tjera rajonale. KDKPAK-ja, e cila ka zbatueshmëri pothuajse universale dhe është instrumenti më i shtjelluar dhe me standardet më të zhvilluara lidhur me pjesëmarrjen politike të personave me aftësi të kufizuara, përshkruhet hollësisht në këtë kapitull dhe gjen referim në të gjithë seksionet e mëposhtme të këtij Udhëzuesi.

Është e rëndësishme të theksohet se një sërë dokumentesh të OSBE-së promovojnë respektimin nga shtetet pjesëmarrëse të instrumenteve universale dhe të disa instrumenteve rajonale për të drejtat e njeriut. Për shembull, Akti Final i Helsinkit i vitit 1975 i angazhon shtetet “të veprojnë në përputhje me Deklaratën Universale e të Drejtave të Njeriut” dhe “të përmbushin detyrimet e tyre të parashikuara në deklaratat dhe marrëveshjet ndërkombëtare në këtë fushë, përfshirë, ndër të tjera, edhe Konventat Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, që ata kanë detyrimin t’i zbatojnë”. Dokumenti i Madridit i vitit 1983 u kërkon

qartë “shteteve pjesëmarrëse, që nuk i kanë ratifikuar këto konventa, të shohin mundësinë e aderimit në to”. Dokumente të mëvonshme të OSBE-së ritheksojnë rëndësinë e aderimit në traktatet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, protokollet përkatëse fakultative dhe në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut të vitit 1950 (KEDNJ).

A. Angazhimet e OSBE-së

Angazhimet e OSBE-së përcaktojnë se: “demokracia pluraliste dhe sundimi i ligjit janë thelbësore për të garantuar respektimin e të gjitha të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore...”⁴ Ato theksojnë se: “demokracia është garancia më e mirë për lirinë e shprehjes, tolerancën e të gjitha grupeve të shoqërisë dhe barazinë e mundësive për çdo person”.⁵

Themeli i angazhimeve specifike për zgjedhjet demokratike është Dokumenti i Kopenhagenit i OSBE-së i vitit 1990, i cili ngarkon të gjitha shtetet pjesëmarrëse me detyrimin që “të garantojnë të drejtën universale dhe të barabartë të votës për qytetarët në moshë madhore” (paragrafi 7.3) dhe “të respektojnë të drejtën e qytetarëve për t’u zgjedhur në funksione politike ose publike, individualisht ose si përfaqësues të partive apo organizatave politike, pa diskriminim” (paragrafi 7.5). Theksi që vihet tek të gjithë qytetarët dhe mosdiskriminimi është shumë i rëndësishëm pasi përfshin edhe personat me aftësi të kufizuara. Mbi të gjitha, Dokumenti shpall se: “të gjithë njerëzit janë të barabartë përpara ligjit dhe gëzojnë të drejtën e mbrojtjes së barabartë prej ligjit, pa asnjë lloj diskriminimi. Në këtë kontekst, ligji ndalon çdo diskriminim dhe u garanton të gjithë njerëzve mbrojtje të barabartë dhe efektive ndaj diskriminimit për çfarëdolloj shkak” (paragrafi 5.9). Më tej, Dokumenti nënvizon se: “Shtetet pjesëmarrëse duhet të garantojnë që ushtrimi i të gjitha të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, të shprehura më lart, të mos jetë objekt i asnjë kufizimi, përveç atyre që parashikohen me ligj dhe që janë në përputhje me detyrimet e tyre në bazë të së drejtës ndërkombëtare, veçanërisht Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, dhe me angazhimet ndërkombëtare... Çdo kufizim i të drejtave dhe lirive në një shoqëri demokratike, duhet të lidhet me një prej objektivave të legjislacionit në fuqi dhe të jetë rreptësisht në përpjesëtim me qëllimin e atij ligji” (paragrafi 24).

Një vit më pas, në vitin 1991, shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së sanksionuan angazhime të shprehura qartë në lidhje me aftësinë e kufizuar. Në Moskë, shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së u angazhuan që “të garantojnë mbrojtjen e të drejtave të njeriut të personave me aftësi të kufizuara” dhe mbi të gjitha, “të marrin masa për t’u garantuar mundësi të barabarta këtyre personave, që ata të marrin pjesë plotësisht në jetën e shoqërisë së tyre”. Përveç kësaj, ato u angazhuan që “të nxisin pjesëmarrjen e duhur të këtyre personave në vendimmarrje në fushat që lidhen me ta”, ku përfshihen ligjet, aktet normative dhe politikat që lidhen me zgjedhjet, si edhe “të nxisin kushte të favorshme për aksesin e personave me aftësi të kufizuara në godinat dhe ndaj shërbimeve publike, strehimit, transportit dhe aktiviteteve kulturore dhe argëtuese”, ku përfshihet aksesin në qendrat e votimit, në ambientet ku zhvillohen fushatat dhe në mjedise të tjera në kuadrin e zgjedhjeve.

4 Dokumenti i Kopenhagenit, 1990. Gjetet në: <http://www.osce.org/odihr/elections/14304?download=true>.

5 Karta e Parisit për një Evropë të Re, 1990. Gjetet në: <http://www.osce.org/mc/39516?download=true>.

Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së u angazhuan qartazi që të ndjekin zbatimin e rekomandimeve të ODIHR-it për zgjedhjet, rëndësia e të cilave u theksua prej tyre në Samitin e Stambollit të vitit 1991. ODIHR-i siguron që të përfshijë në vlerësimet e veta për proceset zgjedhore dhe rekomandimet vijuese problematikat që lidhen me pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuar në zgjedhje. Gjithashtu, ODIHR-i bën përpjekje për të garantuar që aktivitetet pasuese të marrin në konsideratë të drejtën e tyre zgjedhore.

B. Instrumentet universale

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike i vitit 1966 (PNDCP) parashikon në nenin 25 të drejtën e pjesëmarrjes në zgjedhje “pa kufizime të paarsyeshme”. Neni 2 kërkon që çdo shtet “të respektojë dhe t’u sigurojë të gjithë njerëzve që ndodhen në territorin e tij dhe që varen nga juridiksioni i tij të drejtat e njohura në këtë Pakt, pa kurrfarë dallimi të bazuar në racë, ngjyrë, gjini, gjuhë, fe, opinion politik ose çdo opinion tjetër, origjinë kombëtare apo shoqërore, pasuri, lindje ose çdo gjendje tjetër”. Edhe pse aftësia e kufizuar nuk përmendet shprehimisht, është e arsyeshme të supozohet se përfshihet në togfjalëshin “gjendje tjetër”, sidomos bazuar në KDPAK-në, që u miratua më vonë.

Tridhjetë vjet më pas, në vitin 1996, organi i PNDCP-së, Komiteti për të Drejtat e Njeriut, nxori Komentin e Përgjithshëm 25 i cili përmbante shpjegimin unifikues të nenit 25. Në të thuhet se: “Ndihma që u jepet personave me aftësi të kufizuar, të verbër apo analfabetë, duhet të jetë e pavarur”. Gjithashtu, Komenti shprehet se: “Është e paarsyeshme të vihen kufizime ndaj të drejtës së votës mbi bazën e aftësisë së kufizuar fizike”. Megjithatë, sa i përket aftësisë së kufizuar mendore, ai nënvizon se: “... aftësia e kufizuar mendore e konstatuar mund të jetë shkak për mohimin e të drejtës së votës së personit apo i së drejtës për t’u zgjedhur në detyrë”.⁶ Ky kufizim për shkak të aftësisë së kufizuar mendore është cilësuar që atëherë, në kuadër të Konventës, si një formë diskriminimi.

Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (KDPAK)

KDPAK-ja është një akt ndërkombëtar novator, që përforcon të drejtat e njeriut të personave me aftësi të kufizuar dhe përgjegjësitë përkatëse të shtetit, duke iu referuar shprehimisht pjesëmarrjes politike. Konventa, edhe pse nuk u shton të drejta të reja personave me aftësi të kufizuar, solli një ndryshim themelor në mënyrën si përkufizohet aftësia e kufizuar dhe vënien e theksit mbi barazinë dhe pjesëmarrjen e tyre të plotë në shoqëri. Sipas Konventës, mohimi i formave të ndryshme të përshtatjes së arsyeshme që janë të nevojshme për të mundësuar këtë pjesëmarrje, përfshirë edhe pjesëmarrjen në zgjedhje, mund të përbëjë një formë diskriminimi. Të drejtat kryesore të mishëruara në KDPAK, sa i takon zgjedhjeve, lidhen me: të drejtat e personave me aftësi të kufizuar për të marrë pjesë plotësisht në zgjedhje si kandidatë dhe zgjedhës, pa përjashtim; të drejtën për t’u caktuar në detyrë dhe për të ushtruar të gjitha funksionet publike në të gjitha nivelet e qeverisjes; të drejtën e

⁶ Paragrafët 20, 10 dhe 4, Komenti i Përgjithshëm i KDPAK-së 25, Komiteti për të Drejtat e Njeriut. Gjetet në: http://tbinternet.ohchr.org/_layouts/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CCPR%2fC%2f21%2fRev.1%2fAdd.7&Lang=en

aksesit fizik, si edhe të aksesit ndaj informacioneve dhe proceseve zgjedhore, përfshirë edhe ato që lidhen me partitë dhe fushatat; si dhe të drejtën për të votuar me ndihmën e një personi të zgjedhur prej tyre. KDPAK-ja kërkon edhe mbledhjen e të dhënave të ndara si dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar në hartimin e politikave dhe legjisllacionit që ndikojnë në pjesëmarrjen e tyre. Në respekt të këtij parimi, vetë Konventa është hartuar me pjesëmarrjen aktive të lëvizjes për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar.

Deri në vitin 2017, mbi 170 shtete janë bërë palë në këtë Konventë, që do të thotë se ajo gëzon njohje pothuajse universale.⁷ Të gjitha shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së janë zotuar ta zbatojnë këtë Konventë, me përjashtim të Selisë së Shenjtë, Lihtenshtejnit dhe Taxhikistanit. Pesë shtete të tjera pjesëmarrëse të OSBE-së (Irlanda, Kirgistani, Monako, SHBA-ja dhe Uzbekistani) ose nuk kanë dhënë ende konfirmim formal, nuk kanë aderuar ose nuk e kanë ratifikuar këtë Konventë, por përmes siglimit të saj kanë marrë përsipër respektimin e objektivit dhe qëllimit të përgjithshëm të Konventës. Bashkimi Evropian e konfirmoi zyrtarisht KDPAK-në në dhjetor 2010, duke e bërë të parën konventë ndërkombëtare bazë kushtuar të drejtave të njeriut që ratifikohet nga një organizatë rajonale.

Për monitorimin e zbatimit të Konventës, KDPAK-ja ka ngritur Komitetin për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (Komiteti i KDPAK-së), i cili është një organ me ekspertë të pavarur nga shtete të ndryshme palë.⁸ Komiteti nxjerr shpjegime unifikuese të Konventës përmes komenteve të përgjithshme.⁹ Gjithashtu, ai iu bën sugjerime dhe rekomandime shteteve palë, të cilat kanë detyrimin të paraqesin raporte periodike pranë Komitetit se si zbatohen të drejtat e Konventës në vendin e tyre.¹⁰ Vërejtjet përmbyllëse të Komitetit për raportet e shteteve palë japin orientime të mëtejshme për objektin dhe zbatimin e Konventës. Një tjetër funksion kryesor i Komitetit qëndron në kompetencën e tij për të shqyrtuar ankesa individuale në lidhje me shkeljet e pretenduara të Konventës nga shtetet palë në Protokollin Fakultativ të Konventës.¹¹ Këto ankesa mund të bëhen vetëm pasi shterohen mjetet e brendshme juridike. Praktika gjyqësore e organeve mbikëqyrëse, si Komiteti i KDPAK-së i OKB-së, bëhet kështu pjesë e standardeve ndërkombëtare që evoluojnë.

Nisur nga rëndësia dhe karakteri gjithëpërfshirës i KDPAK-së, është e dobishme të nënvizohen disa komponentë kyç që lidhen me pjesëmarrjen në zgjedhje në përgjithësi, para se të kalohet në nenin 29, që përcakton detyrime specifike lidhur me zgjedhjet.

Bazat e Konventës

Preambula e KDPAK-së vlerëson se “aftësia e kufizuar është një koncept që evoluon dhe se aftësia e kufizuar rezulton nga ndërveprimi ndërmjet personave me aftësi të kufizuar dhe pengesave të sjelljes dhe mjedisit, që pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive

7 Për listën e shteteve palë në KDPAK, shih: <http://indicators.ohchr.org>

8 <http://www.ohchr.org/EN/HRBodies/CRPD/Pages/CRPDIndex.aspx>.

9 Deri tani, Komiteti ka nxjerrë katër komente të përgjithshme, përfshirë dhe njohjen e barabartë përpara ligjit (neni 12) dhe aksesueshmërinë (neni 9). Komitetet e Përgjithshme gjenden në: <http://www.ohchr.org/EN/HRBodies/CRPD/Pages/GC.aspx>.

10 Shtetet duhet të raportojnë fillimisht dy vjet pas pranimit të Konventës, dhe më pas, çdo katër vjet.

11 Që prej prillit 2017, 91 vende janë bërë palë në Protokollin Fakultativ të Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Gjendet në:

https://treaties.un.org/Pages/ViewDetails.aspx?src=IND&mtmsg_no=IV-15-a&chapter=4&clang=_en.

në shoqëri në kushte të barabarta me të tjerët”. Ky kuadër nuk është një qasje bamirësie/mjekësore ndaj aftësisë së kufizuar, por buron thellë nga të drejtat e njeriut dhe detyrimi i shtetit për eliminimin e pengesave dhe marrjen e masave për të krijuar shoqëri më të barabarta dhe për të shmangur diskriminimin. Pra, fokusi nuk është që personi me aftësi të kufizuar të bëhet i aftë të përshtatet në shoqëri, por nevoja që shoqëritë të përshtatin dallimet dhe të përmbushin nevojat individuale.

Diskriminimi

Diskriminimi përkufizohet në mënyrë tërësore si “çdo dallim, përjashtim ose kufizim për shkak të aftësisë së kufizuar, që ka si qëllim ose ndikon në pengimin ose mohimin e njohjes, gëzimit ose ushtrimit, njësoj si të tjerët, e të gjitha të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në fushën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, civile apo në ndonjë fushë tjetër. Ai përfshin të gjitha format e diskriminimit, përfshirë edhe mohimin e “përshtatjes së arsyeshme” (neni 1 dhe 2).

Shtetet që kanë ratifikuar ose aderojnë në këtë Konventë kanë detyrimin “të marrin të gjitha masat e duhura, përfshirë edhe ato legjislative, për të modifikuar apo shfuqizuar ligjet, rregulloret, zakonet dhe praktikat ekzistuese të cilat kanë përmbajtje diskriminuese ndaj personave me aftësi të kufizuar (neni 4.1, germa b). Gjithashtu, shtetet kanë detyrimin “të marrin të gjitha masat e duhura për të eliminuar diskriminimin për shkak të aftësisë së kufizuar nga çdo person, organizatë ose ndërmarrje private” (neni 4.1, germa e). Pra, shteti duhet të marrë gjithashtu masa që shoqëria civile dhe subjektet private të mos i diskriminojnë personat me aftësi të kufizuar në lidhje me të drejtat e tyre të pjesëmarrjes politike.

Të dhënat e ndara

Të dhënat e ndara sipas aftësisë së kufizuar janë thelbësore për identifikimin e nivelit të pjesëmarrjes dhe pengesave ndaj aksesit. Neni 31 i detyron shtetet “të mbledhin informacionin e duhur, përfshirë edhe të dhëna statistikore dhe kërkimore... për të hartuar dhe zbatuar politika për të vënë në jetë këtë Konventë”. Gjithashtu, ai i referohet informacionit që duhet “të shkëmbetet sipas nevojës” dhe të shpërndahet. Me qëllim që të jenë sa më efektive, të dhënat mund të ndahen në kategori të tjera, p.sh.: sipas gjinisë, përkatësisë etnike, moshës apo grupit shoqëror.

Konsultimi me personat me aftësi të kufizuar

Shtetet duhet t'i përfshijnë në mënyrë aktive dhe të qenësishme personat me aftësi të kufizuar. Neni 4.3 thekson se: “Gjatë hartimit dhe zbatimit të legjislacionit dhe politikave për zbatimin e kësaj Konvente, si dhe gjatë proceseve të tjera vendimmarrëse lidhur me çështjet e personave me aftësi të kufizuar, shtetet palë duhet të konsultohen ngushtësisht me personat me aftësi të kufizuar dhe t'i përfshijnë ata në mënyrë aktive, përfshirë dhe fëmijët me aftësi të kufizuar, përmes organizatave të tyre përfaqësuese”. Komenti i dytë i Përgjithshëm i Komitetit i referohet garantimit të mundësive të qenësishme që ata të kontribuojnë në procesin e hartimit, në dhënien e komenteve, paraqitjen e propozimeve dhe në rritjen e ndërgjegjësimit.

Aksesueshmëria, projektimi universal dhe përshtatja e arsyeshme

Mjediset, infrastruktura dhe mediat e aksesueshme shpesh njihen si parakushte për ushtrimin e të drejtave të tjera të parashikuara në Konventë.¹² Neni 9 kërkon që shtetet “të marrin masat e duhura për të siguruar që personat me aftësi të kufizuara, ashtu si gjithë të tjerët, të kenë akses në ambientet fizike, ... ndaj informacionit dhe komunikimit, ... dhe ndaj lehtësive dhe shërbimeve të tjera të hapura apo të ofruara për publikun”. Gjithashtu, shteteve u kërkohet që “të zhvillojnë, të miratojnë dhe të monitorojnë zbatimin e udhëzimeve dhe standardeve minimale në lidhje me aksesin në objekte dhe ndaj shërbimeve të hapura apo të ofruara për publikun.”

Përveç kësaj, neni 21 kërkon që shtetet “të ndërmarrin të gjitha masat e duhura për të siguruar që personat me aftësi të kufizuara të mund të ushtrojnë të drejtën e tyre të lirisë së shprehjes dhe mendimit, përfshirë dhe lirinë për të kërkuar, patur dhe përhapur informacionin dhe idetë në baza të barabarta me të tjerët dhe nëpërmjet të gjitha formave të komunikimit sipas zgjedhjes së tyre”. Më lart në këtë Konventë, “komunikimi” përkufizohet në mënyrë tërësore dhe përfshin: “gjuhët, shfaqjet e tekstit, alfabetin Braille, komunikimin me prekje, shkronjat e mëdha, multimediat e aksesueshme, si edhe mënyrat, mjetet dhe format e komunikimit në audio, të shkruar, në gjuhë të qartë, me anë të leximit nga një person ndihmës dhe në ato shtesë dhe alternative, përfshirë edhe informacion dhe teknologji komunikimi të aksesueshëm”.

Dy koncepte kyç, të përcaktuara në fillim të kësaj Konvente, lidhen ngushtë me detyrimin për të garantuar mjedise të aksesueshme: **projektimi universal dhe përshtatja e arsyeshme**.¹³ “Projektimi universal” përkufizohet si “projektim i produkteve, mjediset, programeve dhe shërbimeve që të jenë të përdorshme nga të gjithë njerëzit, sa më shumë që të jetë e mundur, pa pasur nevojë për përshtatje apo projektim të veçantë”. Për shembull, kjo do të thotë se të gjitha materialet zgjedhore duhet të konceptohen në mënyrë të tillë që të jenë të përdorshme nga ana e personave me aftësi të kufizuara të ndryshme. Kjo është qasja proaktive ndaj aksesueshmërisë.

Komenti i dytë i Përgjithshëm i Komitetit shtjellon se krijimi i projektimit universal është një proces gradual, me një theks të veçantë mbi përputhshmërinë e Konventës me produktet dhe shërbimet e reja. Aty parashikohet se: “Të gjitha objektet, infrastrukturat, lehtësitë, mallrat, produktet dhe shërbimet e reja duhet të projektohen në mënyrë të tillë, që të jenë plotësisht të aksesueshme nga ana e personave me aftësi të kufizuara, në përputhje me parimet e projektimit universal”. Edhe pse projektimi universal mund të zbatohet gradualisht, shtetet duhet të përcaktojnë gjithashtu afate të qarta dhe të verë në dispozicion burime të mjaftueshme për eliminimin e pengesave ekzistuese. Sipas Komitetit, këto pengesa “duhet të eliminohen në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike, gradualisht por në mënyrë të qëndrueshme”.

Koncepti i dytë kyç është “përshtatja e arsyeshme”, i cili lidhet me individët që mund të kenë nevoja në një kontekst të caktuar të cilat shkojnë përtej standardeve të përgjithshme të aksesueshmërisë. Kjo përkufizohet si “modifikime dhe rregullime të nevojshme dhe të

¹² Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, në Komentin e Përgjithshëm Nr. 2 (2014).

¹³ KDPK, neni 2.

duhura, që nuk vendosin ndonjë barrë të tepruar apo të panevojshme atëherë kur është e nevojshme në një rast të veçantë, për t'u siguruar personave me aftësi të kufizuar gëzimin apo ushtrimin, në baza të barabarta me të tjerët, e të gjitha të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”. Me fjalë të thjeshta, kjo nënkupton që personat me aftësi të kufizuar mund të kërkojnë masa shtesë përtej rregullave të përgjithshme të aksesueshmërisë.

Ofrimi i shpjegimit në gjuhën e shenjave mund të përbëjë një masë aksesueshmërie apo një masë përshtatjeje të arsyeshme, në varësi të situatës. Për shembull, partive politike mund t'u vendosen disa detyrime. Për partitë e mëdha politike, përdorimi i shpjegimit në gjuhën e shenjave gjatë aktiviteteve kryesore mund të shihet si masë aksesueshmërie. Kjo gjë mund të mos jetë e tillë për partitë më të vogla, për shkak të kufizimeve financiare. Njëkohësisht, nëse një person që ka nevojë për shpjegim në gjuhën e shenjave është i interesuar të marrë pjesë në një aktivitet të vogël, ofrimi i shpjegimit në gjuhën e shenjave do të ishte më shumë një masë përshtatjeje e arsyeshme sesa një kërkesë e përgjithshme aksesueshmërie.

Shtetet kanë detyrimin të garantojnë projektim universal dhe përshtatje të arsyeshme. Komenti i dytë i Përgjithshëm i Komitetit nënvizon se: “Meqenëse aksesueshmëria është parakusht për personat me aftësi të kufizuar që të jetojnë në mënyrë të pavarur... dhe të marrin pjesë plotësisht dhe mbi baza të barabarta në shoqëri, mohimi i aksesit në mjedisin fizik dhe ndaj transportit, teknologjive të informacionit dhe komunikimit, dhe ndaj lehtësive dhe shërbimeve të hapura për publikun, duhet të shihet në kontekstin e diskriminimit”.

Në lidhje me zgjedhjet, Komenti i dytë i Përgjithshëm i Komitetit nënvizon në mënyrë të qartë se: “Personat me aftësi të kufizuar do ta kishin të pamundur t'i ushtrorin ato të drejta [neni 29] në mënyrë të barabartë dhe efektive, nëse shtetet palë nuk garantojnë që procedurat, mjediset dhe materialet e votimit të jenë të përshtatshme, të aksesueshme dhe lehtësisht të kuptueshme dhe të përdorshme. Gjithashtu, është e rëndësishme që aktivitetet dhe materialet politike që përdoren dhe prodhohen nga partitë politike apo kandidatët individualë që marrin pjesë në zgjedhjet publike, të jenë të aksesueshme. Në të kundërt, personave me aftësi të kufizuar u privohet e drejta për të marrë pjesë në proceset politike në mënyrë të barabartë”.

KDPAK-ja kërkon që shtetet të monitorojnë zbatimin e standardeve të aksesueshmërisë. Komenti i dytë i Përgjithshëm i Komitetit nënvizon se shtetet duhet “të krijojnë organe efikase monitorimi, me kapacitete adekuate dhe me tagrin e përshtatshëm për të garantuar vënien në jetë dhe zbatimin e planeve, strategjive dhe standardizimit”.

Ndërgjegjësimi dhe lufta ndaj stereotipave mbizotërues

Nxitja e pjesëmarrjes efektive të personave me aftësi të kufizuar shpesh pengohet nga stereotipat mbizotërues. KDPAK-ja e vë fort theksin mbi nevojën “për nxitjen e respektimit të të drejtave dhe dinjitetit të personave me aftësi të kufizuar” dhe “luftën ndaj stereotipave, paragjytimeve dhe praktikave të dëmshme”. Kjo përfshin “inkurajimin e të gjitha organeve të medias që t'i portretizojnë personat me aftësi të kufizuar në një mënyrë që përputhet me

qëllimin” e KDPAK-së. Në veçanti, media duhet t’i paraqesë personat me aftësi të kufizuar që marrin pjesë mbi baza të barabarta në aktivitetin politik.

Zotësi juridike njësoj si të tjerët

Në praktikë, kufizim i zotësisë juridike do të thotë që një person cilësohet në pamundësi për të marrë vendime në të gjitha fushat apo në disa fusha të jetës së tij, dhe ky kufizim mund të jetë i pjesshëm ose i plotë. Në raste të tilla, të drejtat ligjore i kalojnë një kujdestari, i cili caktohet që të ushtrojë të gjitha të drejtat ose disa të drejta në emër të personit. KDPAK-ja nuk e mbështet këtë qasje. Në vend të heqjes së zotësisë juridike dhe zëvendësimit të vendimmarrjes, KDPAK-ja fokusohet në mbështetjen e personave me aftësi të kufizuar që të ushtrojnë të drejtat e tyre ligjore, përfshirë edhe atë zgjedhore. Neni 12 i detyron shtetet “të njohin ligjërisht që personat me aftësi të kufizuar gëzojnë zotësi juridike, mbi baza të barabarta me të tjerët, në të gjitha aspektet e jetës”. Neni nuk parashikon ndonjë përjashtim, madje specifikon se shtetet “duhet të marrin masat e përshtatshme që t’u garantojnë personave me aftësi të kufizuar akses në mbështetjen që mund të kërkojnë për të ushtruar zotësinë e tyre juridike”. “Vendimmarrje e asistuar” do të thotë që një personi mund t’i jepet ndihma e nevojshme për marrjen e vendimeve të caktuara, përfshirë edhe ushtrimin e të drejtave zgjedhore. Për shembull, për një person me aftësi të kufizuar intelektuale, ky mekanizëm mund të nënkuptojë, që gjykata cakton një person apo grup personash për ta këshilluar personin me aftësi të kufizuar dhe për ta ndihmuar të kuptojë procesin zgjedhor dhe pasojat e vendimeve të tij/saj, përfshirë edhe votimin. Personi i zgjedhur për të ndihmuar duhet lejuar ligjërisht ta ndihmojë atë gjatë procesit të votimit.

Si pasojë, Komiteti i KDPAK-së është shprehur shumë qartë se Konventa nuk lejon heqjen e zotësisë juridike për shkak të aftësisë së kufizuar mendore apo intelektuale. Është e qartë se as vendimet e përgjithshme dhe as ato individuale të gjykatave nuk janë baza të pranueshme për heqjen e të drejtës së votës. Në vitin 2011, në çështjen “Bujdosó dhe pesë të tjerë kundër Hungarisë”, Komiteti shqyrtoi një çështje ku persona me aftësi të kufizuar intelektuale ishin vënë nën kujdestari të pjesshme ose të plotë dhe emrat e tyre ishin hequr automatikisht nga regjistri i zgjedhësve. Komiteti vendosi se “heqja e të drejtës së votës mbi bazën e aftësisë së kufizuar intelektuale apo psikosociale, të perceptuar apo aktuale, përfshirë edhe kufizimin bazuar në një vlerësim individual, përbën diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar”. Ky qëndrim është konfirmuar edhe në Komentin e parë të Përgjithshëm të Komitetit.

Pjesëmarrja politike

Sa i takon pjesëmarrjes në zgjedhje, thelbin e KDPAK-së e shpreh neni 29, që trajton pjesëmarrjen politike. Ai i detyron shtetet të marrin masa pasive dhe aktive; jo vetëm të garantojnë të drejtat, por edhe të marrin masa aktive për të krijuar një mjedis të favorshëm për pjesëmarrje të plotë. Neni 29 fillon me përkufizimin e detyrimit të shteteve në vija të përgjithshme që “të garantojnë që personat me aftësi të kufizuar mund të marrin pjesë në mënyrë të plotë dhe efektive në jetën politike dhe publike, njësoj si gjithë të tjerët”. Ajo që është e rëndësishme është që nuk parashikohen përjashtime për shkak të llojit të aftësisë së kufizuar.

Neni 29 përvijon qartë disa mjete për arritjen e këtij qëllimi, duke përfshirë “garantimin e procedurave, mjedisëve dhe materialeve të votimit të përshtatshme, të aksesueshme dhe lehtësisht të kuptueshme dhe të përdorshme”. Ky nen specifikon më tej detyrimin “për t’u garantuar personave me aftësi të kufizuar shprehjen e vullnetit të lirë si zgjedhës. Për këtë qëllim, lejohet të ndihmohen në votim nga një person i zgjedhur prej tyre me kërkesën e tyre dhe kur është e nevojshme”.

Gjithashtu, neni 29 i detyron shtetet “të promovojnë në mënyrë aktive” një pjesëmarrje më të gjerë të personave me aftësi të kufizuar në çështjet publike. Kjo gjë përfshin “pjesëmarrjen në organizatat joqeveritare dhe shoqatat që kanë të bëjnë me jetën publike dhe politike në vend, si dhe në aktivitetet dhe administrimin e partive politike”.

“Në bazë të nenit 29, personat me aftësi të kufizuar kanë jo vetëm të drejtën, por edhe ‘mundësinë’ për të votuar dhe për t’u zgjedhur. Kjo i ngarkon shtetet palë me detyrimin që, nëpërmjet miratimit të masave pozitive, t’u garantojnë të gjithë personave që përmbushin kriteret mundësi reale për të ushtruar të drejtën e votës. Rrjedhimisht, nuk mjafton vetëm njohja formale e të drejtës së votës për personat me aftësi të kufizuar, por shtetet duhet edhe të garantojnë që personat me aftësi të kufizuar të jenë realisht në gjendje të ushtrojnë të drejtën e votës, për shembull, duke i bërë qendrat e votimit të aksesueshme për përdoruesit në karrocë invalidi, duke lehtësuar përdorimin e mjeteve ndihmëse të votimit me qëllim që personat me aftësi të kufizuar në shikim të votojnë në mënyrë të pavarur, ose duke lejuar që personat me aftësi të kufizuar të ndihmohen në votim nga një person i zgjedhur prej tyre”.

-Zyra e Komisionerit të Lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut (ZKLDNJ), 2011

KDPAK, neni 29 – Pjesëmarrja në jetën politike dhe publike

“Shtetet palë duhet t’u garantojnë personave me aftësi të kufizuar të drejtat politike dhe mundësinë për t’i gëzuar ato njësoj si pjesa tjetër e popullsisë dhe duhet të marrin përsipër:

- (a) t’u garantojnë personave me aftësi të kufizuar pjesëmarrjen e plotë dhe efektive në jetën politike dhe publike, njësoj si gjithë të tjerët, drejtpërsëdrejti apo nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur lirisht prej tyre, përfshirë edhe të drejtën dhe mundësinë e personave me aftësi të kufizuar për të votuar dhe për t’u zgjedhur, ndër të tjera:
 - (i) duke siguruar që procedurat, ambientet dhe materialet e votimit të jenë të përshtatshme, të aksesueshme dhe të thjeshta për t’u kuptuar dhe për t’u përdorur;
 - (ii) duke mbrojtur të drejtën e personave me aftësi të kufizuar për të votuar me votë të fshehtë në zgjedhje dhe referendume publike pa u ndikuar nga asnjë kërcënim dhe për të kandiduar në zgjedhje, për t’u zgjedhur në detyrë dhe për të ushtruar të gjitha funksionet publike në të gjitha nivelet e qeverisjes, duke lehtësuar, sipas rastit, përdorimin e teknologjive ndihmëse dhe të reja;
 - (iii) duke garantuar shprehjen e vullnetit të lirë të personave me aftësi të kufizuar si zgjedhës dhe, për këtë qëllim, kur është e nevojshme, me kërkesën e tyre, duke lejuar ndihmën në votim nga një person i zgjedhur prej tyre;

- (b) garantimin në mënyrë aktive të një mjedisi në të cilin personat me aftësi të kufizuara mund të marrin pjesë në mënyrë efektive dhe të plotë në ndjekjen e çështjeve publike, pa diskriminim dhe njësoj si të tjerët, dhe të inkurajojnë pjesëmarrjen e tyre në çështjet publike, duke përfshirë:
- (i) pjesëmarrjen në organizatat joqeveritare dhe shoqatat, që kanë të bëjnë me jetën publike dhe politike në vend, dhe në aktivitetet dhe administrimin e partive politike.
 - (ii) Krijimi i organizatave të personave me aftësi të kufizuara dhe anëtarësimi në to për përfaqësimin e personave me aftësi të kufizuara në nivel ndërkombëtar, kombëtar, rajonal dhe lokal

C. Instrumente të tjera rajonale

Ky seksion analizon katër organizata kryesore ndërqeveritare rajonale, kur marrin pjesë edhe shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së, që ofrojnë instrumente për përfshirjen e aftësisë së kufizuara. Këto organizata janë Këshilli i Evropës (KiE), Bashkimi Evropian (BE), Komonuelthi i Shteteve të Pavarura (KSHP) dhe Organizata e Shteteve Amerikane (OSHA).

Këshilli i Evropës

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) përmban dispozita detyruese për të drejtën për “zgjedhje të lira” (neni 3, protokollin 1). Në pjesën më të madhe shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së janë edhe anëtarë të Këshillit të Evropës; si rrjedhojë, janë të detyruara të zbatojnë KEDNJ-në. Pas ratifikimit, të detyrueshëm bëhen edhe protokollet e Konventës dhe traktatet e tjera të miratuara nga Këshilli i Evropës, që mund të përmbajnë detyrime në lidhje me zgjedhjet. Ashtu si PNDCP-ja, edhe KEDNJ-ja e ndalon diskriminimin dhe ndonëse nuk i referohet posaçërisht aftësive të kufizuara ajo përmend në mënyrë të përgjithshme frazën “status tjetër” (neni 14). Këshilli i Evropës nuk ka ndonjë traktat të posaçëm për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

Ndërkohë, organe të ndryshme të Këshillit të Evropës kanë dhënë vendime ose rekomandime për zhvillimin e mëtejshëm të standardeve lidhur me aftësinë e kufizuara. Këtu përfshihen vendimet e Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) dhe rekomandimet e miratuara nga Komiteti i Ministrave (organi më i lartë politik i Këshillit të Evropës, ku rekomandimet miratohen me pëlqimin e të 47 shteteve pjesëmarrëse), Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (APKiE) dhe Komisioni Evropian për Demokraci Përmes Ligjit (organ këshillimor për çështje kushtetuese, gjerësisht i njohur si Komisioni i Venecias).

Në vitin 2006, Komiteti i Ministrave nxori një rekomandim (jodetyrues) për “Planin e Veprimit të Këshillit të Evropës për promovimin e të drejtave dhe pjesëmarrjen e plotë të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri” (2006-2015).¹⁴ Aty nënvizohet se: “Personat me aftësi të kufizuara duhet të kenë mundësinë të ndikojnë në fatet e komuniteteve të tyre. Prandaj është e rëndësishme që personat me aftësi të kufizuara të jenë në gjendje të ushtrojnë të drejtën e tyre të votës dhe për të marrë pjesë në aktivitetet politike dhe publike”.¹⁵

14 Gjetend në: <http://www.coe.int/en/web/disability/action-plan-2006-2015>.

15 Këshilli i Evropës, Komiteti i Ministrave, Rekomandimi Rec(2006)5 i Komitetit të Ministrave për Shtetet Anëtare mbi Planin e Veprimit të Këshillit të Evropës “Për promovimin e të drejtave dhe pjesëmarrjen e plotë të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri: përmirësimi i cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuara në Evropë 2006-2015”: https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=0900016805af657.

Rekomandimi përfshinte masa konkrete në lidhje me aksesueshmërinë e procedurave dhe ambienteve të votimit, dhe parashikonte dhënien e ndihmës nga një person i zgjedhur prej tyre, vënien e informacionit në dispozicion në formate të ndryshme, si dhe promovimin e këshillimit me organizatat përfaqësuese të aftësive të kufizuar.

Praktika gjyqësore e GJEDNJ-së nuk e pasqyron plotësisht qasjen e KDDPAK-së ndaj çështjes së zotësisë juridike. GJEDNJ-ja e lejon kufizimin e zotësisë juridike në lidhje me të drejtën e votës, nëse kufizimi vendoset nga gjykata pas vlerësimit individual të rastit. Kjo bie ndesh me KDDPAK-në, e cila thekson se personat me aftësi të kufizuar kanë zotësi juridike njësoj si pjesa tjetër e popullsisë, dhe cilëson çdo kufizim të kësaj të drejte si diskriminim. Sipas KDDPAK-së, shtetet kanë detyrimin t'u sigurojnë mbështetje personave që kërkojnë ndihmë në ushtrimin e zotësisë së tyre juridike. Kjo vendimmarrje e asistuar ndryshon shumë nga vendimmarrja me zëvendësim, pasi zotësia juridike e personit mbetet e pacenuar në të gjitha fushat e tjera të jetës.

Në vitin 2010, GJEDNJ-ja gjykoi çështjen “Alajos Kiss kundër Hungarisë”, e cila ka të bëjë me heqjen e të drejtës së votës për shkak të aftësisë së kufizuar mendore.¹⁶ Vendimi i gjykatës e ngushtoi bazën për heqjen e të drejtës së votës për shkak të aftësisë së kufizuar mendore, duke e lënë këtë gjë të vendoset nga gjykatat pas shqyrtimit të rasteve në mënyrë individuale dhe jo si ndalim të përgjithshëm. Gjykata u shpreh se: “heqja pa dallim e të drejtës së votës, pa një vlerësim të individualizuar gjyqësor dhe duke u bazuar vetëm tek aftësia e kufizuar mendore që kërkon kujdestari të pjesshme, nuk mund të cilësohet në përputhje me bazat e ligjshme për kufizimin e të drejtës së votës”. vetëm tek aftësia e kufizuar mendore që kërkon kujdestari të pjesshme, nuk mund të cilësohet në përputhje me bazat e ligjshme për kufizimin e të drejtës së votës”.

“KDDPAK-ja nuk përcakton ndonjë përjashtim nga të drejtat e parashikuara në të. Përkundrazi, kërkon që autoritetet shtetërore “të pranojnë se personat me aftësi të kufizuar gëzojnë zotësi juridike të njëjtë me gjithë të tjerët, në të gjitha fushat e jetës ... Nuk ka vend për procedura ku gjyqtarët apo personeli mjekësor të vlerësojnë aftësinë e një personi për të votuar, dhe më pas të vendosë nëse të hapë apo jo dritën jeshile. Meqë kjo lloj aftësie votuese nuk testohet te personat pa aftësi të kufizuar, kjo do të nënkuptonte diskriminim flagrant... Konventa i detyron qeveritë që të garantojnë që kjo ndihmë të jepet në rast se është e nevojshme, përfshirë edhe ndihmën për ushtrimin e të drejtës së votës. Ekziston një dallim i madh mes kësaj qasjeje dhe thjesht privimit të dikujt nga të drejtat e tij. Ky është ndryshimi themelor që sjell Konventa e OKB-së”.

- Komisioneri i Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut, mars 2011

Në nëntor të vitit 2011, Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës miratoi një rekomandim për pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuar në jetën politike dhe publike.¹⁷ Kjo gjë theksoi qëndrimin e KDDPAK-së kundër kufizimit të së drejtës për të votuar për shkak të aftësisë së kufizuar mendore, duke deklaruar se nuk duhet të ketë diskriminim në ushtrimin

¹⁶ Shih “Alajos Kiss kundër Hungarisë”, vendim i datës 20 maj 2010 (kërkesa nr. 38832/06). Burimi: <http://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-98800>.

¹⁷ Rekomandimi CM/Rec(2011)14 i Komitetit të Ministrave për Shtetet Anëtare “Për pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuar në jetën politike dhe publike”: https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=09000016805cbe4e.

e zotësisë juridike dhe se “shtetet anëtare duhet të sigurohen që legjislacioni i tyre të zhvishet, në të gjitha nivelet, nga dispozitat që u mohojnë personave me aftësi të kufizuara të drejtën për të votuar apo për t’u zgjedhur”. Ai përsëriti çështjet e aksesueshmërisë dhe ndihmës nga një person i zgjedhur prej tyre, dhe theksoi përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në vendimmarrje dhe nevojën për “informacione dhe statistika të besueshme dhe të krahasueshme”. Rekomandimi vëren gjithashtu se: “shtetet anëtare duhet t’u kërkojnë partive politike, shoqatave, grupeve mediatike dhe organeve të tjera që marrin subvencione ose financim nga shteti, të japin llogari për marrjen e masave aktive që iu garantojnë personave me aftësi të kufizuara akses ndaj informacionit mbi debatet politike, fushatat dhe aktivitetet e tjera që përfshihen në sferën e veprimtarisë së tyre”.

Në vijim, në dhjetor të vitit 2011, Komisioni i Venecias ndryshoi qëndrimin për pjesëmarrjen në zgjedhje të personave me aftësi të kufizuara, duke shtuar një rishikim të variantit të mëparshëm të Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore (miratuar fillimisht në vitin 2002). Teksti fillestar i Kodit lejonte që personave për të cilët gjykata vlerëonte se ishin me pazohtësi mendore t’u hiqej e drejta për të votuar.¹⁸ Deklarata Interpretuese e Rishikuar për Kodin e Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore “Për pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në zgjedhje” e vitit 2011 mban tjetër qëndrim, edhe pse ende me njëfarë paqartësie (nga mospërputhja e qëndrimeve ndërmjet GJEDNJ-së dhe KDPAK-së).¹⁹ Në të përcaktohet se: “E drejta universale për të votuar është parim themelor i Trashëgimisë Zgjedhore Evropiane. Personat me aftësi të kufizuara nuk mund të diskriminohen në këtë aspekt, në përputhje me nenin 29 të KDPAK-së dhe me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së”. Deklarata Interpretuese e Rishikuar i referohet gjithashtu aksesueshmërisë në procedurat dhe ambientet e votimit, ofrimit të informacionit në formate të ndryshme, teknologjive ndihmëse dhe ndihmës nga një person i zgjedhur vullnetarisht.

Rekomandimet e Komitetit të Ministrave dhe shpjegimet e Komisionit të Venecias tregojnë një qasje në zhvillim, e cila është në përputhje me KDPAK-në; sidoqoftë, kjo do të duhet të testohet në praktikën vijuese gjyqësore të GJEDNJ-së.

Një tendencë e tillë duket edhe në dokumentet e mëpasshëm strategjikë të Këshillit të Evropës. Në nëntor të vitit 2016, Këshilli i Evropës miratoi Strategjinë për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2017-2023,²⁰ duke vënë theksin tek shpjegimi i këtyre të drejtave në përputhje me frymën e KDPAK-së. Evidentohen pesë çështje prioritare: barazia, mosdiskriminimi, ndërgjegjësimi, aksesueshmëria dhe trajtimi i barabartë përpara ligjit. Strategjia thekson se personat me aftësi të kufizuara duhet të gëzojnë njohje të barabartë përpara ligjit dhe se vendimmarrja me zëvendësim duhet të zëvendësohet nga vendimmarrja me mbështetje. Në mars të vitit 2017, APKE-ja miratoi Rezolutën 2155(2017) mbi “Të drejtat politike të personave me aftësi të kufizuara: çështje e demokracisë”, në bazë të një raporti të

18 Kodi i mëparshëm i Praktikës së Mirë shprehej se privimi i të drejtës për të votuar dhe për t’u zgjedhur, në bazë të një vendimi për pazohtësi mendore, mund të “vendoset vetëm me vendim të shprehur nga gjykata”. Komisioni i Venecias, Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore, 1.1d. Gjetet në: [http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2002\)023rev-e](http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2002)023rev-e).

19 Deklarata Interpretuese e Rishikuar e Komisionit të Venecias për Kodin e Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore “Për pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në zgjedhje”, 2011. Gjetet në: <http://www.venice.coe.int/webforms/documents/CDL-AD%282011%29045.aspx>

20 Gjetet në: <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=0900016806fe7d4>

përgatitur nga Komiteti i saj për Barazi dhe Mosdiskriminim.²¹ Rezoluta shtjellon sfidat dhe praktikatat e mira të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës, si edhe përsërit thirrjen e APKE-së për zëvendësimin e vendimmarrjes me zëvendësim me mekanizmat e vendimmarrjes me mbështetje.²²

Bashkimi Evropian

Angazhimi i BE-së për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar tregohet nga ratifikimi i KDPAK-së në vitin 2010. E drejta e qytetarëve të BE-së për të votuar në zgjedhjet evropiane dhe vendore bazohet në Traktatin për Funkcionimin e Bashkimit Evropian, si dhe në Kartën e të Drejtave Themelore të BE-së. Neni 21 i Kartës i referohet mosdiskriminimit në të gjitha fushat e veprimtarisë së BE-së, përfshirë dhe zgjedhjet. Strategjia Evropiane për Aftësitë e Kufizuara 2010-2020 përcakton objektivin për arritjen “e pjesëmarrjes së plotë të personave me aftësi të kufizuar duke bërë të mundur që ata të gëzojnë të gjitha përfitimet e nënshtetësisë së BE-së dhe duke hequr pengesat administrative dhe në sjellje ndaj pjesëmarrjes së plotë dhe të barabartë”.²³

Nisma të tjera pozitive të BE-së përfshijnë Direktivën e BE-së e vitit 2016 për aksesueshmërinë e faqeve të internetit dhe aplikacioneve celulare të organeve të sektorit publik (Direktiva për internetin). Kjo Direktivë përcakton kriteret e aksesueshmërisë së faqeve të internetit dhe aplikacioneve celulare të organeve të sektorit publik për t’i bërë ato më të aksesueshme për përdoruesit në shtetet anëtare të BE-së, veçanërisht për personat me aftësi të kufizuar.²⁴ Gjithashtu, ka një rezolutë të Parlamentit Evropian për përdorimin e shpjegimit në gjuhën e shenjave, e cila “thekson se shërbimet publike dhe qeveritare, përfshirë edhe përmbytjen e tyre në rrjet (online), duhet të jenë të aksesueshme me anë të ndërmjetësve në kohë reale si interpretët e gjuhës së shenjave, por edhe nëpërmjet shërbimeve alternative me bazë internetin dhe ato periferike, kur një gjë e tillë është e përshtatshme...”. Ajo përmend gjithashtu “bërjen e procesit politik sa më të aksesueshëm që të jetë e mundur, përfshirë edhe përmes sigurimit të interpretëve profesionistë të gjuhës së shenjave”, dhe “thekson se një gjë e tillë përfshin zgjedhjet, konsultimet publike dhe aktivitete të tjera sipas rastit”.²⁵

Komonuelthi i Shteteve të Pavarura

Konventa për Standardet e Zgjedhjeve Demokratike, të Drejtat Zgjedhore dhe Lirinë në Shtetet Anëtare të Komonuelthit të Shteteve të Pavarura (KSHP) (Konventa e KSHP-së) e vitit 2002 nuk përmban ndonjë referencë të posaçme për pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuar në zgjedhje. Sidoqoftë, neni 2 shprehet se: “e drejta e qytetarit për të zgjedhur dhe për t’u zgjedhur në organet shtetërore, në qeverisjen vendore, në pozicione të tjera (kombëtare) të përfaqësimit dhe në pozicione të tjera të zgjedhura, nuk varet dhe ushtrohet pa asnjë kufizim të karakterit diskriminues me bazë gjininë, gjuhën, besimin ose

21 Gjendet në: <http://website-pace.net/documents/19879/3143407/20170130-Droitshandicapes-EN.pdf/e30d56a9-e78c-4691-b30b-1f1e1da0d1d7>.

22 Shih edhe Rezolutën 2039(2015) “Barazia dhe gjithëpërfshirja për personat me aftësi të kufizuar”, miratuar nga APKE-ja më 30 janar 2015 (§5): <http://assembly.coe.int/nw/xml/XRef/Xref-DocDetails-EN.asp?FileID=21339&lang=EN>.

23 Strategjia Evropiane për Aftësitë e Kufizuara 2010-2020 “Angazhim i ripërtërirë për një Evropë pa pengesa”. Gjendet në: <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2010:0636:FIN:EN:PDF>.

24 Gjendet në: <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:32016L2102>

25 Rezoluta e Parlamentit Evropian, 23 nëntor 2016 (2016/2952[RSP]). Gjendet në: <http://www.europarl.europa.eu/sides/getDoc.do?pubRef=-//EP//TEXT+TA+P8-TA-2016-0442+0+DOC+XML+Vo//EN>

emërtimin, bindjet politike ose bindje të tjera, origjinën kombëtare ose sociale, përkatësinë në një pakicë kombëtare ose grup etnik, gjendjen pasurore ose rrethanat e tjera”.

Organizata e Shteteve Amerikane

Në vitin 1978 hyri në fuqi Konventa Amerikane për të Drejtat e Njeriut, e cila përmban dispozita të përgjithshme për të drejtën e pjesëmarrjes në qeverisje, duke përdorur një gjuhë të ngjashme me PNDKP-në. Sidoqoftë, ajo vërente se: “Ligji mund të normojë ushtrimin e të drejtave dhe mundësive të përmendura në paragrafin e mëparshëm vetëm në bazë të... zotësisë civile dhe mendore.”²⁶ Më vonë, në shtator të vitit 2001, hyri në fuqi Konventa Ndër-Amerikane për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Personave me Aftësi të Kufizuar.²⁷ Ndonëse nuk përmend shprehimisht votimin ose kandidimin në zgjedhje, ajo përmend nxitjen e integritit në veprimtari politike dhe administrative. Sidoqoftë, Konventa parashikonte kushte të caktuara, në të cilat personat me aftësi të kufizuar deklaroheshin të pazotë.²⁸ Më e rëndësishmja është që, në vitin 2011, Komiteti i Konventës u shpreh se një gjë e tillë duhet të interpretohet sërish në kuadër të KDKP-së, dhe u kërkoi palëve në Konventë ta ndryshonin atë për ta harmonizuar me KDKP-në.²⁹

26 Konventa Amerikane për të Drejtat e Njeriut, neni 23. Gjetet në: <http://www.cidh.oas.org/basicos/english/basic3.american%20convention.htm>.

27 Gjetet në: <http://www.oas.org/juridico/english/treaties/a-65.html>.

28 “Në rast se, sipas ligjit vendas të një vendi, një person mund të deklarohet i pazoti juridikisht, kur kjo është e nevojshme dhe e përshtatshme për mirëqenien e tij/saj, një deklaram i tillë nuk përbën diskriminim.” Konventa Ndër-Amerikane për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Personave me Aftësi të Kufizuar, neni I.2.b.

29 Komiteti i OSHA-së për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Personave me Aftësi të Kufizuar (CEDDIS) OEA/Ser.L/XXIV.3.1, CEDDIS/doc.12(I-E/11) rev.1, 4 dhe 5 maj 2011. Gjetet në: http://www.sedi.oas.org/ddse/documentos/Discapacidad/English/CEDDIS-%20NY_ENG.pdf.



Kapitulli 2: Pengesat për pjesëmarrjen

Shkalla e pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuar në procesin zgjedhor është e vështirë të matet për arsye të mungesës së të dhënave ekzistuese në rajonin e OSBE-së. Duket se ato prova që ekzistojnë, tregojnë që personat me aftësi të kufizuar janë në përgjithësi më pak të përfaqësuar si votues, kandidatë, në pozicione të zgjedhura, në parti politike, në administratat zgjedhore dhe si vëzhgues në zgjedhje. Një gjë e tillë po njihet gjithnjë e më shumë. Për shembull, në vitin 2011, Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës theksoi se: “personat me aftësi të kufizuar përbëjnë përgjithësisht një masë të vogël të atyre që përfshihen në çështje publike dhe që kryejnë funksione përfaqësimi”.³⁰ Po kështu, edhe në botimet akademike është vërejtur se: “janë ndërmarrë disa nisima studimore për zgjedhjet në shkallë vendi, që marrin parasysh aftësitë e kufizuar... Këta studiues kanë konstatuar se pjesëmarrja në zgjedhje ka qenë më e ulët për personat me aftësi të kufizuar krahasuar me personat që nuk kanë aftësi të kufizuar”.³¹ Pjesëmarrja e ulët shpesh u atribuohet pengesave ligjore, qëndrimeve publike negative, mungesës së njohurive, problemeve me aksesueshmërinë dhe mungesës së burimeve dhe mbështetjes për të kandiduar dhe shërbyer në poste zyrtare.

30 Rekomandimi CM/Rec(2011)14 i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare “Për pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuar në jetën politike dhe publike”:

https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=0900016805cbe4e

31 “Pjesëmarrja politike e personave me aftësi të kufizuar në Evropë: të drejtat, aksesueshmëria dhe aktivizmi”, Priestley, Stickings, Loja, Grammenos, Lawson, Waddington dhe Fridriksdottir, 2016. “Studime për zgjedhjet” 42 (2016) 1-9, Elsevier.

Grupet e avokimit për personat me aftësi të kufizuar argumentojnë se pjesëmarrja e ulët në zgjedhje është tregues i diskriminimit politik, që përjetëson stigmën dhe marginalizimin.³² Heqja e zotësisë juridike personave me aftësi të kufizuar mendore ose intelektuale (dhe ndonjëherë personave me aftësi të kufizuar të llojeve të tjera) ka çuar shpesh në privimin e të drejtave të tyre zgjedhore. Në disa juridiksione, ka pasur pengesa ligjore edhe për anëtarësimin në parti politike ose në organizata të shoqërisë civile (OSHC).³³ Kriteri që personat me aftësi të kufizuar mendore duhet të vërtetojnë se kanë “zotësi për të gjykuar” është kritikuar nga OPAK-të të ndryshme si kriter shumë diskriminues dhe arbitrar, veçanërisht për faktin se asnjë grup tjetër nuk duhet të vërtetojë që ka kapacitet politik (një gjë e tillë është kritikuar edhe nga Komisioneri i Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut në mars të vitit 2011). Komiteti i KDPAK-së vëren se: “Historikisht, personave me aftësi të kufizuar u është mohuar e drejta e zotësisë juridike në shumë fusha në mënyrë diskriminuese me anë të regjimeve të vendimmarrjes me zëvendësim, si kujdestaria, mbrojtja ligjore (conservatorship) dhe ligjet për shëndetin mendor.”³⁴ Siç u tha më lart, KDPAK-ja nuk parashikon vendimmarrje me zëvendësim, por thekson vendimmarrjen me mbështetje duke bërë që personat me aftësi të kufizuar të ruajnë zotësinë e tyre juridike.

Arsyeja e rregullimit të pamjaftueshëm të aksesit për personat me aftësi të kufizuar mund të jetë pjesërisht pasojë e mungesës së përfshirjes së grupeve të prekura dhe konsultimit me to. Kjo tendencë ka çuar në thirrje të vazhdueshme për zbatimin të qasjes “asgjë s’mund të bëhet për ne pa ne”.³⁵ Një konsultim i tillë ndihmon zbutjen e diskriminimit, përkrah përparimin e përshtatshëm që është fuqizues dhe realist, si dhe nxit pjesëmarrje më të gjerë. Vlera e kësaj qasjeje po pranohet gjithnjë e më shumë në praktikë dhe në literaturën akademike. Për shembull, “... studimet në Mbretërinë e Bashkuar tërhoqën vëmendjen ndaj pengesave specifike, me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuar intelektuale, si dhe ndaj rëndësisë së kapitalit social dhe rrjeteve të mbështetjes si elementë mundësues për pjesëmarrjen në politikë (Bell e të tjerë, 2001; Keeley e të tjerë, 2008; Redley, 2008). Këto gjetje tregojnë se përcaktimi i të drejtave politike dhe ofrimi i aksesueshmërisë mund të mos jenë të mjaftueshme për të arritur pjesëmarrjen e plotë pa kuptuar dhe trajtuar në mënyrë proaktive edhe personat me aftësi të kufizuar dhe pretendimet e tyre politike.”³⁶

Po kështu, raporti i vitit 2016 i Raportuesit të Posaçëm të OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara përmbante komentin se: “Siç u duk gjatë procesit që çoi në miratimin e KDPAK-së, pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuar në vendimmarrjen publike mund të ketë ndikim shumë të madh në veprimet e qeverisë që i prekin ata, dhe mund të çojë në vendime më të mira, pasi personat me aftësi të kufizuar janë në pozitë më të mirë për të evidentuar nevojat e veta, si dhe politikat më të përshtatshme për përbushjen e këtyre nevojave. Pjesëmarrja e tyre garanton që politikat dhe programet shtetërore të hartohen në

32 Shih, për shembull, Qendrën Avokatore për Aftësitë e Kufizuara Mendore: <http://mdac.info/en>.

33 Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore, “E drejta e pjesëmarrjes në politikë e personave me aftësi të kufizuar”, f. 36: <http://fra.europa.eu/en/publication/2014/indicators-right-political-participation-people-disabilities>.

34 Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, Komenti i Përgjithshëm nr. 1 (2014). Gjetet në: <https://documents-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/G14/031/20/PDF/G1403120.pdf?OpenElement>.

35 Shih, për shembull, Forumin Evropian për Aftësitë e Kufizuara. Gjetet në: <http://www.edf-feph.org>.

36 Pjesëmarrja politike e personave me aftësi të kufizuar në Evropë: të drejtat, aksesueshmëria dhe aktivizmi”, Priestley, Stickings, Loja, Grammenos, Lawson, Waddington, dhe Fridriksdottir, 2016. “Studime për zgjedhjet” 42 (2016) 1-9, Elsevier.

bazë të nevojave dhe parapëlqimeve të tyre.”³⁷

OPAK-të janë bërë gjithnjë e më aktive për çështjet e të drejtave politike, përfshirë dhe monitorimin dhe dokumentimin e problemeve, paraqitjen e kundërshtimeve ligjore dhe avokimin. Përparimi i kuadrit ligjor ndërkombëtar me anë të KDPAK-së ka sjellë detyrime të reja për shtetet që e kanë nënshkruar ose kanë rënë dakord ta zbatojnë këtë Konventë, që ka sjellë si rezultat përmirësimin e planeve të veprimit, ligjeve dhe dispozitave vendase. Sidoqoftë, ka një gamë të madhe mangësish në lidhje me harmonizimin, siç vërehet në studimin e botuar në vitin 2014 nga Agjencia e BE-së për të Drejtat Themelore (ADTH), i cili trajtonte të drejtën e pjesëmarrjes politike të personave me aftësi të kufizuar brenda BE-së.³⁸

Gratë me aftësi të kufizuar përballen me vështirësi specifike në lidhje me pjesëmarrjen e tyre në jetën politike, përfshirë dhe proceset zgjedhore. Ato mund të hasen me forma të shumëllojshme diskriminimi, të cilat mund t'i çojnë në rrezik edhe më të lartë përjashtimi dhe përfaqësimi të ulët.

Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara është shprehur se: “Ka prova të forta që tregojnë se gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuar përballen me pengesa në shumicën e fushave të jetës. Këto pengesa krijojnë situata të formave të shumëllojshme dhe të ndërthurura të diskriminimit ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuar, veçanërisht në lidhje me: aksesin e barabartë në arsimim, mundësi ekonomike, ndërveprim social dhe drejtësi; trajtim të barabartë përpara ligjit; dhe aftësinë për të marrë pjesë në politikë dhe për të ushtruar kontroll mbi vetë jetët e tyre në kontekste të ndryshme...”. Në lidhje me pjesëmarrjen, Komiteti theksoi veçanërisht se: “Zërat e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuar janë mbytur historikisht dhe, prandaj, gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuar janë më pak të përfaqësuara në mënyrë shpërpjesëtimore në vendimarrjen publike.”

Përjashtimi nga pjesëmarrja në zgjedhje çon në mosdëgjimin dhe mostrajtimin e interesave të një grupi të përjashtuar. Pa të drejtën dhe mundësinë për të marrë pjesë si votues dhe si kandidatë, personat me aftësi të kufizuar rrezikojnë të marginalizohen edhe më shumë në shoqëri, çka dëmton si ata vetë ashtu edhe shoqërinë. Pjesëmarrja në zgjedhje është thelbësore për gjithëpërfshirjen e individëve në shoqëri. Gjithashtu, përjashtimi zvogëlon gjithëpërfshirjen në qeverisje dhe, për pasojë, shkallën në të cilën vullneti i shtetasve merret parasysh në mënyrë të efektshme.³⁹

37 Raport i Raportuesit të Posaçëm për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, Këshilli për të Drejtat e Njeriut, 2016:

http://www.ohchr.org/EN/HRBodies/HRC/RegularSessions/Session31/_layouts/15/WopiFrame.aspx?sourcedoc=/EN/HRBodies/HRC/RegularSessions/Session31/Documents/A_HRC_31_62_E.doc&action=default&DefaultItemOpen=1. Raporti i AFR-së mbulon vetëm Shtetet Anëtare të BE-së. Gjetet në: <http://fra.europa.eu/en/publication/2014/indicators-right-political-participation-people-disabilities>.

38 Raporti i AFR-së mbulon vetëm Shtetet Anëtare të BE-së. Gjetet në: <http://fra.europa.eu/en/publication/2014/indicators-right-political-participation-people-disabilities>.

39 Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, Komenti i Përgjithshëm 3, 2016.



Kapitulli 3. Cikli zgjedhor dhe pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuar

Kjo pjesë trajton çështje që vëzhguesit e ODIHR-it duhet të marrin në konsideratë në vlerësimin e pjesëmarrjes në zgjedhje të personave me aftësi të kufizuar. Janë identifikuar disa pyetje, që ofrojnë një strukturë për mbledhjen e të dhënave dhe për analizat e mëvonshme nga ekipi bazë i misioneve të ODIHR-it. Misionet, më pas, duhet të identifikojnë çështjet kryesore që duhet të theksohen në raportet publike dhe të bëjnë rekomandimet përkatëse.

Çështjet dhe pyetjet e identifikuara më poshtë trajtojnë një sërë fushash ku duhet të fokusohen vëzhguesit e ODIHR-it në faza të ndryshme të ciklit zgjedhor. Siç është standard për aktivitetet e ODIHR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve, informacioni mblidhet përmes ekipit bazë të ekspertëve në kryeqytet dhe nga vëzhguesit afatgjatë në rajone dhe, më pas, i nënshtrohet verifikimit dhe analizës. Duke pasur parasysh kufizimet në kohë dhe në burimet ekzistuese, si dhe çështjet e shumta zgjedhore që duhet të mbulojnë misionet, mund të mos jetë e mundur që të mbulohen të gjitha çështjet e identifikuara gjatë misionit, që do të thotë se ato që duhet të shqyrtohen duhet të jenë çështjet më kryesore.

A. Periudha parazgjedhore

Kjo pjesë trajton çështjet që duhet të shqyrtojnë vëzhguesit e ODIHR-it gjatë periudhës parazgjedhore. Ajo fokusohet në instrumentet ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti përkatës dhe tek legjislacioni vendas, si dhe tek administrimi i zgjedhjeve, fushatat dhe partitë politike. Gjithashtu, fokusohet në masën në të cilën ekzistojnë kushtet mundësuere, të dhënat e detajuara, konsultimin me OPAK-të dhe informacionet për zgjedhjet në formate të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuar, si dhe nëse ka kufizime të zotësisë juridike të personave me aftësi të kufizuar.

Statusi i instrumenteve ndërkombëtare

Misionet për vëzhgimin dhe vlerësimin e zgjedhjeve duhet që, së pari, të kontrollojnë nëse një shtet e ka ratifikuar apo aderon në KDPAK. Dokumenti Përmbyllës i OSBE-së i Takimit të Vjenës të vitit 1989 i referohet nevojës për shqyrtimin nga shtetet pjesëmarrëse të mundësisë së aderimit në PNDCP dhe në “instrumente të tjera të rëndësishme ndërkombëtare, nëse nuk e kanë bërë këtë gjë akoma”.⁴⁰ Kështu, në kuadër të aktiviteteve për vëzhgimin e zgjedhjeve, ODIHR-i e ka si praktikë që t’u rekomandojë vendeve që nuk janë ende shtet palë në këtë. Konventë ta ratifikojnë atë, ndërsa shteteve palë u rekomandon të tërheqin çdo rezervë që mund të cenojë të drejtat e parashikuara në nenin 29. Rezervat, që janë në thelb kushte të një shteti për aderimin në një traktat, shprehen në momentin e ratifikimit/aderimit dhe duhet të jenë specifike dhe jo në kundërshtim me objektin dhe qëllimin e Konventës.⁴¹ Deklaratat, edhe pse nuk i kufizojnë efektet ligjore të një traktati, de facto mund të kenë efekt të ngjashëm me rezervën.⁴² Shteti nënshkrues, që ende nuk e ka ratifikuar traktatin, duhet të ndjekë objektin dhe qëllimin e tij, edhe pse ende nuk ka detyrim ligjor për ta zbatuar.⁴³ Me ratifikimin e KDPAK-së, legjislacioni vendas duhet të përputhet me këtë Konventë dhe të parashikojë promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të përcaktuara në atë Konventë.

Nëse një shtet e ka ratifikuar/është anëtarësuar në KDPAK, ai do të duhet të raportojë sipas një kalendarit të caktuar dhe Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara i përgjigjet me vërejtje përmbyllëse, përfshirë edhe sugjerime dhe rekomandime. Përveç raporteve të paraqitura nga vendet përkatëse, mund të paraqiten edhe raporte të tjera alternative ose raporte jozyrtare (këto janë raporte të shoqërisë civile të cilat, përkatësisht, mund të zëvendësojnë ose t’u shtohen raporteve shtetërore). Këto dokumente ofrojnë informacion zyrtar për situatën e zbatimit të marrëveshjes dhe nevojës për përmirësim të ardhshme.

40 Dokumenti Përmbyllës i Takimit të Vjenës, 1989, paragrafi 13.2. Mund të gjendet në: <http://www.osce.org/mc/40881?download=true>.

41 Konventa e Vjenës për Ligjin mbi Traktatet, 1969, neni 2(1)(d): “deklaratat e njëanshme, pavarësisht se si janë formuluar apo quajtur, të bëra nga një shtet, në momentin e nënshkrimit, ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit në një traktat, me anë të të cilave shteti zotohet të përjashtojë apo të modifikojë efektet juridike të dispozitave të caktuara të traktatit mbi mënyrën se si do ta zbatojë ai shtet traktatin”.

42 Udhëzuesi i Kombeve të Bashkuara për Traktatet shprehet se: “Shteti mund të bëjë një deklaratë në lidhje me mënyrën se si e kupton ai një çështje që përfshihet në një dispozitë të caktuar të traktatit apo në shpjegimin e saj. Deklaratat interpretuese të këtij lloji, ndryshe nga rezervat, nuk kanë për qëllim të përjashtojnë apo të modifikojnë efektet ligjore të një traktati. Qëllimi i një deklaratë interpretuese është të qartësojë kuptimin e dispozitave të caktuara ose të të gjithë traktatit.” Mund të gjendet në:

<https://treaties.un.org/doc/source/publications/THB/English.pdf>.

43 Konventa e Vjenës për Ligjin mbi Traktatet, 1969.

#	Pyetje	Eksperti drejtues i misionit të vëzhgimit
1	A e ka ratifikuar apo a është anëtarësuar shteti në KDKPAK dhe, nëse po, a ka shprehur ai ndonjë rezervë apo ka bërë deklaratë në lidhje me pjesëmarrjen në zgjedhje (në veçanti, për nenet 29, 9 dhe 12)? A e ka ratifikuar apo a është anëtarësuar shteti në Protokollin Fakultativ të KDKPAK-së? A e ka ratifikuar apo aderon shteti në konventa të tjera përkatëse? A janë bërë ndryshime në legjislacionin vendas pas ratifikimit dhe a kanë qenë këto ndryshime në përputhje me detyrimet e shtetit?	Analisti ligjor
2	A ka raportuar shteti në Komitetin për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara për çështje që lidhen me pjesëmarrjen në zgjedhje? A janë paraqitur raporte jozyrtare ose alternative? Cilat kanë qenë vërejtjet përmblylëse të Komitetit në lidhje me pjesëmarrjen në zgjedhje të personave me aftësi të kufizuara? A ka raportuar shteti në organe të tjera monitoruese të traktateve të ndryshme për çështje që lidhen me pjesëmarrjen në zgjedhje të personave me aftësi të kufizuara, për shembull, në Këshillin e OKB-së për të Drejtat e Njeriut apo në Komitetin për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW)?	Analisti ligjor

Kuadri ligjor dhe kërkesat e përgjithshme të aksesueshmërisë

Shumë pak shtete pjesëmarrëse të OSBE-së kanë legjislacion, që i referohet në mënyrë specifike pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuara në jetën politike dhe publike. Po kështu, janë të pakta vendet që përkufizojnë çfarë do të thotë projektim i pamjaftueshëm universal dhe mungesë modifikimesh të arsyeshme si forma diskriminimi. Prandaj, misionet e ODIHR-it duhet të rishikojnë dhe të analizojnë legjislacionin vendas sa u përket dispozitave për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara.

Krijimi i kushteve mundësuese nënkupton ngritjen e strukturave bazë për promovimin e pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuara në shoqëri në përgjithësi. Kjo përfshin një kuadër ligjor që promovon të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe dispozita për aksesueshmërinë, përfshirë edhe ndërtesat, mjedisin e ndërtuar (hapësirën e ndërtuar nga dora e njeriut në vendet ku njerëzit jetojnë, punojnë dhe rikrijojnë në jetën e tyre të përditshme) dhe informacionin në përgjithësi. Kjo është veçanërisht e rëndësishme, pasi qendrat e votimit zakonisht vendosen në ambiente publike ose shtetërore.

Kërkesat e përgjithshme lidhur me aksesueshmërinë në ndërtesa dhe informacion kontribuojnë për krijimin e një mjedisi më të favorshëm për pjesëmarrjen në zgjedhje. Sipas nenit 9 të KDKPAK-së për aksesueshmërinë, shtetet janë të detyruara “të marrin masat e duhura për t’u siguruar akses personave me aftësi të kufizuara, njësoj si të tjerët,” në “mjedisin fizik..., informacion dhe komunikim”. Më tej, neni 9 u referohet shprehimisht masave të duhura “Për të zhvilluar, miratuar dhe monitoruar zbatimin e udhëzimeve dhe standardeve minimale në lidhje me aksesin ndaj lehtësive dhe shërbimeve të hapura apo të ofruara për publikun”. Këto masa mund të përfshijnë parkim të dedikuar për automjetet, rampat, tualetet ku mund të përdoret karrocë invalidi, shenja në dhoma/salla dhe sinjalistika orientuese. Shtetet duhet

“t’u sigurojnë personave me aftësi të kufizuar akses ndaj informacionit lidhur me mjetet ndihmëse lëvizëse, pajisjet dhe teknologjitë ndihmëse, përfshirë edhe teknologjitë e reja, si edhe forma të tjera asistence, shërbimesh mbështetëse dhe lehtësirash”.⁴⁴

Kuptohet që kërkesat ligjore për informacione të aksesueshme përmes formateve të shumëllojshme vlejnë edhe për zgjedhjet, duke pasur parasysh se sa e rëndësishme është që kandidatët dhe zgjedhësit të jenë në gjendje të marrin dhe të japin informacion. KDPAK-ja i referohet gjuhës së shenjave, shfaqjes së tekstit, alfabetit Braille, komunikimit me prekje, përdorimit të shkronjave të mëdha dhe multimediave të aksesueshme, si dhe formateve të komunikimit me shkrim, në audio, lehtësisht të lexueshme, me anë të leximit nga një person ndihmës dhe atyre shtesë dhe alternative. Sigurimi i informacioneve në formate të tilla mund të kërkohet nga administrata zgjedhore, gjyqësori, mediat e financuara nga fondet publike, partitë politike dhe/ose organizatat e shoqërisë civile.

Për aksesueshmërinë e përmbajtjes në internet janë përcaktuar udhëzime ndërkombëtare në standardet e Udhëzuesit për Aksesueshmërinë së Materialeve në Internet (UAMI), publikuar nga Konsorciumi Botëror i Internetit (W3C), organizata kryesore ndërkombëtare për standardet e internetit.⁴⁵ Këto udhëzime tregojnë se si mund të bëhet më e aksesueshme përmbajtja e internetit për një sërë personash me aftësi të kufizuar dhe për të gjithë përdoruesit e internetit. Versioni aktual, WCAG 2.0 është publikuar në dhjetor të vitit 2008. Duhet të merren parasysh edhe standardet e aksesueshmërisë për mediat audio-vizuale publike dhe private.

KDPAK, neni 2 – Përkufizimet

“Komunikimi” përfshin gjuhët, shfaqje të tekstit, alfabetin Braille, komunikimin me prekje, shkronjat e mëdha, multimediat e aksesueshme, si edhe mënyrat, mjetet dhe format e komunikimit në audio, të shkruar, në gjuhë të qartë, me anë të leximit nga një person ndihmës dhe në ato shtesë dhe alternative, përfshirë edhe informacion dhe teknologji komunikimi të aksesueshëm.

“Gjuha” përfshin gjuhën e folur dhe të shkruar si dhe format e tjera të gjuhëve që nuk fliten;

“Përshtatshmëria e arsyeshme” do të thotë modifikim i nevojshëm dhe i përshtatshëm që nuk vendos ndonjë barrë shpërpjestimore apo të panevojshme, aty ku duhet në raste të veçanta, për t’u siguruar personave me aftësi të kufizuar gëzimin ose ushtrimin, në baza të barabarta me të tjerët, e të gjitha të drejtave të njeriut dhe lirive themelore;

“Projektim universal” do të thotë projektim i produkteve, mjedisit, programeve dhe shërbimeve që të jenë të përdorshme nga të gjithë njerëzit, sa më shumë që të jetë e mundur, pa pasur nevojë për përshtatje ose projekte të veçanta. “Projektimi universal” nuk duhet të përjashtojë pajisjet ndihmëse për grupe të veçanta të personave me aftësi të kufizuar, aty ku është e nevojshme.

44 KDPAK, neni 4.1(h).

45 <https://www.w3.org/TR/WCAG20/>.

KDPAK, neni 9 - Aksesit

1. Me qëllim që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të mund të jetojnë në mënyrë të pavarur dhe të marrin pjesë plotësisht në të gjitha aspektet e jetës, shtetet palë do të marrin masat e duhura për të siguruar që personat me aftësi të kufizuar, ashtu si gjithë të tjerët, të kenë akses në ambientet fizike, ndaj transportit, informacionit dhe komunikimit, përfshirë edhe teknologjitë dhe sistemet e informacionit dhe komunikimit, si dhe ndaj lehtësive apo shërbimeve të tjera të hapura apo të ofruara për publikun, si në zonat urbane ashtu edhe në ato rurale.
 2. Shtetet palë duhet të marrin masat e duhura gjithashtu:
 - (a) për të zhvilluar, miratuar dhe monitoruar zbatimin e udhëzimeve dhe standardeve minimale në lidhje me aksesin ndaj lehtësive dhe shërbimeve të hapura apo të ofruara për publikun;
 - (b) për të siguruar që subjektet private, që ofrojnë lehtësi dhe shërbime të hapura apo të ofruara për publikun, të marrin parasysh të gjitha aspektet e aksesit për personat me aftësi të kufizuar;
 - (c) për të ofruar trajnim për aktorët e interesit lidhur me problemet, që kanë të bëjnë me aksesin për personat me aftësi të kufizuar;
 - (d) për të siguruar që ndërtesat dhe objektet e tjera publike të përmbajnë shenja në alfabetin Braille dhe në forma lehtësisht të lexueshme dhe të kuptueshme;
 - (e) për të siguruar forma asistence të drejtpërdrejtë dhe të ndërmjetme, përfshirë edhe guida, lexues dhe interpretë profesionistë të gjuhës së shenjave, për të mundësuar aksesin në ndërtesa dhe objekte të tjera të hapura për publikun;
 - (f) për të inkurajuar forma të tjera të përshtatshme të asistencës dhe mbështetjes për personat me aftësi të kufizuar, për t'u siguruar atyre akses ndaj informacionit;
 - (g) për të nxitur aksesin e personave me aftësi të kufizuar ndaj sistemeve e teknologjive të reja të informacionit dhe komunikimit, përfshirë dhe internetin;
 - (h) për të promovuar projektimin, zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e sistemeve dhe teknologjive të aksesueshme të informacionit dhe komunikimit në një fazë të hershme, në mënyrë që këto teknologji dhe sisteme të bëhen të aksesueshme me një kosto minimale.
-

#	Pyetje	Eksperti drejtues i misionit të vëzhgimit
3	A ka ndonjë strategji kombëtare apo plan veprimi për personat me aftësi të kufizuar, që përfshin të drejtën për pjesëmarrje politike? A ekziston ndonjë mekanizëm për monitorimin e zbatimit të strategjisë kombëtare/planit të veprimit dhe a është procesi konsultativ? A bëhet raportim publik?	Analisti ligjor
4	A ka standarde të përgjithshme ligjore për aksesueshmërinë e informacionit? A zbatohen standardet ligjore për aksesueshmërinë edhe për administratën zgjedhore, partitë politike dhe organizatat e shoqërisë civile? A ka standarde ligjore për aksesueshmërinë për ofruesit privatë dhe publikë të informacioneve publike në internet? A ka standarde ligjore për aksesin në mediat audio-vizuale publike dhe private?	Analisti ligjor
5	A ka standarde të përgjithshme ligjore për aksesin në ndërtesa dhe në infrastrukturë në përgjithësi? A zbatohen ato për administratën zgjedhore, partitë politike dhe shoqërinë civile? A ka standarde të detyrueshme për aksesin në ndërtesat e institucioneve qendrore dhe vendore?	Analisti ligjor
6	A ka dispozita të qarta ligjore lidhur me pjesëmarrjen në zgjedhje të personave me aftësi të kufizuar? A ka dispozita të qarta ligjore për mosdiskriminimin lidhur me pjesëmarrjen në zgjedhje të personave me aftësi të kufizuar? A janë përcaktuar projektimi universal i pamjaftueshëm dhe mohimi i përshtatjes së arsyeshme si forma diskriminimi në legjislacionin e brendshëm?	Analisti ligjor

Të dhënat e ndara

KDPAK-ja përcakton kërkesa specifike për ndarjen dhe shpërndarjen e të dhënave. Megjithatë, në të gjitha vërejtjet përmbyllëse të tij që nga viti 2011, Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara ka shprehur shqetësime për mungesën apo nivelin e ulët të të dhënave të besueshme të ndara lidhur me aftësinë e kufizuar, dhe ka vënë në dukje edhe mungesën e ndarjes së të dhënave sipas gjinisë.⁴⁶ Komiteti thekson edhe se të dhënat e mbledhura nuk arrijnë të tregojnë larminë e personave me aftësi të kufizuar. Në kontekstin e zgjedhjeve, është e rëndësishme që të sigurohen të dhëna të ndara - si për shembull, për regjistrimin dhe pjesëmarrjen në zgjedhje të personave me aftësi të kufizuar, në mënyrë që të vlerësohet pjesëmarrja e tyre në votim. Të dobishme mund të jenë edhe të dhënat për numrin e personave me aftësi të kufizuar që janë regjistruar si kandidatë, si dhe numrin e personave me aftësi të kufizuar që janë anëtarë të komisioneve zgjedhore të çdo niveli.

Mungesa e të dhënave të ndara lidhur me aftësinë e kufizuar shihet si një nga pengesat kryesore për hartimin e politikave të përshtatshme për trajtimin e problemeve thelbësore dhe marrjen e masave bazuar në nevoja. Komiteti i KDPAK-së rekomandon që shtetet “të përditësojnë dhe të mbledhin të dhëna dhe statistika për personat me aftësi të kufizuar, të ndara sipas moshës,

46 Që nga viti 2011, Komiteti ka miratuar vërejtje përmbyllëse sa i takon BE-së dhe 47 shteteve palë në Konventë, përfshirë 18 shtete pjesëmarrëse të OSBE-së.

gjinisë, llojit të aftësisë së kufizuar, përkatësisë etnike dhe vendndodhjes gjeografike, përfshirë edhe llojin e vendbanimit apo sistemimit në institucione, rastet e raportuara për diskriminim dhe/ose dhunë ndaj këtyre personave, duke ndjekur një qasje të bazuar në të drejtat e njeriut. Gjatë zhvillimit të këtyre proceseve, Komiteti rekomandon që çdo shtet palë të angazhohet në mënyrë domethënëse me organizatat e personave me aftësi të kufizuar.⁴⁷ Në vitin 2011, Zyra e Komisionerit të Lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut (ZKLDNJ) vuri në dukje se “vetëm pak shtete të anketuara mbledhin informacion statistikor mbi përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar në jetën politike dhe publike”.⁴⁸

Mbledhja e të dhënave të ndara për aftësinë e kufizuar është e vështirë. Falë të drejtës për respektimin e jetës private, askush nuk mund të detyrohet të tregojë statusin e vet të aftësisë së kufizuar. Metodologjitë klasike të mbledhjes së të dhënave, siç janë intervistat derë më derë, me telefon dhe internet, mund të përjashtojnë në mënyrë shpërpjesëtimore personat me aftësi të kufizuar të ndryshme, për shembull, personat e sistemuar në institucione apo personat me aftësi të kufizuar dëgjimore ose intelektuale. Edhe më e vështirë është mbledhja e të dhënave për personat me aftësi të kufizuar psikosociale apo të tjera “të padukshme”, për shembull, për shkak të paragjyqimeve mbizotëruese në shoqëri. Për më tepër, mbledhja e të dhënave për aftësinë e kufizuar mbart ndjeshmëri dhe mund të bëhet objekt manipulimi, ndërsa shifrat bazuar në vëzhgime janë të kufizuar për faktin se bazohen vetëm te personat me aftësi të kufizuar që janë të dukshme.

Në këtë drejtim, rekomandohen gjerësisht pyetjet e sugjeruara nga Grupi i Uashingtonit, një Komision i OKB-së për Statistikat, i përbërë nga përfaqësues të zyrave kombëtare të statistikave. Thelbi i këtyre pyetjeve konsiston më tepër te funksionaliteti që mund të kufizojë pjesëmarrjen sesa te klasifikimi i aftësisë së kufizuar.⁴⁹ Për shembull, pyetjet si: “A përdor personi aparat dëgjimi? A ka personi vështirësi në ecje apo në ngjitjen e shkallëve?”. Administrata zgjedhore mund të inkurajohet të mbledhë më shumë informacion për llojet e përshtatshmërisë që kanë nevojë zgjedhësit, sesa për llojin e aftësisë së kufizuar. Kjo do të çojë në vetë-identifikimin e më shumë individëve dhe mbledhjen e të dhënave më të dobishme.

KDPAK, neni 31 – Statistikat dhe grumbullimi i të dhënave

1. Shtetet palë marrin përsipër të mbledhin informacionin e duhur, përfshirë edhe të dhëna statistikore dhe kërkimore, për të bërë të mundur që ato të hartojnë dhe zbatojnë politika për të vënë në jetë këtë Konventë. Procesi i mbledhjes dhe ruajtjes së këtij informacioni:

- (a) duhet të jetë në përputhje me masat mbrojtëse ligjore, përfshirë edhe ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, për të siguruar konfidencialitetin dhe respektimin e jetës private të personit me aftësi të kufizuar;

47 Vërejtjet përmbyllëse, Serbi (CRPD/C/SRB/CO/1).

48 Paragrafi 63. Studim tematik i Komisionerit të Lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut “Mbi pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuar në jetën politike dhe publike”, 2011. Gjetet në: http://www.ohchr.org/Documents/HRBodies/HRCouncil/RegularSession/Session19/A-HRC-19-36_en.pdf.

49 Grupi i Uashingtonit punon për hartimin e metodave, që përmirësojnë statistikën për personat me aftësi të kufizuar në nivel global, me kontributin e ekspertëve dhe agjencive të ndryshme ndërkombëtare, ku përfshihen agjencitë e OKB-së, agjencitë e ndihmës dypalëshe, OJQ-të, organizatat e personave me aftësi të kufizuar, si dhe studiuesit. Për më tepër, shih: <http://www.washingtongroup-disability.com/>.

(b) duhet të jetë në përputhje me normat ndërkombëtare të pranuar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, si edhe me parimet etike për mbledhjen dhe përdorimin e statistikave.

2. Informacioni i mbledhur sipas këtij neni do të ndahet në të dhëna, sipas rastit, dhe do të përdoret për t'u ardhur në ndihmë shteteve palë në vlerësimin e zbatimit të detyrimeve të tyre që rrjedhin nga Konventa, si edhe për të identifikuar dhe eliminuar pengesat me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuar gjatë ushtrimit të të drejtave të tyre.

3. Shtetet palë marrin përgjegjësinë për shpërndarjen e këtyre statistikave dhe sigurojnë që ato të jenë të aksesueshme nga personat me aftësi të kufizuar dhe nga të tjerët.

#	Pyetje	Eksperti drejtues i misionit të vëzhgimit
7	A ka kërkesa ligjore për ndarjen e të dhënave zgjedhore sipas aftësive të kufizuar të ndryshme dhe gjinisë? Për shembull, për zgjedhësit, kandidatët dhe të zgjedhurit. A është e detyrueshme bërja publike e këtyre të dhënave? A ka dispozita për mbrojtjen e të dhënave dhe, nëse po, si interpretohen ato në lidhje me detyrimet e KDPAK-së?	Analisti ligjor
8	A ka të dhëna zgjedhore të ndara sipas aftësive të kufizuar? Për shembull, për zgjedhësit, kandidatët dhe të zgjedhurit. A janë të dhënat të ndara edhe sipas gjinisë? A besojnë njerëzit tek të dhënat dhe, nëse jo, cilat ishin arsytet e përmendura?	Analisti zgjedhor

Konsultimi dhe përfshirja

Për një kohë të gjatë, personat me aftësi të kufizuar kanë bërë fushatë për t'u përfshirë në marrjen e vendimeve që ndikojnë në jetën e tyre. KDPAK-ja kërkon në nenin 4.3 që shtetet palë "të këshillohen nga afër me personat me aftësi të kufizuar dhe t'i përfshijnë ata në mënyrë aktive". Kjo nënkupton angazhim me organizatat e formuara nga vetë personat me aftësi të kufizuar dhe jo thjesht konsultim vetëm me organizatat e prindërve dhe kujdestarëve apo me organizatat e formuara nga të tjerë për personat me aftësi të kufizuar. Komiteti i KDPAK-së thekson nevojën për të garantuar që "mekanizmat për lehtësimin e ndihmesës në votim të krijohen në konsultim të ngushtë me OPAK-të, me qëllim që t'u përshtaten nevojave të tyre".⁵⁰

Në hartimin e metodologjisë për vëzhgimin e zgjedhjeve, ODIHR-i i kushton vëmendje të veçantë përfshirjes së grupeve të papërfaqësuar sa duhet në politikë. Udhëzuesi i ODIHR-it për Ndjekjen e Zbatimit të Rekomandimeve për Zgjedhjet i vitit 2016 shprehet se: "përfshirja në procesin zgjedhor e grupeve të papërfaqësuar sa duhet në politikë, duhet të jetë domethënëse dhe jo sipërfaqësore. Kjo nënkupton që duhet punuar me grupe me përfaqësim të gjerë, duke iu dhënë informacion paraprakisht për të kuptuar qartë çështjet dhe alternativat, si dhe mundësinë për të bërë pyetje dhe sugjerime. Këto konsultime duhet të jenë periodike, dhe jo vetëm një herë, dhe duhen të dokumentohen publikisht."⁵¹

50 Vërejtjet përmbyllëse, Suedi, 2014 (CRPD/C/SWE/CO/1).

51 Udhëzues për Ndjekjen e Zbatimit të Rekomandimeve për Zgjedhjet (Varshavë, Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut, 2016). Gjetet në: <http://www.osce.org/odihr/elections/119893>.

Shembuj të praktikave të mira në rajonin e OSBE-së

- Një akt ligjor në një shtet pjesëmarrës të OSBE-së i detyronte organet shtetërore të konsultohen dhe të bashkëpunojnë me OPAK-të në formulimin e politikave dhe masave kombëtare. Gjithashtu, akti përcaktonte përgjegjësitë e OPAK-ve në përfaqësimin e interesave të personave me aftësi të kufizuara, në caktimin e përfaqësuesve të tyre në organet shtetërore, si dhe në koordinimin me OPAK-të e tjerë. Kjo ndihmoi që personat me aftësi të kufizuara të angazhoheshin në diskutimet mbi të drejtat e tyre dhe, rrjedhimisht, në krijimin e praktikave të mira.
- Organi i administrimit të zgjedhjeve (OAZ) në një shtet pjesëmarrës të OSBE-së punoi me disa organizata të jashtme dhe me persona me aftësi të kufizuara për të dhënë informacion rreth shërbimeve të veta. Gjithashtu, u formua një grup këshillimor që ofronte ekspertizë tematike dhe këshillim për çdo nismë që kishte për objekt aksesueshmërinë. Grupi ndihmoi edhe në identifikimin e mënyrave më të mira për të informuar personat me aftësi të kufizuara se kur, ku dhe si të regjistrohen dhe të votojnë.
- Në një tjetër shtet pjesëmarrës të OSBE-së, Ministria e Brendshme dhe Ministria e Shëndetësisë ftuan OPAK-të të marrin pjesë në procesin e hartimit të ligjit mbi kushtet bazë të aksesueshmërisë dhe mosdiskriminimit që duhet të kenë ambientet, produktet dhe shërbimet e nevojshme për pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në proceset politike dhe zgjedhore. “Pjesëmarrje e plotë në jetën politike nënkupton të drejta dhe detyrime. Personat me aftësi të kufizuara duhet të ndihmohen që të marrin pjesë në të gjithë procesin, përfshirë edhe si komisionerë në qendrat e votimit”, deklaronte Ministria e Shëndetësisë, Shërbimeve Sociale dhe Barazisë.

#	Pyetje	Eksperti drejtues i misionit të vëzhgimit
9	A ka kërkesa ligjore për konsultimin me OPAK-të dhe për përfshirjen e tyre aktive në lidhje me zgjedhjet? A është e detyruar administrata zgjedhore të konsultohet në nivel qendror dhe/ose në nivel vendor? A ekziston ndonjë detyrim për mediat e financuara nga fondet publike, që të konsultohen me OPAK-të për transmetimin e informacionit për zgjedhjet?	Analisti ligjor
10	A janë konsultuar OPAK-të në ndonjë nismë për reformë legjislative? A duket se janë marrë në konsideratë qëndrimet e OPAK-ve? Nëse jo, për çfarë arsyes (nëse ka arsye)?	Analisti ligjor
11	A ka kryer administrata zgjedhore konsultime me OPAK-të dhe, nëse jo, pse? A duket se janë marrë në konsideratë qëndrimet e OPAK-ve? A është bërë kjo në nivel vendor dhe qendror? A ka administrata zgjedhore politika për personat me aftësi të kufizuara? A ka administrata zgjedhore një pikë kontakti për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara?	Analisti zgjedhor
12	A ka kryer media e financuar nga fondet publike konsultime me OPAK-të në lidhje me aksesueshmërinë e pasqyrit të fushatës dhe të informacionit zgjedhor? A duket se janë përfshirë qëndrimet e OPAK-ve?	Analisti i medias

Të drejtat e pjesëmarrjes

Heqja e të drejtave zgjedhore personave të shpallur nga gjykata si persona juridikisht të pazotë, është një pengesë e qartë legjislative për pjesëmarrjen në jetën politike. Siç u trajtua më lart, ky fakt është pranuar tashmë nga Komiteti për të Drejtat e Njeriut (organi i KDPAK-së), nga GJEDNJ-ja dhe nga Komisioni i Venecias. Sidoqoftë, KDPAK-ja ka sjellë evolucion ligjor, duke i konsideruar këto praktika si diskriminuese. KDPAK-ja thotë se personat me aftësi të kufizuara duhet të gëzojnë zotësinë juridike për të votuar dhe për të kandiduar në baza të njëjta me të tjerët, pa asnjë përjashtim. Fokusi është zhvendosur nga heqja e të drejtës së votës tek dhënia e ndihmës së nevojshme për të mundësuar vendimmarrje të asistuar. Këto dispozita prekin sidomos personat me aftësi të kufizuara psikosociale dhe intelektuale.

Në vitin 2011, ZKLDNJ-ja nxori një raport ku vinte në dukje se: “Në shumicën e vendeve që iu përgjigjën pyetësorit të ZKLDNJ-së, personat me aftësi të kufizuara psikosociale dhe pamundësi intelektuale vazhdojnë të privohen nga e drejta e votës dhe e drejta për t’u zgjedhur, në bazë të dispozitave kushtetuese ose ligjore, që lidhin të drejtat e tyre politike me zotësinë juridike... Vetëm një numër i vogël vendesh i kanë hequr të gjitha kufizimet për pjesëmarrjen politike të personave me aftësi të kufizuara psikosociale ose intelektuale... Këto kufizime pasqyrojnë një qasje të prapambetur dhe diskriminuese ndaj personave me aftësi të kufizuara dhe rolit të tyre në shoqëri, gjë që nuk përputhet me detyrimet që rrjedhin

nga KDPAK-ja”.⁵²

Në shumicën dërrmuese të shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së, e drejta e votës dhe e drejta për të kandiduar lidhet me zotësinë juridike, çka rezulton në kufizim të pjesëmarrjes gjë që është në shkëlqje të KDPAK-së. Në pak shtete pjesëmarrëse të OSBE-së nuk ka kufizime për votimin nga personat me aftësi të kufizuara, qoftë edhe për ata nën kujdestari. Po kështu, një studim i publikuar nga ADTH-ja në vitin 2014 konstatonte se vetëm 7 nga 28 shtete anëtare të BE-së garantonin të drejtën e votës për të gjithë njerëzit, pavarësisht aftësisë së kufizuar. Në 15 vende nuk lejohej votimi për personat me aftësi të kufizuara të cilët janë shpallur me pazotësi juridike. Në vendet ku aplikohen këto kufizime, e drejta e votës kufizohet ose automatikisht si rezultat i zotësisë juridike të kufizuar ose pas një vlerësimi individual të aftësisë së personit për të votuar.

Heqja e zotësisë juridike shpesh përfshin edhe heqjen e mundësisë për të bërë ankim apo apelim. Raporti i ADTH-së i vitit 2014 konstatonte se në 19 vende të BE-së vetëm personat me zotësi juridike kishin akses në mekanizmat e ankimit lidhur me të drejtat e pjesëmarrjes politike. Kështu, në këto juridiksione, personat me aftësi të kufizuara, që janë privuar nga zotësia juridike nuk kanë akses të pavarur apo të drejtpërdrejtë në mekanizmat juridike (përfshirë institucionet jogyqësore, si p.sh.: institucionet vendase për të drejtat e njeriut dhe organet e barazisë).

Shembull i praktikës së mirë në rajonin e OSBE-së

Dispozitat ligjore parashikojnë vendimmarrje të asistuar, që shërben që personat me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në mënyrë sa më të plotë që të jetë e mundur dhe u mundëson për aq sa është e mundur që të shprehin vullnetin dhe preferencat e tyre të mëparshme ose të tashme (pa iu referuar “interesave më të mira”). Ligji në këtë shtet pjesëmarrës të OSBE-së parashikon një marrëveshje për vendimmarrje të asistuar, ku personi cakton një “ndihmës në vendimmarrje” që ta mbështesë atë. Ndihmësi nuk ka të drejtë të marrë vendime në emër të personit, por, nga ana tjetër, mund të marrë informacion, të këshillojë, të konstatojë vullnetin dhe preferencat e personit, ta asistojë personin që të shprehë vendimet e tij/saj dhe të përpiqet të garantojë zbatimin e vendimeve të personit. Marrëveshja mund të zgjidhet në çdo kohë. Ekziston edhe marrëveshja për bashkëvendimmarrje, ku bashkëvendimmarrësi mund të marrë bashkërisht një ose disa vendime.

52 Paragrafët 70, 39 dhe 43. Studim tematik i Komisionerit të Lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut “Mbi pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në jetën politike dhe publike”, 2011. Gjithashtu, paragrafi 38 përcakton se: “... në shumë vende, e drejta e pjesëmarrjes politike vazhdon të jetë e lidhur me zotësinë juridike të individit. Disa shtete kanë një dispozitë përjashtimi automatik ose thajse automatik në sistemet e tyre juridike. Ato iu mohojnë të drejtën e pjesëmarrjes politike të gjithë personave, që janë nën një masë mbrojtjeje, si p.sh.: nën kujdestari të pjeseshme dhe të plotë, pavarësisht nivelit të tyre aktual dhe/apo individual të aftësive funksionale, apo nëse kanë një aftësi të kufizuar intelektuale a një problem të shëndetit mendor. Në vende të tjera, zotësia për të votuar e personave me aftësi të kufizuara psikosociale apo intelektuale është objekt i një vlerësimi individual, që kryhet nga një profesionist i mjekësisë apo gjyqtar, që bën vlerësimin e zotësisë aktuale të individit për të votuar”. Gjetendet në:

#	Pyetje	Eksperti drejtues i misionit të vëzhgimit
13	A ka kufizime legislative ndaj pjesëmarrjes në zgjedhje (si kandidat ose si zgjedhës), që janë të lidhura me zotësinë juridike? Nëse ka kufizime, a kërkohet vendim gjykatë i veçantë për zotësinë juridike në lidhje me të drejtën e votës? Nëse legjislacioni nuk e parashikon heqjen e zotësisë juridike, a ekzistojnë mekanizma mbështetës për personat me aftësi të kufizuara që të ushtrojnë të drejtën e votës?	Analisti ligjor
14	A ka në legjislacion mekanizma ankimi dhe apelimi për personat, të cilëve iu kufizohet e drejta e votës për shkak të zotësisë juridike? A është e mundur gjithashtu të paraqitet ankesë në institucione jogjyqësore (si p.sh.: institucionet për të drejtat e njeriut, organet e barazisë etj.)?	Analisti ligjor
15	Nëse ka kufizime legislative për pjesëmarrjen në zgjedhje për shkak të zotësisë juridike, a ka statistika zyrtare për numrin e personave të prekur? A ka raporte për shpërdorimin e kufizimeve ndaj zotësisë juridike?	Analisti ligjor

Ndërgjegjësimi dhe informacioni për zgjedhjet

Në seksionin më lart për “Kushtet mundësuese”, theksohet rëndësia e ofrimit të informacionit në formate të shumëllojshme. Është e nevojshme që zgjedhësit me aftësi të kufizuara të kuptojnë procesin, të ndjekin çfarë ndodh me zgjedhjet dhe të jenë në gjendje të bëjnë ankesë, nëse është e nevojshme. Format e informacionit të aksesueshëm mund të përfshijnë materiale që janë lehtësisht të lexueshme, tekste me shkronja të mëdha, alfabetin Braille dhe materiale audiovizive (përfshirë edhe shpjegimin në gjuhën e shenjave). Edhe administrata zgjedhore dhe mediat kanë përgjegjësinë për të rritur ndërgjegjësimin për pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara dhe për luftën ndaj stereotipave, duke promovuar kështu pjesëmarrjen politike.

Sa i përket zbatimit të nenit 29 të Konventës, Komiteti i KDDPAK-së thekson nevojën për të garantuar që “informacioni për zgjedhjet të ofrohet në formate të aksesueshme” dhe që “edukimi i zgjedhësve përmes mjeteve të komunikimit masiv të jetë i aksesueshëm”.⁵³ Mediat e financuara nga fondet publike kanë përgjegjësinë e veçantë të promovojnë përmbushjen e detyrimeve të KDDPAK-së. Prandaj, një misioni vëzhgimi të zgjedhjeve i duhet të shqyrtojë se çfarë po bëjnë këto media për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të luftuar stereotipat. Mediave private, edhe pse nuk e kanë këtë detyrim, mund t’u kërkohet të jenë të aksesueshme. Disa media private mund të zgjedhin që ta vënë në dispozicion përmbajtjen në formate të ndryshme, me qëllim që të luftojnë në mënyrë aktive stereotipat dhe të rrisin përfshirjen e aftësisë së kufizuara.

53 Vërejtjet përmbyllëse, Suedi, 2014 (CRPD/C/SWE/CO/1).

Shembuj të praktikave të mira në rajonin e OSBE-së

- Autoriteti zgjedhor në një shtet pjesëmarrës të OSBE-së shfaqte në faqen e vet të internetit klipe televizivë rreth sistemit zgjedhor dhe votimit, me shpjegim në gjuhën e shenjave. Informacioni për partitë politike dhe kandidatët transmetohej në televizionin publik dhe privat. Media shtetërore i bëri programet e saj të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuar, duke shtuar titra, tekst të folur, shpjegimin në gjuhën e shenjave dhe përshkrime në audio të programeve.
- Qeveria në një shtet pjesëmarrës të OSBE-së publikoi një udhëzues lehtësisht të lexueshëm në lidhje me votimin dhe procedurat e regjistrimit. Udhëzuesi u përgatit nga një shoqatë që përfaqëson dhe mbështetet personat me aftësi të kufizuar në mësimnxënie. Shoqata përgatiti edhe një version lehtësisht të lexueshëm të programeve të partive politike që garonin në zgjedhje. Gjithashtu, komisioni zgjedhor, në bashkëpunim me këtë shoqatë, publikoi një tabelë informative të përbashkët për zgjedhjet ku zgjedhësit me aftësi të kufizuar informoheshin rreth të drejtave të tyre.

#	Pyetje	Eksperti drejtues i misionit të vëzhgimit
16	A ofron administrata zgjedhore informacion sipas standardeve të aksesueshmërisë dhe në formate të ndryshme, përfshirë edhe materialet lehtësisht të lexueshme dhe ato në format me shkronja të zmadhuara, shabllone në alfabetin Braille për votim, si dhe me shpjegim në gjuhën e shenjave? A disponohet ky informacion si në nivel vendor, ashtu dhe në nivel qendror? A e përfshin edukimin e zgjedhësve? A jep informacion mbi mjediset zgjedhore të aksesueshme? A përditësohet informacioni me veprimtaritë e përgjithshme zgjedhore (si p.sh.: deklaratat për shtyp, njoftimet dhe të dhënat)? Cilat janë pikëpamjet e OPAK-ve lidhur me dispozitat për informimin?	Analisti zgjedhor
17	A ofron media e financuar nga fondet publike informacion për zgjedhjet në përputhje me standardet e aksesueshmërisë në formate të ndryshme? Nëse po, a e mbulon ajo edukimin e zgjedhësve dhe informimin për fushatën? A kanë kandidatët me aftësi të kufizuar akses të njëjtë në media me kandidatët e tjerë? Cilat janë pikëpamjet e OPAK-ve rreth ofrimit të informacionit nga media të financuara nga fondet publike? Po në lidhje me mediat private?	Analisti i medias

Administrata zgjedhore

Procedura aktive e regjistrimit të zgjedhësve mund të rezultojë barrë e tepruar për personat me aftësi të kufizuar, aq më shumë për personat e sistemuar në institucione nëse nuk merren masa të veçanta. Edhe regjistrimi pasiv i zgjedhësve, bazuar në regjistrin e gjendjes civile, mund të sjellë sfida shpërpjesëtimore në regjistrimin dhe marrjen e dokumenteve të nevojshme të identifikimit. Të regjistruarve me aftësi të kufizuar mund edhe t'u kërkohet të deklarojnë aftësinë e kufizuar, në mënyrë që administrata zgjedhore të jetë në dijeni të shërbimeve që duhet t'u ofrojë.

Po kështu, aksesit në procesin e caktimit të kandidatëve mund të jetë de facto i vështirë nëse, për shembull, dokumentet e caktimit të kandidatëve duhet të dorëzohen personalisht në kushtet kur mungojnë standardet e aksesueshmërisë. Gjithashtu, caktimi si kandidat dhe kandidimi për një person me aftësi të kufizuar, për të cilat nevojitet mbështetje shtesë, mund të rezultojë i vështirë në një shoqëri ku mbizotërojnë qëndrime negative ndaj aftësisë së kufizuar.

Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara thekson nevojën për të garantuar që “ndihmësit në qendrat e votimit të jenë të trajnuar për të ndihmuar votuesit”.⁵⁴ Gjithashtu, personeli i administratës zgjedhore i të gjitha niveleve ka nevojë për trajnim me qëllim që të mbështesë pjesëmarrjen në zgjedhje të personave me aftësi të kufizuar. Neni 4 i KDKPAK-së, mbi detyrimet e përgjithshme, angazhon shtetet palë që “të nxisin trajnimin e profesionistëve dhe personelit, që punon me personat me aftësi të kufizuar, në lidhje me të drejtat e njohura në këtë Konventë”. Neni 9, për aksesueshmërinë, i referohet edhe ofrimit të “trajnitimit për palët e interesuara mbi problematikën e aksesueshmërisë me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuar”.

Shembull i praktikës së mirë në rajonin e OSBE-së

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në një shtet pjesëmarrës të OSBE-së punësoi për zgjedhjet parlamentare katër persona me aftësi të kufizuar në qendrën e tij telefonike të shërbimit ndaj votuesve. Një nga personat e punësuar ishte i/e verbër dhe administrata zgjedhore krijoi kushtet e nevojshme që punonjësi të kryente detyrat e kërkuara në mënyrë të pavarur. Gjithashtu, gjatë procesit të punësimit, Komisioni mori masa për përmirësimin e kualifikimeve dhe rritjen e kapaciteteve për personat me aftësi të kufizuar.

54 Vërejtjet përmblylëse, Suedi, 2014 (CRPD/C/SWE/CO/1).

#	Pyetje	Eksperti drejtues i misionit të vëzhgimit
18	A është i vështirë procesi i regjistrimit të zgjedhësve për personat me aftësi të kufizuar të ndryshme, duke rrezikuar kështu akses të reduktuar? A ka pengesa për marrjen e mjetit të identifikimit, duke rrezikuar kështu akses të reduktuar? A ka ndonjë masë e posaçme për regjistrimin si zgjedhës të personave me aftësi të kufizuar?	Analisti zgjedhor
19	A është i vështirë procesi i caktimit të kandidatëve për personat me aftësi të kufizuar të ndryshme (duke rrezikuar kështu akses të reduktuar)? A ofrohet mbështetje shtesë për personat me aftësi të kufizuar për t'u regjistruar si kandidatë?	Analisti zgjedhor
20	A kryen administrata zgjedhore trajnime efektive mbi përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar? A theksohen të drejtat e personave me aftësi të kufizuar? A shpjegohen problematikat kyçe, si aksesueshmëria në shërbime, ndihma nga një person i zgjedhur nga vetë zgjedhësi, si dhe disponueshmëria e informacionit? A është trajnuar administrata zgjedhore për OPAK-të dhe a ka ajo programe për edukimin e zgjedhësve?	Analisti zgjedhor

Fushatat zgjedhore dhe partitë politike

Personat me aftësi të kufizuar duhet të jenë në gjendje të marrin informacion nga partitë dhe kandidatët dhe të jenë pjesëmarrës në aktivitetet e fushatave të tyre, me qëllim që të bëjnë zgjedhje të mbështetura tek informacioni. Kandidatët me aftësi të kufizuar duhet të kenë kushtet e duhura për të bërë fushatë, me qëllim që të kenë mundësi të barabarta garimi në zgjedhje. Paragjykimet shoqërore mund ta vështirësojnë shumë garimin e tyre si kandidatë, p.sh.: ekziston rreziku që personat me aftësi të kufizuar të stigmatizohen apo të vihen në shënjestër të krimeve për shkak të urrejtjes.⁵⁵ Gjithashtu, personat me aftësi të kufizuar mund të kenë mungesë fondesh për zhvillimin e fushatës dhe të përballen me shpenzime shtesë për shkak të aftësisë së kufizuar, p.sh.: kosto transporti shtesë apo kosto për shpjegimin në gjuhën e shenjave.

Neni 29 i KDPAK-së specifikon se shtetet palë duhet të marrin masa për të nxitur pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuar “në organizatat joqeveritare dhe shoqatat e angazhuara me jetën publike dhe politike të vendit, si edhe në aktivitetet dhe administrimin e partive politike”.

Komiteti i KDPAK-së ka rekomanduar që shtetet të lehtësojnë ndihmën për personat me aftësi të kufizuar që të garojnë si kandidatë në zgjedhjet e përgjithshme dhe vendore,⁵⁶ si dhe t'u garantohet personave të zgjedhur në funksione publike e gjithë mbështetja e nevojshme,

55 Shih, për shembull, “Krimet për shkak të urrejtjes ndaj personave me aftësi të kufizuar, raportim për krimet për shkak të urrejtjes”, OSBE/ODIHR, 2016. Gjetet në: <http://www.osce.org/odihr/290021>.

56 Vërejtjet përmbyllëse, Kroaci (CRPD/C/HRV/CO/1), Turkmekistan (CRPD/C/TKM/CO/1).

përfshirë edhe ndihmës personale.⁵⁷ Megjithatë, duket se ndihma individuale ekziston vetëm në fare pak shtete pjesëmarrëse të OSBE-së. Ndhim mund të jetë në formën e mbështetjes financiare, aksesit të barabartë në mediat shtetërore, mbështetjes për aksesueshmëri gjatë aktiviteteve të fushatës dhe/ose sigurimi i një ndihmësi.

Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara ka theksuar nevojën për të garantuar që “fushatat zgjedhore të jenë plotësisht të aksesueshme”⁵⁸ dhe ka shprehur shqetësimin për proceset zgjedhore të paaksesueshme, përfshirë edhe fushatat politike.⁵⁹

Edhe pse ndonjëherë programet e partive politike përmbajnë angazhime për të promovuar shoqëri më gjithëpërfshirëse dhe më të integruara, shpesh ato u referohen personave me aftësi të kufizuara thjesht si përfitues të shërbimeve sociale dhe ndihmës shëndetësore, dhe jo si pjesëmarrës në procesin zgjedhor.

Shembuj të praktikave të mira në rajonin e OSBE-së

- Qeveria e një shteti pjesëmarrës të OSBE-së përgatiti materiale ku promovon dhe shpjegon detyrimet ligjore për partitë politike në kuadër të KDPAK-së. Me qëllim përhapjen më të gjerë të praktikave të mira, qeveria bashkëpunoi gjithashtu me partitë politike për të analizuar politikatat e tyre ekzistuese në lidhje me aksesin e aftësisë së kufizuar.
- Me objektivin për të informuar zgjedhësit me aftësi të kufizuara në shikim, në bashkëpunim të ngushtë me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, një OJQ në një shtet pjesëmarrës të OSBE-së përgatiti informacion mbi programet e partive politike në format audio (me zë), që u publikua në faqen e internetit që informon zgjedhësit.
- Autoritetet e një shteti pjesëmarrës të OSBE-së vunë në dispozicion fonde për mbulimin e shpenzimeve shtesë që mund të kenë personat me aftësi të kufizuara kur konkurojnë si kandidatë, përfshirë, për shembull: kosto shtesë transporti dhe kosto për shpjegimin në gjuhën e shenjave.

57 Vërejtjet përmbyllëse, Suedi (KDPAK/C/SWE/CO/1).

58 Vërejtjet përmbyllëse, Suedi, 2014 (CRPD/C/SWE/CO/1).

59 Vërejtjet përmbyllëse, Portugali (CRPD/C/PRT/CO/1).

#	Pyetje	Eksperti drejtues i misionit të vëzhgimit
21	A ofrojnë partitë politike/kandidatët informacion në formate të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuar të ndryshme? Nëse po, a e bëjnë këtë të gjitha partitë apo vetëm disa? A përfshihen problematikat kryesore të fushatës dhe/ose informacioni rreth partive dhe kandidatëve?	Analisti politik
22	A u jepet mbështetje shtesë kandidatëve me aftësi të kufizuar? A ofrohen fonde shtesë për të mbuluar shpenzimet për fushatën? A i përfshijnë fushatat zgjedhore personat me aftësi të kufizuar? A janë mjediset e fushatave fizikisht të aksesueshme? A ka formate të ndryshme prezantimi (për shembull, gjuha e shenjave, titra apo materiale në format lehtësisht të lexueshëm)? A ka diskutime rreth përfshirjes së personave me aftësi të kufizuar?	Analisti politik
23	A kanë partitë/kandidatët politikë politika për promovimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar dhe/ose për pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuar në parti dhe si kandidatë? A kanë ata të dhëna për personat me aftësi të kufizuar brenda partisë? A e promovojnë ata përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar në programet e tyre? A marrin partitë politike mbështetje financiare nga shteti për të rritur pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuar në strukturat e tyre?	Analisti politik
24	A kanë mediat e financuara nga fondet publike politika apo praktika për promovimin e pjesëmarrjes së kandidatëve me aftësi të kufizuar apo për diskutimin mbi përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar në procesin e fushatës? A jep media publike informacion mbi fushatën në formate të ndryshme të aksesueshme? A i ka ndonjë media private këto politika dhe praktika? A paraqitet raportimi sipas perspektivës së bazuar në të drejta?	Analisti i medias

B. Dita e zgjedhjeve

Ky seksion shqyrton proceset e aksesueshme, mjetet ndihmëse, ndihmën nga një person i zgjedhur dhe mekanizmat alternativë të votimit. KDPAK-ja i detyron shtetet të zhvillojnë procese zgjedhore që respektojnë parimin e projektimit universal, që ato të jenë sa më të aksesueshme. Përveç kësaj, duhet bërë përshtatshmëri e arsyeshme (modifikime dhe rregullime për nevoja specifike individuale) për të mbështetur personat me aftësi të kufizuar të veçanta. Duhet marrë parasysh çështje të ndryshme, si projektimi i objekteve, procedurat e lejuara, aksesit ndaj informacionit dhe format e ndihmës së autorizuar, në mënyrë që proceset e votimit të jenë të aksesueshme nga personat me aftësi të kufizuar të ndryshme, përfshirë edhe ato shqisore, fizike, mendore dhe intelektuale.

Procese votimi të aksesueshme

Aksesueshmëria mund të shoqërohet me një shumëllojshmëri problemesh. Këto përfshijnë qendra votimi që nuk ofrojnë akses praktik të pavarur për personat me aftësi të kufizuar fizike dhe shqisore. Masat që mund të merren për të përmirësuar aksesin fizik përfshijnë sigurimin e aksesit në kate të ndryshme të ndërtesave, parkimin e dedikuar për automjetet, dyert automatike, tualetet që plotësojnë standardet e aksesueshmërisë, shenjat treguese, hapësirën për manovrimin e karrocës së invalidit, heqjen e pengesave dhe ndriçimin e mirë. Edhe aksesit ndaj informacionit mund të jetë problematik, sidomos kur mungon edukimi i zgjedhësve në formate alternative, që iu bëjnë të mundur personave me aftësi të kufizuar shqisore ose intelektuale të dijnë se si të bëjnë shënimin në fletën e votimit.

Shembull i praktikës së mirë në rajonin e OSBE-së

Legjislacioni zgjedhor në një shtet pjesëmarrës të OSBE-së parashikon që ambientet e qendrave të votimit të jenë të përshtatshme si për regjistrimin e zgjedhësve ashtu edhe për aksesueshmërinë e votuesve. Gjithashtu, Ligji për Antidiskriminimin dhe Aksesueshmërinë kërkonte që autoritetet zgjedhore të garantonin aksesueshmëri për të gjithë, pa dallim aftësie funksionale. Bashkitë porositën pajisje dhe materiale zgjedhore që plotësonin kërkesat e projektimit universal, ndërsa testimi i pajisjeve u bë nga OPAK-të. Në kuadër të këtij procesi, pajisjet e votimit, përfshirë edhe dhomat e fshehta të votimit, u prodhuan të tilla që të ishin të aksesueshme nga të gjithë.

#	Pyetje	Eksperti drejtues i misionit të vëzhgimit
25	A ka dispozita ligjore për t'i bërë të aksesueshme proceset zgjedhore përmes marrjes së të gjitha masave të nevojshme? A ka standarde ligjore për aksesueshmërinë e qendrave të votimit? A i trajtojnë këto standarde llojet e ndryshme të aftësisë së kufizuar? A ka dispozita ligjore për votimin nga persona në institucionet e kujdesit afatgjatë?	Analisti ligjor
26	A janë ndërtesat e përdorura nga autoritetet zgjedhore dhe për votim të aksesueshme nga personat me aftësi të kufizuar të ndryshme? A i përmbushin ato standardet ligjore të vendit (nëse ka të tilla)? A janë ato të aksesueshme nga personat në karrocë invalidi pa ndihmë? A mundet që personat me aftësi të kufizuar fizike të bëjnë shënim në fletën e votimit dhe të votojnë në fshehtësi, pa ndihmë? Nëse janë të aksesueshme vetëm disa qendra votimi, si ndikon kjo në pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuar?	Analisti zgjedhor
27	A disponohet informacioni për votimin në formate të aksesueshme, përfshirë edhe formate lehtësisht të lexueshme dhe me shkronja të mëdha? Nëse po, a mbulohen mjaftueshëm të gjitha udhëzimet për votimin?	Analisti zgjedhor

Mjetet ndihmëse

Mjetet ndihmëse mbështesin votuesit me aftësi të kufizuar për të bërë shënimin në fletën e votimit në mënyrë të pavarur dhe pa pasur nevojë për ndihmë. Kjo mundëson pjesëmarrje të barabartë dhe garanton fshehtësinë e votës. Përdorimi efektiv i mjeteve ndihmëse kërkon që ato të jenë të disponueshme në qendrat e votimit, që votuesit të kenë dijeni për to, që personeli të jetë trajnuar për mënyrën si përdoren ato dhe që votuesit të jenë në gjendje t'i përdorin ato me efektivitet.

Shembuj të praktikave të mira në rajonin e OSBE-së

- Një shtet pjesëmarrës i OSBE-së miratoi masa ligjore detyruese që parashikonin se çdo qendër votimi duhej të kishte të aksesueshme një shabllon në alfabetin Braille për votim dhe të paktën një dhomë të fshehtë votimi për mundësimin e votimit në alfabetin Braille.
- Në një bashki u zhvillua një projekt pilot, ku çdo qendër votimi kishte një shabllon votimi që personat me aftësi të kufizuar në shikim mund ta përdornin për të votuar pa ndihmë, edhe nëse nuk e dinin alfabetin Braille.
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në një shtet pjesëmarrës të OSBE-së, pasi shqyrtoi praktikat më të mira ndërkombëtare dhe diskutoi me organizatat që janë të angazhuara me problematikat e aftësisë së kufizuar në shikim, miratoi një fletë votimi standard për zgjedhjet, si edhe një shabllon të posaçëm për personat me aftësi të kufizuar në shikim, që u mundësonte të bënin zgjedhjen e tyre në fletën e votimit. Përveç kësaj, çdo qendër votimi kishte dy lupa dhe shabllone në alfabetin Braille me prekje (të printuara me profil).

Mjetet ndihmëse – nga “Akses i barabartë: si të përfshihen personat me aftësi të kufizuar në proceset zgjedhore dhe politike”, 2014, Fondacioni Ndërkombëtar për Sistemet Zgjedhore (IFES) dhe Instituti Demokratik Kombëtar (NDI)

“Ekzistojnë disa lloje mjetesh ndihmëse që e bëjnë procesin zgjedhor më të aksesueshëm... Shabllonet me prekje (të printuara me profil) janë dosje brenda të cilëve futet fleta e votimit, dhe votuesi i verbër i identifikon kandidatët përmes simboleve të alfabetit Braille ose me prekje, gjë që garanton fshehtësinë e votës... Vrimat në shabllon përputhen me kutizat në fletët e votimit, në mënyrë që votuesit të arrijë të lexojë dhe të bëjë shënimin në fletën e votimit njësoj si votuesit që nuk përdorin shabllon. Disa organe të administrimit të zgjedhjeve kanë përgatitur fletë votimi në alfabetin Braille, por shabllonet janë zgjidhje më e mirë për dy arsye. Së pari, shpesh ka shumë pak votues për kuti fletësh votimi që përdorin fletën e votimit në alfabetin Braille, kështu që është lehtësisht e identifikueshme se si kanë votuar ata. Nga ana tjetër, kur votuesi me aftësi të kufizuar përdor shabllonin,

fleta e votimit duket njësoj si të tjerat dhe kështu garantohet fshehtësia e votës. Së dyti, shabllonet me prekje (të printuara me profil) janë zakonisht më pak të kushtueshme. Organeve të administrimit të zgjedhjeve iu duhet të sigurojnë vetëm pak shabllone për çdo qendër votimi, ndërsa sigurimi i fletëve të votimit në alfabetin Braille kërkon më shumë logjistikë për të garantuar numrin e duhur të këtyre fletëve të votimit në çdo qendër votimi...

Dhomat e fshehta të votimit që janë më të ulëta, të aksesueshme për personat në karrocë invalidi, ndihmojnë në ruajtjen e fshehtësisë së votës. Pullat ngjitëse në alfabetin Braille me prekje ose kapakët e kutive të votimit i ndihmojnë zgjedhësit e verbër që të dinë se në cilën kuti duhet ta hedhin çdo fletë votimi në rastet e zgjedhjeve kur fletët e votimit duhet të hidhen në kuti të ndryshme. Lupat, dritat portative dhe stilolapsat e formatit të madh janë mjete që i ndihmojnë votuesit me dhe pa aftësi të kufizuar”.

#	Pyetje	Eksperti drejtues i misionit të vëzhgimit
28	A disponohen mjete ndihmëse për të lehtësuar votimin nga ana e personave me aftësi të kufizuar në qendrat e votimit (për shembull, shabllone me prekje (të printuara me profil), shabllone në alfabetin Braille ose lupa)? Nëse po, a di personeli si t'i përdorë ato? A i njohin zgjedhësit këto mjete dhe a dinë si t'i përdorin ato? A janë ato efektive?	Analisti zgjedhor

Ndihma nga një person i zgjedhur prej vetë votuesit

Një tjetër çështje që duhet marrë parasysh është nëse zgjedhësit mund të kenë ndihmën e një personi të zgjedhur prej tyre, siç parashikon neni 29 i KDPAK-së, ose nëse mund të ndihmohen nga dikush tjetër, si për shembull, nga një zyrtar zgjedhor (kjo mund të komprometojë fshehtësinë e votës dhe të rezultojë në abuzim në disa raste). Raporti i ADTH-së i vitit 2014 konstaton se: “Në 15 Shtete Anëtare të BE-së..., personave me aftësi të kufizuar fizike, pamore dhe intelektuale u ofrohet ndihmë në votim, pasi të jetë marrë autorizim nga autoritetet zgjedhore. Por, shpesh, ky legjisllacion kërkon që në dhomën e fshehtë të votimit, bashkë me zgjedhësin dhe ndihmësin të jetë i pranishëm edhe një zyrtar zgjedhor, çka mund të ngrejë shqetësime në lidhje me fshehtësinë e votës për personat që kanë nevojë për ndihmë”.

#	Pyetje	Eksperti drejtues i misionit të vëzhgimit
29	A ka dispozita ligjore për ndihmën në votim nga një person i zgjedhur prej zgjedhësit? Nëse po, a duhet të jetë i pranishëm edhe një zyrtar zgjedhor?	Analisti ligjor
30	Në praktikë, a jepet ndihmë në votim nga personi që zgjidhet nga vetë zgjedhësi? A duket se dispozitat respektohen? A garantohet fshehtësia e votës?	Analisti zgjedhor

Mekanizmat alternativë të votimit

Personat me aftësi të kufizuar duhet të kenë mundësi ta hedhin votën njësoj si çdo votues tjetër. Kur votimi bëhet në qendra votimi, personave me aftësi të kufizuar duhet t'u garantohen kushtet që të votojnë vetë. Në disa raste, aksesit në qendrën e votimit mund të mos jetë i mundur, kështu që mund të përdoren mekanizma alternativë votimi (MAV), si votimi i lëvizshëm, elektronik apo me postë. Megjithatë, siç thekson ZKLDNJ-ja në vitin 2011: "Mënyrat alternative të votimit duhet të përdoren vetëm në rastet kur për personat me aftësi të kufizuar është e pamundur, ose jashtëzakonisht e vështirë, të votojnë në qendrën e votimit si gjithë të tjerët... Mbështetja përgjithësisht tek votimi me ndihmës dhe votimi me mekanizma alternativë – si mënyrë për të garantuar pjesëmarrjen politike të personave me aftësi të kufizuar – nuk është në përputhje me detyrimet e përgjithshme që kanë marrë përsipër shtetet palë në bazë të neneve 4 dhe 29 të Konventës [KDPAK]."⁶⁰

MAV-të kanë mangësi të theksuara lidhur me fshehtësinë dhe integritetin. Në përgjithësi, gjatë përdorimit të tyre ushtrohet më pak kontroll dhe ofrohet më pak garanci, çka rrit mundësitë për cenimin e fshehtësisë së votës. Kështu, ka më shumë mundësi për kanosje dhe presion për të manipuluar votën. Pra, nëse legjislati i lejon MAV-të, është e nevojshme të shqyrtohen garancitë dhe nëse ekziston besimi i përgjithshëm në këto mekanizma ndër personat me aftësi të kufizuar dhe në përgjithësi ndër palët e interesuara zgjedhore.⁶¹

KDPAK-ja thekson fuqimisht të drejtën për të jetuar në komunitet, ku neni 19 parashikon që shtetet palë "të njohin të drejtën e barabartë të të gjithë personave me aftësi të kufizuar për të jetuar në komunitet, me zgjedhje të barabarta me të tjerët, dhe do të marrin masat e duhura dhe efektive për të bërë të mundur që personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë plotësisht këtë të drejtë dhe përfshirjen e pjesëmarrjen e tyre të plotë në komunitet". Megjithatë, ka persona që vazhdojnë të jetojnë në institucione, prandaj është e rëndësishme të shqyrtohen dispozitat ligjore që ua lejojnë këtyre rezidentëve votimin, sidomos kur e kanë të pamundur të dalin nga ambientet e institucionit. Gjithashtu, vëzhguesit duhet të verifikojnë problematikat në lidhje me fshehtësinë e votës edhe kur votimi kryhet në vendet ku jetojnë zgjedhësit me aftësi të kufizuar.

60 Paragrafët 58 dhe 74, Studim tematik i Komisionerit të Lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut "Mbi pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuar në jetën politike dhe publike", 2011. Gjetet në: http://www.ohchr.org/Documents/HRBodies/HRCouncil/RegularSession/Session19/A-HRC-19-36_en.pdf.

61 Shembuj të garancive janë: kriteret e përshtatshmërisë, një proces aplikimi që kërkon caktimin me shkrim i nënshkruar nga i regjistruari, të dhënat e aplikimeve dhe masat e transparencës.

#	Pyetje	Eksperti drejtues i misionit të vëzhgimit
31	A ka dispozita ligjore për mënyra alternative votimi (p.sh.: i lëvizshëm, elektronik ose me postë)? Nëse po, a janë parashikuar masa mbrojtëse?	Analisti ligjor
32	Nëse ka dispozita për mënyra alternative votimi (si votimi i lëvizshëm apo votimi me postë), sa efektive kanë rezultuar ato në praktikë për personat me aftësi të kufizuar? A e sigurojnë ato fshehtësinë e votës? A ka garanci të mjaftueshme? Si janë shprehur OPAK-të për këto dispozita? Si janë shprehur aktorët e tjerë zgjedhorë për këto dispozita? Çfarë dispozitash praktike janë hartuar për personat në institucione të kujdesit afatgjatë?	Analisti zgjedhor

C. Periudha pas ditës së zgjedhjeve

Pas ditës së zgjedhjeve, një mision i ODIHR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve mund të shqyrtojë dhënien e informacionit mbi rezultatet, aksesin ndaj ankimit dhe apelimit, si edhe si e kanë trajtuar vëzhguesit vendorë përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar. Treguesit e rezultateve duhet të paraqesin edhe numrin dhe përqindjet e personave me aftësi të kufizuar që kanë marrë pjesë në procesin zgjedhor në cilësi të ndryshme.

Informacioni për rezultatet

Të dhënat për kandidatët/partitë fituese dhe tabelat përmbledhëse duhet të jenë në formate të aksesueshme me qëllim që personat me aftësi të kufizuar të informohen për rezultatin e zgjedhjeve dhe të kontrollojnë toatalet e shpallura. Paragrafi 7.4 i Dokumentit të Kopenhagenit të OSBE-së i angazhon shtetet t'i bëjnë publike rezultatet zyrtare. Komenti i Përgjithshëm 34 i Komitetit të OKB-së për të Drejtat e Njeriut vëren se: "Shtetet palë duhet që, në mënyrë aktive, ta bëjnë publik informacionin shtetëror me interes publik".⁶² Këto të dhëna duhet të jenë në formate të shumëllojshme në mënyrë që të jenë të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuar. Është e rëndësishme që këto të dhëna të vihen në dispozicion në kohë reale, pra, duke lënë kohë për përgatitjen dhe regjistrimin e ankimeve dhe apelimeve.

#	Pyetje	Eksperti drejtues i misionit të vëzhgimit
33	A ofrohen të dhëna mbi rezultatet zgjedhore në formate të ndryshme, përfshirë edhe në formate lehtësisht të lexueshme, në audio, në alfabetin Braille ose me shkronja të zmadhuara dhe me shpjegim në gjuhën e shenjave? Nëse po, a disponohet ky informacion në kohë reale, duke lënë kohë të mjaftueshme për regjistrimin e ankimeve dhe apelimeve?	Analisti zgjedhor

62 <http://www2.ohchr.org/english/bodies/hrc/docs/gc34.pdf>

Ankimet dhe apelimet

Në çdo proces zgjedhor duhet të ofrohet mundësia për të depozituar ankime dhe apeline, me qëllim që të sigurohet akses ndaj mjeteve juridike dhe të promovohet përmirësimi i politikave dhe i praktikave që forcojnë respektimin e detyrimeve në lidhje me të drejtat e njeriut.⁶³ Është e rëndësishme që kjo të garantohet gjatë gjithë ciklit zgjedhor, por edhe më shumë gjatë fazës paszgjedhore. Neni 13 i KDKPAK-së vë theksin mbi aksesin e barabartë në organet e drejtësisë; por kjo ka rezultuar e vështirë të arrihet në praktikë. Siç u analizua më lart, një person i privuar nga zotësia juridike mund të përjashtohet nga ankimi, kështu që i duhet ta bëjë atë përmes dikujt tjetër, siç është kujdestari. Për më tepër, mungesa e aksesueshmërisë dhe kostot për paraqitjen e ankimeve dhe apelineve mund të rëndojnë në mënyrë shpërpjesëtimore mbi personat me aftësi të kufizuara. Mund të mungojë informacioni në formate të aksesueshme dhe të mos kuptohen të drejtat për shkak të aftësisë së kufizuar. Kjo e vështirëson së tepërmi shfrytëzimin e mjeteve për korrigjimin ligjor nga personat që ndihen se kanë qenë viktime të diskriminimit për shkak të aftësisë së kufizuar.

KDKPAK, neni 13 - Aksesin në organet e drejtësisë

1. Shtetet palë duhet të sigurojnë akses efektiv në organet e drejtësisë për personat me aftësi të kufizuara njësoj si pjesa tjetër e popullsisë, përfshirë edhe përshtatshmëri procedurale dhe sipas përkatësisë së moshës, me qëllim lehtësimin e rolit të tyre efektiv si pjesëmarrës të drejtpërdrejtë dhe jo të drejtpërdrejtë, përfshirë edhe në rolin e dëshmitarit, në të gjitha procedurat ligjore, përfshirë dhe fazat hetimore dhe stadi të tjera paraprake.

#	Pyetje	Eksperti drejtues i misionit të vëzhgimit
34	A disponohet në formate të shumfishta informacioni për mekanizmat e ankimit dhe apelimet? A vihet ky informacion në dispozicion si në nivel vendor, ashtu edhe qendror? A trajnohen zyrtarët zgjedhorë dhe organet që shqyrtojnë ankimet për ndërgjegjësimin lidhur me pjesëmarrjen në zgjedhje të personave me aftësi të kufizuara?	Analisti ligjor
35	A ka në praktikë pengesa për personat me aftësi të kufizuara, që të kenë akses ndaj mekanizmave të ankimit dhe apelimet? A janë paraqitur ankime dhe apeline përmes administratës zgjedhore dhe sistemit gjyqësor? A janë paraqitur ankesa pranë institucioneve të tjera jogyjqësore (si p.sh.: institucionet për të drejtat e njeriut, organet e barazisë dhe Avokati i Popullit)? Çfarë problematikash specifike ngrënë personat me aftësi të kufizuara?	Analisti ligjor

63 PNDPCP, neni 2.3 parashikon se: "3. Çdo shtet palë në këtë Pakt zotohet: (a) të sigurojë që çdo person, kur t'i shkelen të drejtat dhe liritë e njohura në këtë Pakt, të ketë të drejtën e një mjeti juridik efektiv".

Shembuj të praktikave të mira në rajonin e OSBE-së

- Me mbështetjen e IFES-it, një OJQ vendore zhvilloi një mision afatgjatë vëzhgimi të zgjedhjeve me fokus pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuar, ku VAGJ-të monitoruan mbi 300 aktivitete politike dhe VASH-të mbuluan mbi 500 qendra votimi. Misioni paraqiti 37 rekomandime mbi përmirësimin e efektivitetit të administratës zgjedhore, subjektet politike, sistemin e ankimit dhe apelimit dhe shoqërinë civile.

Vëzhgimi vendor

Rëndësia e vëzhgimit të zgjedhjeve theksohet në shpjegimin unifikues të nenit 25 të PNDPC-së. Komenti i Përgjithshëm 25 i Komitetit për të Drejtat e Njeriut deklaroi se: “Duhet të ketë shqyrtim të pavarur të procesit të votimit dhe numërimit”.⁶⁴ Grupet e vëzhgimit vendor që mbështesin Deklaratën e Parimeve Globale për Vëzhgimin dhe Monitorimin e Paanshëm të Zgjedhjeve nga Organizatat Qytetare, kanë marrë përsipër angazhime lidhur me aftësinë e kufizuar. Organizatat mbështetëse “zotohen të përfshijnë në raportet e tyre gjetje dhe rekomandime lidhur me pjesëmarrjen në proceset zgjedhore... të pjesëve tradicionalisht të papërfaqësuar sa duhet të popullatës, si p.sh.: personat me aftësi të kufizuar..., si edhe me hapat që ndërmarrin autoritetet, garuesit në zgjedhje dhe aktorët e tjerë për nxitjen e pjesëmarrjes së plotë të këtyre grupeve dhe/ose heqjen e pengesave ndaj pjesëmarrjes së tyre”.⁶⁵

#	Pyetje	Eksperti drejtues i misionit të vëzhgimit
36	A ndihmojnë grupet e vëzhgimit vendor në promovimin e pjesëmarrjes së plotë të personave me aftësi të kufizuar në procesin zgjedhor? A mbledhin të dhëna grupet e vëzhgimit vendor dhe a raportojnë mbi përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar? A kanë ofruar mbrojtje grupet e vëzhgimit vendor për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar? A kanë grupet e vëzhgimit vendor politika mbi përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar brenda organizatave të tyre?	Analisti zgjedhor

Treguesit e rezultateve

Këta tregues vlerësojnë deri në çfarë mase personat me aftësi të kufizuar marrin pjesë faktikisht si përfaqësues të zgjedhur, kandidatë, zgjedhës dhe në administratat zgjedhore. Nëse personat me aftësi të kufizuar janë të papërfaqësuar sa duhet, theksi vihet më shumë mbi masat e mëtejshme që duhet të ndërmarrë shteti për të mbështetur pjesëmarrjen. Siç u tha më lart, marrja e këtyre të dhënave mund të jetë e vështirë.

64 PNDPC, Komenti i Përgjithshëm 25, paragrafi 20.

65 Gjetet në: www.gndem.org/declaration-of-global-principles.

Nga informacioni i disponueshëm, shumica e vendeve ka një numër shumë të ulët personash me aftësi të kufizuar në parlamentet kombëtare. Raportet e Komitetit të KDPAK-së shprehin edhe shqetësimin për mospërfaqësimin sa duhet të personave me aftësi të kufizuar si kandidatë në zgjedhje dhe në organet ekzekutive dhe publike.

#	Pyetje	Eksperti drejtues i misionit të vëzhgimit
37	Sa persona me aftësi të kufizuar ishin në grupin e deputetëve që largohen, dhe sa prej tyre janë zgjedhur për të qenë pjesë e parlamentit pasardhës? Sa për qind janë gra? A i ofrojnë burimet zyrtare këto të dhëna?	Analisti politik
38	Sa persona me aftësi të kufizuar janë regjistruar si kandidatë? Sa për qind janë gra? A i ofrojnë burimet zyrtare këto të dhëna? A përputhen ato me burimet jozyrtare?	Analisti politik
39	Sa persona janë regjistruar si persona me aftësi të kufizuar në listën e zgjedhësve? A ndahen këto të dhëna sipas gjinisë? A ka të dhëna mbi numrin e saktë të personave që kanë votuar? A i ofrojnë burimet zyrtare këto të dhëna? A përputhen ato me burimet jozyrtare? Cilat janë pikëpamjet e OPAK-ve rreth numrit të zgjedhësve me aftësi të kufizuar, që janë regjistruar?	Analisti zgjedhor
40	Sa persona me aftësi të kufizuar punojnë në administratën zgjedhore? Sa për qind e tyre janë gra? A kanë personat me aftësi të kufizuar gjithashtu role të rëndësishme brenda administratës zgjedhore?	Analisti zgjedhor



Kapitulli 4: Puna e vëzhguesve dhe misioneve të ODIHR-it

Pjesëmarrja në zgjedhje e personave me aftësi të kufizuar është një fushë e së drejtës dhe praktikës në evoluim të vazhdueshëm. Angazhimet në kuadër të KDPAK-së vihen në zbatim më lehtë nëse detyrimet e KDPAK-së monitorohen, duke përmirësuar gjithëpërfshirjen në zgjedhje dhe në qeverisje. Për të vlerësuar se sa janë përmbushur kështu angazhimet lidhur me pjesëmarrjen në zgjedhje të personave me aftësi të kufizuar, duhet të analizohen ligjet, politikat, të dhënat dhe informacioni mbi mbajtjen e zgjedhjeve.

Shpesh mund të jetë e vështirë të mblidhen të dhëna se çfarë ndodh realisht në praktikë. Organizatat e aftësisë së kufizuar dhe vëzhguesit vendorë kanë rol të veçantë në mbledhjen dhe analizimin e këtij informacioni. Vëzhguesit vendorë janë në pozita të favorshme për të mbledhur informacion të plotë mbi fazat e ndryshme të procesit zgjedhor, sepse mbledhin të dhëna në mbarë vendin.

Puna e ODIHR-it lidhur me zgjedhjet kufizohet më shumë tek burimet në dispozicion dhe prandaj fokusohet tek problematikat kyçe në përmbushjen e detyrimeve dhe angazhimeve lidhur me aftësinë e kufizuar. Ekipet bazë analizojnë legjislacionin, politikat dhe masat në nivel qendror. Misionet për vëzhgimin e zgjedhjeve (MVZ-të) kanë vëzhgues afatgjatë (VAGJ-të) dhe vëzhgues afatshkurtër (VASH-të), të cilët mund të mbledhin të dhëna në terren për situatën e pjesëmarrjes në mbarë vendin. Më pas, misionet raportojnë gjetjet

kryesore dhe evidentojnë ku ka përputhshmëri dhe ku ka mangësi. Misionet i shohin të drejtat e personave me aftësi të kufizuar në balancë me të gjitha të drejtat e tjera zgjedhore, që duhet të respektohen, ashtu siç përcaktohet në angazhimet e OSBE-së dhe në detyrime dhe standarde të tjera ndërkombëtare.

ODIHR-i është i përkushtuar që të mbështesë përfshirjen dhe aktivizimin e personave me aftësi të kufizuar në aktivitetet e tij të vëzhgimit të zgjedhjeve. ODIHR-i përpiqet të japë mundësi maksimale për pjesëmarrje brenda kohëzgjatjes së misioneve të veta, që zakonisht zgjasin pak muaj, si edhe të garantojë kujdesin e duhur për të gjithë personelin vendas dhe ndërkombëtar të organizatës, të cilët ndonjëherë punojnë në kushte pasigurie dhe sfida.

A. Misionet për vlerësimin e nevojave (MVN-të)

Zakonisht, ODIHR-i dërgon një mision për vlerësimin e nevojave (MVN) në një shtet pjesëmarrës midis 4 dhe 6 muaj para ditës së zgjedhjeve. MVN-ja vlerëson mjedisin parazgjedhor dhe rekomandon nëse nevojitet vëzhgim; nëse po, rekomandon llojin më të përshtatshëm të vëzhgimit. Të gjitha raportet e MVN-ve publikohen në rubrikën e ODIHR-it në faqen e internetit të OSBE-së.

Hapat që ndërmerr MVN-ja:

- Para dërgimit të MVN-së, këshilltari përgjegjës për zgjedhjet i ODIHR-it verifikon nëse vendi e ka ratifikuar/ka aderuar në KDPAK dhe nëse ka shprehur ndonjë rezervë apo ka bërë ndonjë deklaratë. Raportimi nga ana e vendit në Komitetin e KDPAK-së, raportet alternative dhe ato jozyrtare, si edhe vërejtjet përmbyllëse të Komitetit mund të verifikohen për të parë pjesëmarrjen në zgjedhje. MVN-ja mund të verifikojë edhe nëse ka një strategji apo plan veprimi kombëtar që përfshin referimin në pjesëmarrjen politike të personave me aftësi të kufizuar.
- Gjatë MVN-së, ekipi verifikon me administratën zgjedhore për masat e ndërmarra për t'u siguruar akses personave me aftësi të kufizuar.
- Gjatë MVN-së, ekipi takohet me një ose me më shumë organizata të personave me aftësi të kufizuar, për të mësuar këndvështrimet e tyre rreth problematikave kryesore që prekin personat me aftësi të kufizuar gjatë procesit zgjedhor.
- Gjatë MVN-së, ekipi verifikon me partitë politike nëse po marrin ndonjë masë të brendshme për të nxitur pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuar, si dhe nëse ka ndonjë politikë në përzgjedhjen e personave me aftësi të kufizuar si kandidatë.

B. Aktivitetet që lidhen me zgjedhjet

Masat e përshkruara më poshtë janë për misionet për vëzhgimin e zgjedhjeve (MVZ-të) dhe misionet e kufizuar për vëzhgimin e zgjedhjeve (MKVZ), por mund të zbatohen edhe për misionet për vlerësimin e zgjedhjeve (MVIZ-të) dhe ekipet e ekspertëve për zgjedhjet (EEZ-të), sipas nevojave të identifikuara si dhe fokusit dhe burimeve të misionit.

Nën mbikëqyrjen e Zëvendëskryetarit të Misionit (ZKiM), një anëtar i ekipit bazë caktohet si pikë kontakti për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar. Ai/ajo ka përgjegjësinë të rrisë sensibilizimin për KDPAK-në dhe këtë udhëzues, të nxisë koordinimin, të takohet me OPAK-të, dhe të nxisë trajtimin në seksionet e ndryshme të raporteve të publikuara e përfshirjes së personave me aftësi të kufizuar. Nga të gjithë analistët e ekipeve bazë pritet që të analizojnë përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar në fushat e tyre përkatëse të vlerësimit, siç shtjellohet më poshtë. Disa çështje kërkojnë kontributin e disa kolegëve të ekipit bazë, ku, për shembull, analisti ligjor jep informacion për kuadrin ligjor kurse analisti zgjedhor vëren çfarë ndodh në praktikë.

Dy burime të përgjithshme të vlefshme me informacione specifike sipas vendeve janë: Election Access (www.electionaccess.org/en/), dhe DOTCOM for EU-related countries (www.disability-europe.net/dotcom).

*Hapat që ndërmer MVZ-ja:*⁶⁶

- ZKiM-ja, në konsultim me anëtarët e ekipit bazë, cakton një pikë kontakti për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar.
- Pika e kontaktit për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar merr masat që të qarkullohet Udhëzuesi dhe të kuptohen përgjegjësitë përkatëse nga ekspertët e ekipit bazë. Gjithashtu, pika e kontaktit mundëson takimin me OPAK-të.
- Pika e kontaktit siguron që VAGJ-të dhe VASH-të të informohen përmbledhtas mbi përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar.
- Pika e kontaktit dhe ZKiM-ja përgatisin paragrafë me përmbledhje ekzekutive dhe rishikojnë të dhënat e raportimit të kolegëve të ekipit bazë mbi përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar.

C. Vëzhguesit afatgjatë (VAGJ-të)

VAGJ-të janë anëtarët rajonalë të dhe MVZ-ve të cilët mbledhin informacion mbi atë çfarë ndodh në terren në mbarë vendin para ditës së zgjedhjeve, në ditën e zgjedhjeve dhe pas saj. Ata mbështesin gjithashtu VASH-të (gjatë MVZ-ve) në punën e tyre në terren. Prandaj, VAGJ-të luajnë rol të rëndësishëm në ndihmesën që i jepet misionit për të njohur situatën de facto sa i përket respektimit, mbrojtjes dhe përmbushjes së të drejtave zgjedhore të personave me aftësi të kufizuar në rajone.

Përmes koordinatorit të VAGJ-ve, ekspertët e ekipit bazë u kërkojnë VAGJ-ve të mbledhin informacion rreth asaj çka po ndodh në nivel vendor në lidhje me pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuar në procesin zgjedhor. Ata informohen mbi këtë nga ekipi bazë pas mbërritjes së ekipit në vendin përkatës. VAGJ-të vëzhgojnë kryesisht çështjet e mëposhtme.

- **A ka kryer administrata zgjedhore konsultime me OPAK-të?** A duket se janë marrë në konsideratë qëndrimet e OPAK-ve; nëse jo, pse?

66 Pyetje specifike për anëtarët e ekipeve bazë jepen në seksionet më lart, si edhe në Shtojcën A.

- **A ofron administrata zgjedhore informacion në nivel vendor sipas standardeve të aksesueshmërisë në formate të ndryshme?** A e përfshin edukimin e zgjedhësve? A jep informacion mbi mjediset zgjedhore të aksesueshme? A përditësohet informacioni me veprimtaritë e përgjithshme zgjedhore (si p.sh.: deklaratat për shtyp)? A e kundërshton administrata zgjedhore çdo stereotip dominues që lidhet me pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuar në zgjedhje?
- **A janë mediat vendore të disponueshme në disa formate?** A e përfshin edukimin e zgjedhësve dhe informimin rreth fushatës? A e kundërshton media vendore çdo stereotip dominues, duke e pasqyruar pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuar në zgjedhje? A financohen ato nga fondet publike apo private?
- **A është i vështirë procesi i regjistrimit të zgjedhësve për personat me aftësi të kufizuar të ndryshme, duke rrezikuar kështu akses të reduktuar?** A janë të vështira kërkesat për marrjen e mjetit të identifikimit? A u kërkohet personave me aftësi të kufizuar ta regjistrojnë aftësinë e tyre të kufizuar në ndonjë mënyrë, dhe nëse po, a është efektiv sistemi?
- **A është i vështirë procesi i caktimit të kandidatëve për personat me aftësi të kufizuar të ndryshme (duke rrezikuar kështu akses të kufizuar)?** A ofrohet mbështetje shtesë për personat me aftësi të kufizuar për t'u regjistruar si kandidatë?
- **A ofrojnë partitë politike/kandidatët informacion në formate të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuar të ndryshme?** Nëse po, a e bëjnë këtë të gjitha partitë apo vetëm disa? A përfshihen problematikat kryesore të fushatës dhe/ose informacioni rreth partive dhe kandidatëve?
- **A janë aktivitetet e fushatave të përshtatura edhe për personat me aftësi të kufizuar?** Si është akses i fizik? A ka formate të ndryshme prezantimi (për shembull, gjuha e shenjave, materialet në format lehtësisht të lexueshëm ose titrat)? A lejojnë mjediset kalimin e karrocës së invalidit pa qenë nevoja për ndihmë? A u jepet mbështetje shtesë kandidatëve me aftësi të kufizuar? A ka diskutime rreth përfshirjes së personave me aftësi të kufizuar?
- **A janë ndërtesat e përdorura nga autoritetet zgjedhore dhe ato për votim të aksesueshme nga personat me lloje të ndryshme aftësisht të kufizuar?** A i përmbushin ato standardet ligjore të vendit (nëse ka të tilla)? Nëse janë të aksesueshme vetëm disa qendra votimi, si ndikon kjo në pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuar?
- **A kryen administrata zgjedhore trajnime efektive mbi përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar?** A theksohen në to të drejtat e personave me aftësi të kufizuar? A shpjegohen problematikat kyçe, si aksesueshmëria në shërbime, ndihma nga një person i zgjedhur nga vetë zgjedhësi dhe disponueshmëria e informacionit?
- **Nëse ka dispozita për mënyra alternative votimi (si votimi i lëvizshëm apo votimi me postë), sa efektive kanë rezultuar ato në nivel vendor?** A e sigurojnë ato fshehtësinë e votës? A ka garanci të mjaftueshme? Si janë shprehur OPAK-të në nivel vendor për këto dispozita? Si janë shprehur aktorët e tjerë vendorë zgjedhorë për këto dispozita? Çfarë dispozitash praktike janë hartuar për personat në institucionet e kujdesit afatgjatë?

- **A ofrohen të dhëna mbi rezultatet zgjedhore në formate të ndryshme, përfshirë edhe atë lehtësisht të lexueshëm, në alfabetin Braille, me shkronja të mëdha apo me shpjegim në gjuhën e shenjave?** Nëse po, a disponohet ky informacion në kohë reale, duke lënë kohë të mjaftueshme për regjistrimin e ankimeve dhe apelimeve?
- **A ofrojnë mekanizmat vendorë të ankimeve dhe apelimeve informacionin në përputhje me standardet e aksesueshmërisë në formate të ndryshme?**
- **A janë mekanizmat vendorë të ankimeve dhe apelimeve të aksesueshme de facto nga personat me aftësi të kufizuar?** Cilat janë të drejtat e personave me aftësi të kufizuar që janë ngritur?
- **A mbledhin të dhëna grupet e vëzhgimit vendor** për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar në nivel vendor?

D. Vëzhguesit afatshkurtër (VASH-të) dhe vëzhgimi në ditën e zgjedhjeve

Ky seksion trajton çështjet që VASH-të dhe anëtarë të tjerë të MVZ-së do të vëzhgojnë në ditën e zgjedhjeve. Në ditën e zgjedhjeve, VASH-të shpërndahen në territor; të vendosur në të gjithë vendin, ata japin informacione nga terreni mbi proceset e votimit, numërimit dhe nxjerrjes së rezultateve. Ashtu si VAGJ-të, por me fokus më të ngushtë, VASH-të kanë rol të rëndësishëm në ndihmesën që i jepet misionit për të mësuar se cila është gjendja de facto sa i përket respektimit, mbrojtjes dhe përmbushjes së të drejtave zgjedhore të personave me aftësi të kufizuar në ditën e zgjedhjeve. VASH-të informohen përmbledhtas mbi këtë nga ekipi bazë sapo ata mbërrijnë në vend.

Vëzhguesit e ODIHR-it kanë në dispozicion një kohë të kufizuar për të kontrolluar në çdo qendër votimi (zakonisht rreth 30 minuta) dhe një numër qendrash votimi për të mbuluar. Prandaj vëzhguesit duhet të përqendrohen në çështjet e identifikuara më poshtë, edhe pse këto mund të ndryshojnë në varësi të kuadrit ligjor të vendit dhe veçorive administrative. Pyetjet dhe udhëzimet e zakonshme për formularët e VASH-ve të përdorur në qendrat e votimit (QV-të) dhe qendrat e nxjerrjes së rezultateve mund të përfshijnë si më poshtë:⁶⁷

#	Pyetësi i MVZ-së në ditën zgjedhjeve	Udhëzimet e MVZ-së për pyetjet përkatëse
1	A disponohet informacioni në QV-të në formate të ndryshme për personat me aftësi të kufizuar të ndryshme? (Po/Jo)	Formatet e ndryshme të informacionit e bëjnë procesin të aksesueshëm për personat me aftësi të kufizuar të ndryshme. Për vënien e informacionit në dispozicion mund të përfshihen materiale lehtësisht të lexueshme, versione tekstesh të shtypura me shkronja të zmadhuara, shkrimet në alfabetin Braille dhe materiale audio-vizuale (përfshirë edhe gjuhën e shenjave).

67 Metodologjia e ODIHR-it për mbledhjen e të dhënave në ditën e zgjedhjeve përfshin formularë të standardizuar, që duhen plotësuar nga vëzhguesit dhe që bazohen në raportimin sasior dhe cilësor nga VAGJ-të.

2	<p>A është QV-ja fizikisht e aksesueshme për personat me aftësi të kufizuar fizike?</p> <p>A është struktura e QV-së e përshtatshme për zgjedhësit me aftësi të kufizuar?</p> <p>(Po/Jo)</p>	<p>Kjo përfshin vëzhgimin nëse qendra e votimit është e aksesueshme për një person me aftësi të kufizuar fizike, në mënyrë që ai ose ajo të mund të shënojë në fletën e votimit dhe të votojë në fshehtësi dhe me dinjitet, pa ndihmë të veçantë. Për shembull, nevoja për ndihmë për ngritjen e karrocës së invalidit disa shkallë nënkupton që ndërtesa është e aksesueshme. Gjithashtu, kjo përfshin kontrollin nëse një person në karrocë invalidi mund të shënojë në fletën e votimit dhe të votojë në fshehtësi pa ndihmë, për shembull, duke siguruar një dhomë të fshehtë votimi mjaftueshëm të ulët që të përdoret nga një person në karrocë invalidi; e njëjta gjë vlen edhe për kutinë e votimit.</p>
3	<p>A disponohen mjete ndihmëse për të ndihmuar personat me aftësi të kufizuar shqisore?</p> <p>(Po/Jo)</p>	<p>Këto mjete u mundësojnë personave me aftësi të kufizuar shqisore të votojnë në fshehtësi. Ato përfshijnë shabllonet me relief (të printuara me termofom), shabllonet në alfabetin Braille dhe lupat. Mundohuni t'i shihni këto dhe të mësoni nëse funksionojnë, si dhe nëse, praktikisht, njerëzit dinë t'i përdorin ato dhe iu duken të dobishme.</p>
4	<p>A mundet një zgjedhës me aftësi të kufizuar të zgjedhë se kush do ta ndihmojë?</p> <p>(Po/Jo/Nuk e di)</p>	<p>A respektohet zgjedhja që bën zgjedhësi se kush do ta ndihmojë? A jep ndihmesën e vet edhe ndonjë zyrtar zgjedhor (duke kompromentuar kështu fshehtësinë e votës)?</p>

E. Raportimi publik dhe rekomandimet

MVZ-të, MKVZ-të, MVIZ-të dhe EEZ-të e ODIHR-it raportojnë lidhur me zgjedhjet. Kështu, misioni duhet të bëjë një përmbledhje dhe të përcaktojë prioritetet në mënyrë që të trajtojë situatën e përgjithshme në lidhje me pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuar në procesin zgjedhor, si dhe të jetë i qartë rreth pikave kryesore të forta dhe të dobëta. Duke pasur parasysh numrin e kufizuar të rekomandimeve që bën misioni, nuk ka gjasa të jenë më shumë se disa rekomandime të lidhura me përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar. Prandaj, misioni duhet të caktojë prioritetet në përputhje me situatën përkatëse të një vendi. Gjatë procesit të hartimit të përfundimeve dhe rekomandimeve që lidhen me aftësitë e kufizuar, është e rëndësishme të zhvillohen diskutime me OPAK-të për ta qartësuar maksimalisht misionin mbi çështjet dhe për të testuar prioritetet dhe rekomandimet. Pikat kyçe që lidhen me përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar duhet të përfshihen në deklaratën paraprake mbi gjetjet dhe përfundimet (për misionet për vëzhgimin e zgjedhjeve dhe misionet e kufizuar për vëzhgimin e zgjedhjeve), që paraqitet ditën pas zgjedhjeve. Trajtimi më i plotë i të drejtave të personave me aftësi të kufizuar do të bëhet në raportin përfundimtar. Të drejtat e personave me aftësi të kufizuar duhet të përmenden në përmbledhjen ekzekutive të raporteve, kur është mundësia, dhe sigurisht në raportin përfundimtar. Kjo duhet të përfshijë një përfundim të përgjithshëm dhe, më

pas, raportimi dhe rekomandimet për personat me aftësi të kufizuar duhet të përfshihen në seksione të ndryshme në të gjithë tekstin.

Nëse një vend e ka nënshkruar, por nuk e ka ratifikuar KDPAK-në, Konventa mund vazhdojë të shërbejë për referim meqenëse vendi ka shprehur interes për ta zbatuar atë dhe veprimet e tij nuk duhet të bien ndesh me Konventën. Nëse një vend nuk e ka nënshkruar apo nuk e ka miratuar Konventën, parimet e KDPAK-së mund të shërbejnë për referim, pasi shkalla e ratifikimit global nënkupton që Konventa ka vlerë normative, duke pranuar që vetë vendi nuk është i detyruar ta zbatojë ose nuk është i angazhuar ndaj Konventës. Në raste të tilla, misioni duhet të rekomandojë ratifikimin e KDPAK-së në përputhje me angazhimet e OSBE-së.⁶⁸

Sa më shumë të përputhet kuadri ligjor dhe gjuha e përdorur në raportim me kuadrin dhe gjuhën e KDPAK-së, aq më i qartë do të jetë raportimi dhe aq më i përdorshëm është për Komitetin për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. E njëjta gjë vlen edhe për rekomandimet, të cilat nuk duhet të jenë të përgjithshme por të shtrojnë çështje specifike që janë të zbatueshme dhe të matshme. Shembuj të rekomandimeve mund të përfshijnë referimin ndaj heqjes së të gjitha kufizimeve lidhur me të drejtat e votimit dhe të kandidimit, përfshirë edhe ato që bazohen në vendime të personalizuara gjykatë mbi pazotësinë mendore, në përputhje me KDPAK-në, apo hartimin e dispozitave për ndihmë nga një person i zgjedhur nga vetë zgjedhësi, gjithashtu në përputhje me KDPAK-në.

Si gjithmonë, misionet nuk duhet të bëjnë rekomandime që janë tepër normative, duke pasur parasysh se shtetet kanë një kufi vlerësimi rreth asaj se çfarë masash do të marrin për të siguruar përmbushjen e Konventës dhe të angazhimeve politike. Gjithashtu, misionet:

- nuk duhet të rekomandojnë që kufizimet lidhur me të drejtën e votës të personave me aftësi të kufizuar mendore dhe intelektuale të vendosen nga gjykatat rast pas rasti. Përkundrazi, misionet duhet të promovojnë standardet e KDPAK-së, duke rekomanduar që të mos ketë kufizime lidhur me të drejtën e votës për shkak të aftësive të kufizuar mendore ose intelektuale.
- nuk duhet t'u japin përparësi mënyrave alternative të votimit (të tilla, si votimi i lëvizshëm, votimi me postë dhe votimi me delegim), por të theksojnë përfshirjen në pjesëmarrje të personave me aftësi të kufizuar përmes projektimit universal. Kur është mundësia, vëmendje duhet t'i kushtohet përmirësimit të aksesueshmërisë së qendrave ekzistuese të votimit dhe jo bërjes së përgatitjeve alternative, pasi këto kanë probleme thelbësore lidhur me fshehtësinë dhe integritetin.

F. Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve

Në kuadër të Dokumentit të Stambollit të OSBE-së të vitit 1999, shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së u angazhuan “për të zbatuar në mënyrë të menjëhershme vlerësimet dhe rekomandimet e ODIHR-it për zgjedhjet”. Që prej asaj kohe, ndjekja e zbatimit të rekomandimeve për zgjedhjet është bërë gjithnjë e më e rëndësishme për shtetet

68 Në përputhje me paragrafin 13.2 të Dokumentit të Vjenës të OSBE-së të vitit 1989.

pjesëmarrëse të OSBE-së, si dhe për punën e ODIHR-it për të mbështetur shtetet në përpjekjet e tyre për përmirësimin më tej të proceseve zgjedhore.⁶⁹

ODIHR-i shpreh gatishmërinë të kthehet në një vend ku ka vëzhguar zgjedhjet dhe ku ka paraqitur zyrtarisht një raport përfundimtar. Nëse kërkohet nga një shtet pjesëmarrës, ODIHR-i mund të kryejë aktivitete për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të tij. Këto mund të përfshijnë rishikimet ligjore, asistencën me ekspertizë ligjore në hartimin e legjislacionit, vlerësimet e thelluara të përbërësve specifikë zgjedhorë, këshillimin teknik, mbështetjen për OSHC-të, vizitat afatshkurtra për të bërë analiza, si dhe lehtësimin dhe koordinimin.

ODIHR-i nxit pluralizmin politik dhe pjesëmarrjen e grupeve të papërfaqësuar sa duhet në proceset e ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve, si një mjet për të nxitur mundësi të barabarta për pjesëmarrje në zgjedhje. Kështu, ODIHR-i kërkon që të bëjë konsultime me OPAK-të dhe t'i përfshijë ato në aktivitetet e ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve, si dhe inkurajon shtetet pjesëmarrëse t'i përfshijnë po ashtu OPAK-të në këtë proces.

Pikat e veprimit të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve:

- Ekipi i ODIHR-it duhet të takohet me OPAK-të gjatë vizitës për paraqitjen e raportit përfundimtar, si dhe t'i përfshijë OPAK-të në diskutime në tryeza të rrumbullakëta.
- Kur është mundësia, ekipi i ODIHR-it duhet t'i përfshijë personat me aftësi të kufizuar dhe rekomandimet për aftësinë e kufizuar në diskutimet për raportin përfundimtar.
- Të nxiten OPAK-të që të përfshihen në aktivitete të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve dhe në reformën zgjedhore.
- Të ofrohet ndihmë për shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së për nxitjen e pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuar në proceset zgjedhore, përfshirë edhe përmes rishikimit të legjislacionit dhe praktikave zgjedhore në përputhje me KDPAK-në.

Shembull i praktikës së mirë në rajonin e OSBE-së

Në një shtet pjesëmarrës të OSBE-së, Avokati i Popullit ngriti një grup pune për shqyrtimin e çështjeve që kanë të bëjnë me pjesëmarrjen në zgjedhje të personave me aftësi të kufizuar. Ky grup pune përfshiu përfaqësues të OPAK-ve dhe organizatave të tjera të shoqërisë civile në kryerjen e një studimi për të verifikuar nëse sigurohej aksesueshmëria e qendrave të votimit, siç kërkohet nga ligji. Përfundimet e studimit, përfshirë edhe rekomandimet për përmirësime, iu paraqitën nga grupi i punës një game të gjerë aktorësh zgjedhorë në një aktivitet publik pas zgjedhjeve dhe iu shpërndanë institucioneve shtetërore nga Avokati i Popullit. Grupi i punës e vazhdoi aktivitetet e tij edhe në zgjedhjet pasuese, për të vlerësuar progresin e bërë dhe masën në të cilën ishin zbatuar rekomandimet e mëparshme.

69 Për më shumë informacion, shih: "Manualin për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve për zgjedhjet" e ODIHR-it, 2016. Gjetendet në: <http://www.osce.org/odhr/elections/119893>.

Shtojca A – Pyetjet për secilin anëtar të ekipit bazë

Analisti ligjor

#	Pyetje	Burimet e mundshme
1	A e ka ratifikuar apo a është anëtarësuar shteti në KDPAK dhe, nëse po, a ka shprehur ai ndonjë rezervë apo ka bërë ndonjë deklaratë në lidhje me pjesëmarrjen në zgjedhje (në veçanti, për nenet 29, 9 dhe 12)? A e ka ratifikuar apo a është anëtarësuar shteti në Protokollin Fakultativ të KDPAK-së? A e ka ratifikuar apo aderon shteti në konventa të tjera përkatëse? A janë bërë ndryshime në legjislacionin vendas pas ratifikimit dhe a kanë qenë këto ndryshime në përputhje me detyrimet e shtetit?	KDPAK-ja dhe statusi i ratifikimit të protokollit fakultativ, faqja e internetit e Përmbledhjes së Traktateve të OKB-së ⁷⁰
2	A ka raportuar shteti në Komitetin për të Drejtat e Personave me Aftësi të kufizuar për çështje që lidhen me pjesëmarrjen në zgjedhje? A janë paraqitur raporte jozyrtare ose alternative? Cilat ishin vërejtjet përmbyllëse të Komitetit në lidhje me pjesëmarrjen në zgjedhje të personave me aftësi të kufizuar? A ka raportuar shteti në organe të tjera monitoruese të traktateve për çështje që lidhen me pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuar në zgjedhje, për shembull, në Këshillin e OKB-së për të Drejtat e Njeriut apo në Komitetin për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW)?	Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (faqja e internetit) ⁷¹ Komitetet e organeve të tjera të Konventës (faqet e internetit)
3	A ka një strategji kombëtare apo plan veprimi për personat me aftësi të kufizuar që përfshin të drejtën për pjesëmarrje politike? A ka ndonjë mekanizëm për monitorimin e zbatimit të tyre dhe a është ky një proces konsultativ? A bëhet raportim publik?	Ministria përgjegjëse OPAK-të
4	A ka standarde të përgjithshme ligjore për aksesueshmërinë e informacionit? A zbatohen standardet ligjore për aksesueshmërinë edhe për administratën zgjedhore, partitë politike dhe organizatat e shoqërisë civile? A ka standarde ligjore për aksesueshmërinë për ofruesit privatë dhe publikë të informacioneve publike në internet? A ka standarde ligjore për aksesin në mediat audio-vizuale publike dhe private?	Legjislacioni Strategjia kombëtare ose plani i veprimit Ministria përgjegjëse

⁷⁰ https://treaties.un.org/Pages/Treaties.aspx?id=4&subid=A&clang=_en.

⁷¹ <https://www.ohchr.org/EN/HRBodies/CRPD/Pages/CRPDIndex.aspx>

5	A ka standarde të përgjithshme ligjore për aksesin në ndërtesa dhe në infrastrukturë në përgjithësi? A zbatohen ato për administratën zgjedhore, partitë politike dhe shoqërinë civile? A ka standarde të detyrueshme për aksesin në ndërtesat e institucioneve qendrore dhe vendore?	Legjislatiioni Strategjia kombëtare ose plani i veprimit Ministria përgjegjëse
6	A ka dispozita të qarta ligjore lidhur me pjesëmarrjen në zgjedhje të personave me aftësi të kufizuar? A ka dispozita të veçanta ligjore për mosdiskriminimin lidhur me pjesëmarrjen në zgjedhje të personave me aftësi të kufizuar? A janë përcaktuar projektimi universal i pamjaftueshëm dhe mohimi i përshtatjes së arsyeshme si forma diskriminimi në legjislatiionin e brendshëm?	Ligjet mbi mosdiskriminimin dhe aksesueshmërinë Kushtetuta Legjislatiioni zgjedhor
7	A ka kërkesa ligjore për ndarjen e të dhënave zgjedhore sipas aftësive të kufizuar të ndryshme dhe gjinisë? Për shembull, për zgjedhësit, kandidatët dhe të zgjedhurit. A është e detyrueshme bërja publike e këtyre të dhënave? A ka dispozita për mbrojtjen e të dhënave dhe, nëse po, si interpretohen ato në lidhje me detyrimet e KDPAK-së?	Legjislatiioni
9	A ka kërkesa ligjore për konsultimin me OPAK-të dhe për përfshirjen e tyre aktive në lidhje me zgjedhjet? A është e detyruar administrata zgjedhore të konsultohet në nivel qendror dhe/ose në nivel vendor? A ekziston ndonjë detyrim për mediat e financuara nga fondet publike që të konsultohen me OPAK-të për transmetimin e informacionit për zgjedhjet?	Legjislatiioni
10	A janë konsultuar OPAK-të në ndonjë nismë për reformë legjislative? A duket se janë marrë në konsideratë qëndrimet e OPAK-ve? Nëse jo, për çfarë arsyes (nëse ka)?	Parlamenti OPAK-të
13	A ka kufizime legjislative ndaj pjesëmarrjes në zgjedhje (si kandidat ose zgjedhës), që janë të lidhura me zotësinë juridike? Nëse ka kufizime, a kërkohet vendim gjykate i veçantë për zotësinë juridike në lidhje me të drejtën e votës? Nëse legjislatiioni nuk e parashikon heqjen e zotësisë juridike, a ka mekanizma mbështetës për personat me aftësi të kufizuar që të ushtrojnë të drejtën e votës?	Legjislatiioni
14	A ka në legjislatiion mekanizma ankimi dhe apelimi për personat të cilëve iu kufizohet e drejta e votës për shkak të zotësisë juridike? A është e mundur gjithashtu të paraqitet ankesë në institucione jogjyqësore (si p.sh.: institucionet për drejtat e njeriut, organet e barazisë etj.)?	Legjislatiioni Institucionet jogjyqësore
15	Nëse ka kufizime legjislative për pjesëmarrjen në zgjedhje për shkak të zotësisë juridike, a ka statistika zyrtare për numrin e personave të prekur? A ka raporte për shpërdorimin e kufizimeve ndaj zotësisë juridike?	Statistikat zyrtare OPAK-të

25	A ka dispozita ligjore për t'i bërë të aksesueshme proceset zgjedhore përmes marrjes së të gjitha masave të nevojshme? A ka standarde ligjore për aksesueshmërinë e qendrave të votimit? A i trajtojnë këto standarde llojet e ndryshme të aftësive të kufizuar? A ka dispozita ligjore për votimin nga personat në institucionet e kujdesit afatgjatë?	Legjislacioni Strategjia kombëtare ose plani i veprimit
29	A ka dispozita ligjore për ndihmën në votim nga një person i zgjedhur prej votuesit? Nëse po, a duhet të jetë i pranishëm edhe një zyrtar zgjedhor?	Legjislacioni Organi i administrimit të zgjedhjeve (OAZ)
31	A ka dispozita ligjore për mënyrat alternative të votimit (p.sh.: i lëvizshëm, elektronik ose me postë)? Nëse po, a janë parashikuar masa mbrojtëse?	Legjislacioni OAZ
34	A disponohet në formate të shumëfishta informacioni për mekanizmat e ankimit dhe apelimit? A vihet ky informacion në dispozicion si në nivel vendor ashtu edhe në atë qendror? A trajnohen zyrtarët zgjedhorë dhe organet që shqyrtojnë ankimet për ndërjegjësimin lidhur me pjesëmarrjen në zgjedhje të personave me aftësi të kufizuar?	OAZ Gjykatat Institucionet jogjyqësore Gjetjet e VAGJ-ve/ VASH-ve OPAK-të
35	A ka në praktikë pengesa për personat me aftësi të kufizuar, që të kenë akses ndaj mekanizmave të ankimit dhe apelimit? A janë paraqitur ankime dhe apelime përmes administratës zgjedhore dhe sistemit gjyqësor? A janë paraqitur ankesa pranë institucioneve të tjera jogjyqësore (si p.sh.: institucionet për të drejtat e njeriut, organet e barazisë dhe Avokati i Popullit)? Çfarë problematikash specifike ngrenë personat me aftësi të kufizuar?	Gjykatat Institucionet jogjyqësore Gjetjet e VAGJ-ve/ VASH-ve OPAK-të Grupet e vëzhgimit vendor

Analisti zgjedhor

#	Pyetje	Burimet e mundshme
8	A ka kërkesa ligjore për ndarjen e të dhënave zgjedhore sipas llojeve të ndryshme të aftësive të kufizuar dhe gjinisë? Për shembull, për zgjedhësit, kandidatët dhe të zgjedhurit. A është e detyrueshme bërja publike e këtyre të dhënave? A ka dispozita për mbrojtjen e të dhënave dhe, nëse po, si interpretohen ato në lidhje me detyrimet e KDPAK-së?	OAZ OPAK-të
11	A ka kryer administrata zgjedhore konsultime me OPAK-të dhe, nëse jo, pse? A duket se janë marrë në konsideratë qëndrimet e OPAK-ve? A është bërë kjo në nivel vendor dhe qendror? A ka administrata zgjedhore politika për personat me aftësi të kufizuar? A ka administrata zgjedhore një pikë kontakti për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar?	OAZ OPAK-të Gjetjet e VAGJ-ve/ VASH-ve

16	A ofron administrata zgjedhore informacion sipas standardeve të aksesueshmërisë dhe në formate të ndryshme, përfshirë edhe materialet lehtësisht të lexueshme dhe ato në format me shkronja të mëdha, shabllone në alfabetin Braille për votim, si dhe me shpjegim në gjuhën e shenjave? A disponohet ky informacion si në nivel vendor ashtu dhe në atë qendror? A e përfshin edukimin e zgjedhësve? A jep informacion mbi mjediset zgjedhore të aksesueshme? A përditësohet informacioni me veprimtaritë e përgjithshme zgjedhore (si p.sh.: deklaratat për shtyp, njoftimet dhe të dhënat)? Cilat janë pikëpamjet e OPAK-ve lidhur me dispozitat për informimin?	OAZ OPAK-të Gjetjet e VAGJ-ve/ VASH-ve Grupet e vëzhgimit vendor
18	A është i vështirë procesi i regjistrimit të zgjedhësve për personat me aftësi të kufizuar të ndryshme, duke rrezikuar kështu akses të reduktuar? A ka pengesa për marrjen e mjetit të identifikimit, duke rrezikuar kështu akses të reduktuar? A ekziston ndonjë masë e posaçme për regjistrimin si zgjedhës të personave me aftësi të kufizuar?	Legjisllacioni Rregulloret e OAZ-së OPAK-të Gjetjet e VAGJ-ve/ VASH-ve Grupet e vëzhgimit vendor
19	A është i vështirë procesi i caktimit të kandidatëve për personat me aftësi të kufizuar të ndryshme (duke rrezikuar kështu akses të kufizuar)? A ofrohet mbështetje shtesë për personat me aftësi të kufizuar për t'u regjistruar si kandidatë?	Legjisllacioni Rregulloret e OAZ-së OPAK-të Gjetjet e VAGJ-ve/ VASH-ve Grupet e vëzhgimit vendor
20	A kryen administrata zgjedhore trajnime efektive mbi përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar? A theksohen të drejtat e personave me aftësi të kufizuar? A shpjegohen problematikat kyçe, si aksesueshmëria në shërbime, ndihma nga një person i zgjedhur nga vetë zgjedhësi, dhe disponueshmëria e informacionit? A është trajnuar administrata zgjedhore për OPAK-të dhe a ka ajo programe për edukimin e tyre?	OAZ OPAK-të Gjetjet e VAGJ-ve/ VASH-ve Grupet e vëzhgimit vendor
26	A janë ndërtesat e përdorura nga autoritetet zgjedhore dhe për votim të aksesueshme nga personat me aftësi të kufizuar të ndryshme? A i përmbushin ato standardet ligjore të vendit (nëse ka të tilla)? A janë ato të aksesueshme nga personat në karricë invalidi pa ndihmë? A mundet që personat me aftësi të kufizuar fizike ta shënojnë në fletën e votimit dhe të votojnë në fshehtësi, pa ndihmë? Nëse janë të aksesueshme vetëm disa qendra votimi, si ndikon kjo në pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuar?	OAZ OPAK-të Gjetjet e VAGJ-ve/ VASH-ve Grupet e vëzhgimit vendor

27	A disponohet informacioni për votimin në formate të aksesueshme, përfshirë edhe formate lehtësisht të lexueshme dhe me shkronja të mëdha? Nëse po, a mbuloohen mjaftueshëm të gjitha udhëzimet për votimin?	OAZ OPAK-të VASH-ët Grupet e vëzhgimit vendor
28	A disponohen mjete ndihmëse për të lehtësuar votimin nga ana e personave me aftësi të kufizuar në qendrat e votimit (për shembull, shabllone me relief (të printuara me termoform), shabllone në alfabetin Braille ose lupa)? Nëse po, a di personeli si t'i përdorë ato? A i njohin zgjedhësit këto mjete dhe a dinë si t'i përdorin ato? A janë ato efikase?	OAZ OPAK-të Gjetjet e VAGJ-ve/ VASH-ve Grupet e vëzhgimit vendor
30	Në praktikë, a jepet ndihmë në votim nga personi që zgjidhet nga vetë zgjedhësi? A duket se dispozitat respektohen? A garantohet fshehtësia e votës?	Rregulloret e OAZ-së OPAK-të Gjetjet e VAGJ-ve/ VASH-ve Grupet e vëzhgimit vendor
32	Nëse ka dispozita për mënyra alternative votimi (si votimi i lëvizshëm apo votimi me postë), sa efektive kanë rezultuar ato në praktikë për personat me aftësi të kufizuar? A e sigurojnë ato fshehtësinë e votës? A ka garanci të mjaftueshme? Si janë shprehur OPAK-të për këto dispozita? Si janë shprehur aktorët e tjerë zgjedhorë për këto dispozita? Çfarë dispozitash praktike janë hartuar për personat në institucione të kujdesit afatgjatë?	Rregulloret e OAZ-së OPAK-të Gjetjet e VAGJ-ve/ VASH-ve Grupet e vëzhgimit vendor
33	A ofrohen të dhëna mbi rezultatet zgjedhore në formate të ndryshme, përfshirë edhe në formate lehtësisht të lexueshëm, në audio, në alfabetin Braille apo formatin e shtypur me shkronja të mëdha, si dhe me shpjegim në gjuhën e shenjave? Nëse po, a disponohet ky informacion në kohë reale, duke lënë kohë të mjaftueshme për regjistrimin e ankimeve dhe apelimeve?	OAZ OPAK-të Gjetjet e VAGJ-ve/ VASH-ve
36	A ndihmojnë grupet e vëzhgimit vendor në promovimin e pjesëmarrjes së plotë të personave me aftësi të kufizuar në procesin zgjedhor? A mbledhin të dhëna grupet e vëzhgimit vendor dhe a raportojnë mbi përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar? A kanë ofruar mbrojtje grupet e vëzhgimit vendor për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar? A kanë grupet e vëzhgimit vendor politika mbi përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar brenda organizatave të tyre?	Grupet e vëzhgimit vendor OPAK-të Gjetjet e VAGJ-ve/ VASH-ve

39	Sa persona janë regjistruar si persona me aftësi të kufizuar në listën e zgjedhësve? A ndahen këto të dhëna sipas gjinisë? A ka të dhëna mbi numrin e saktë të personave që kanë votuar? A i ofrojnë burimet zyrtare këto të dhëna? A përputhen ato me burimet jozyrtare? Çfarë mendojnë OPAK-të lidhur me numrin e zgjedhësve me aftësi të kufizuar që janë regjistruar?	OAZ OPAK-të
40	Sa persona me aftësi të kufizuar punojnë në administratën zgjedhore? Sa për qind e tyre janë gra? A kanë personat me aftësi të kufizuar gjithashtu role të rëndësishme brenda administratës zgjedhore?	OAZ

Analisti politik

#	Pyetje	Burimet e mundshme
21	A ofrojnë partitë politike/kandidatët informacion në formate të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuar të ndryshme? Nëse po, a e bëjnë këtë të gjitha partitë apo vetëm disa? A përfshihen problematikat kryesore të fushatës dhe/ose informacioni rreth partive dhe kandidatëve?	Partitë politike/ kandidatët OPAK-të Gjetjet e VAGJ-ve/ VASH-ve Grupet e vëzhgimit vendor
22	A u jepet mbështetje shtesë kandidatëve me aftësi të kufizuar? A ofrohen fonde shtesë për të mbuluar shpenzimet për fushatën? A i përfshijnë fushatat zgjedhore personat me aftësi të kufizuar? A janë mjediset e fushatave fizikisht të aksesueshme? A ka formate të ndryshme prezantimi (për shembull, gjuha e shenjave, titrat apo materialet në format lehtësisht të lexueshëm)? A ka diskutime rreth përfshirjes së personave me aftësi të kufizuar?	Partitë politike/ kandidatët OPAK-të Gjetjet e VAGJ-ve/ VASH-ve Grupet e vëzhgimit vendor
23	A kanë partitë/kandidatët politikë politika për promovimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar dhe/ose për pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuar në parti dhe si kandidatë? A kanë ata të dhëna për personat me aftësi të kufizuar brenda partisë? A e promovojnë ata përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar në programet e tyre? A marrin partitë politike mbështetje financiare nga shteti për të rritur pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuar në strukturat e tyre?	Partitë politike/ kandidatët OPAK-të Grupet e vëzhgimit vendor
37	Sa persona me aftësi të kufizuar ishin në grupin e deputetëve që largohen, dhe sa prej tyre janë zgjedhur për të qenë pjesë e parlamentit pasues? Sa për qind janë gra? A i ofrojnë burimet zyrtare këto të dhëna?	Statistikat zyrtare Parlamenti OAZ OPAK-të
38	Sa persona me aftësi të kufizuar janë regjistruar si kandidatë? Sa për qind janë gra? A i ofrojnë burimet zyrtare këto të dhëna? A përputhen ato me burimet jozyrtare?	OAZ OPAK-të

Analisti i medias

#	Pyetje	Burimet e mundshme
12	A ka kryer media e financuar nga fondet publike konsultime me OPAK-të në lidhje me aksesueshmërinë e pasqyrimin të fushatës dhe të informacionit zgjedhor? A duket se janë përfshirë qëndrimet e OPAK-ve?	Media e financuar nga fondet publike OPAK-të
17	A ofron media e financuar nga fondet publike informacion për zgjedhjet në përputhje me standardet e aksesueshmërisë në formate të ndryshme? Nëse po, a e mbulon ajo edukimin e zgjedhësve dhe informimin për fushatën? A kanë kandidatët me aftësi të kufizuar akses të njëjtë në media me kandidatët e tjerë? Cilat janë pikëpamjet e OPAK-ve rreth ofrimit të informacionit nga media të financuara nga fondet publike? Po në lidhje me mediat private?	Monitorimi i mediave nga MVZ-ja OPAK-të Media e financuar nga fondet publike Media private
24	A kanë mediat e financuara nga fondet publike politika apo praktika për promovimin e pjesëmarrjes së kandidatëve me aftësi të kufizuar apo për diskutimin mbi përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar në procesin e fushatës? A jep media publike informacion mbi fushatën në formate të ndryshme të aksesueshme? A i ka ndonjë media private këto politika dhe praktika? A paraqitet raportimi sipas perspektivës së bazuar në të drejta?	Monitorimi i mediave nga MVZ-ja OPAK-të Media e financuar nga fondet publike Media private

Shtojca B - Angazhimet e OSBE-së dhe Detyrimet e Standardet e tjera Ndërkombëtare

Dokumenti i Moskës i OSBE-së, 1991

41. Shtetet pjesëmarrëse vendosin:

- 1 - të garantojnë mbrojtjen e të drejtave të njeriut për personat me aftësi të kufizuara;
- 2 - të ndër marrin hapa për t'u garantuar mundësi të barabarta këtyre personave për të marrë pjesë plotësisht në jetën në shoqëri;
- 3 - të promovojnë pjesëmarrjen e duhur të këtyre personave në vendimmarrje në fushat që u përkasin;
- 4 - të nxisin shërbimet dhe trajnimet e punonjësve socialë për rehabilitimin profesional dhe social të personave me aftësi të kufizuara;
- 5 - të nxisin kushtet e favorshme për aksesin e personave me aftësi të kufizuara në ndërtesa dhe shërbime publike, strehim, transport dhe veprimtari kulturore dhe rikrijuese.

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDKP), 1966

2.1. Çdo shtet palë në këtë Pakt zotohet të respektojë dhe t'u sigurojë të gjithë njerëzve që ndodhen në territorin e tij dhe që varen nga juridiksioni i tij të drejtat e njohura në këtë Pakt, pa kurrfarë dallimi të bazuar në racë, ngjyrë, gjini, gjuhë, fe, opinion politik ose çdo opinion tjetër, origjinë kombëtare apo shoqërore, pasuri, lindje ose çdo gjendje tjetër.

25. Çdo qytetar ka të drejtë dhe mundësi që, pa asnjë nga dallimet e përmendura në nenin 2 dhe pa kufizime të paarsyeshme:

- (a) të marrë pjesë në drejtimin e punëve publike, qoftë drejtpërsëdrejti ose nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur lirisht;
- (b) të votojë dhe të zgjidhet në zgjedhje të qenësishme periodike, me votim të përgjithshëm dhe të barabartë dhe me votë të fshehtë, të cilat sigurojnë shprehjen e lirë të vullnetit të zgjedhësve;
- (c) të ketë akses, në kushte të përgjithshme barazie, në ushtrimin e funksioneve publike në vendin e tij.

Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (KDPAK), 2008

Neni 2 - Përkufizimet

Për qëllime të kësaj Konvente:

“Komunikimi” përfshin gjuhët, shfaqjet e tekstit, alfabetin Braille, komunikimin me prekje, shkronjat e mëdha, multimediat e aksesueshme, si edhe mënyrat, mjetet dhe format e komunikimit në audio, të shkruar, në gjuhë të qartë, me anë të leximit nga një person ndihmës dhe ato shtesë dhe alternative, përfshirë edhe informacion dhe teknologji komunikimi të aksesueshëm.

“Gjuha” përfshin gjuhën e folur dhe të shkruar si dhe format e tjera të gjuhëve që nuk fliten;

“Diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar” nënkupton çdo dallim, përjashtim apo kufizim për shkak të aftësisë së kufizuar, që ka si qëllim ose ndikon në pengimin apo mohimin e njohjes, gëzimit apo ushtrimit, njësoj si gjithë të tjerët, të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në fushën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, civile apo në ndonjë fushë tjetër. Në këtë përkufizim përfshihen të gjitha format e diskriminimit, përfshirë edhe mohimin e përshtatjes së arsyeshme;

“Përshtatja e arsyeshme” do të thotë modifikim i nevojshëm dhe i duhur që nuk vendos ndonjë barrë shpërpjestimore apo të panevojshme, aty ku duhet në raste të veçanta, për t’u siguruar personave me aftësi të kufizuar gëzimin ose ushtrimin, në kushte të barabarta me të tjerët, e të gjitha të drejtave të njeriut dhe lirive themelore;

“Projektim universal” do të thotë projektim i produkteve, mjedisit, programeve dhe shërbimeve që të jenë të përdorshme nga të gjithë njerëzit, sa më shumë që të jetë e mundur, pa pasur nevojë për përshtatje ose konceptime të veçanta. “Projektimi universal” nuk duhet të përjashtojë pajisjet ndihmëse për grupe të veçanta të personave me aftësi të kufizuar, aty ku është e nevojshme.

Neni 4 - Detyrime të përgjithshme

1. Shtetet palë marrin përsipër të sigurojnë dhe nxisin realizimin e plotë të të gjitha të drejtave të njeriut dhe lirive themelore për të gjithë personat me aftësi të kufizuar, pa diskriminim të ndonjë lloji për shkak të aftësisë së kufizuar. Për këtë qëllim, shtetet palë marrin përsipër:

- (a) të miratojnë të gjitha masat e duhura legjislative, administrative dhe masa të tjera për zbatimin e të drejtave të njohura nga kjo Konventë;
- (b) të marrin të gjitha masat e duhura, përfshirë edhe ato legjislative, për të ndryshuar apo shfuqizuar ligjet, rregulloret, zakonet dhe praktikat ekzistuese të cilat kanë përmbajtje diskriminuese ndaj personave me aftësi të kufizuar;...
- (d) të mos marrin pjesë në veprime apo praktika që nuk janë në përputhje me këtë Konventë, dhe të sigurojnë që autoritetet dhe institucionet publike veprojnë në përputhje me këtë Konventë;...

- (f) të ndërmarrin apo të nxisin punën kërkimore dhe zhvillimin e mallrave, shërbimeve, pajisjeve dhe lehtësive të projektuara në mënyrë të universale, sipas përcaktimit të nenit 2 të kësaj Konvente, që kërkojnë përshtatjet më minimale të mundshme dhe me koston më të ulët për të plotësuar nevojat specifike të personave me aftësi të kufizuara, për të nxitur disponueshmërinë dhe përdorimin e tyre, si edhe për të nxitur përdorimin e projektimit universal në hartimin e standardeve dhe udhëzimeve;
- (g) të ndërmarrin apo të nxisin punën kërkimore dhe zhvillimin, si dhe të promovojnë disponueshmërinë dhe përdorimin e teknologjive të reja, përfshirë edhe teknologjitë e informacionit dhe komunikimit, mjetet ndihmëse lëvizëse, pajisjet dhe teknologjitë mbështetëse, të cilat u vijnë në ndihmë personave me aftësi të kufizuara, duke iu dhënë përparësi teknologjive me kosto të përballueshme;
- (h) t'u sigurojnë personave me aftësi të kufizuara akses ndaj informacionit lidhur me mjetet ndihmëse lëvizëse, pajisjet dhe teknologjitë ndihmëse, përfshirë edhe teknologjitë e reja, si dhe forma të tjera asistence, shërbimesh dhe lehtësirash mbështetëse;
- (i) të përmirësojnë trajnimin e profesionistëve dhe stafit, që punon me personat me aftësi të kufizuara lidhur me të drejtat që njeh kjo Konventë, me qëllim që asistenca dhe shërbimet e garantuara nga këto të drejta të sigurohen më mirë.

3. Në zhvillimin dhe zbatimin e legjislacionit dhe politikave për zbatimin e kësaj Konvente, si dhe për proceset e tjera vendimmarrëse në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me personat me aftësi të kufizuara, shtetet palë duhet të konsultohen nga afër me dhe të përfshijnë në mënyrë aktive personat me aftësi të kufizuara, përfshirë edhe fëmijët me aftësi të kufizuara, nëpërmjet organizatave të tyre përfaqësuese.

Neni 5 - Barazia dhe mosdiskriminimi

1. Shtetet palë pranojnë se të gjithë personat janë të barabartë përpara ligjit dhe se gëzojnë të drejtë pa asnjë diskriminim për mbrojtje dhe përfitim të barabartë nga ligji.
2. Shtetet palë duhet të ndalojnë çdo lloj diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar dhe t'u garantojnë personave me aftësi të kufizuara mbrojtje ligjore të barabartë dhe efektive ndaj diskriminimit të çdo lloj forme.
3. Me qëllim nxitjen e barazisë dhe eliminimin e diskriminimit, shtetet palë duhet të ndërmarrin të gjitha hapat e duhura për t'u siguruar se është ofruar përshtatja e arsyeshme.
4. Masat specifike të cilat janë të nevojshme për të përshpejtuar apo arritur, de facto, barazinë e personave me aftësi të kufizuara, nuk do të konsiderohen diskriminim sipas përcaktimeve të kësaj Konvente.

Neni 6 - Gratë me aftësi të kufizuara

1. Shtetet palë pranojnë se gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara janë objekt i një diskriminimi shumëformësh, dhe për këtë arsye do të marrin masa për t'u siguruar se ato gëzojnë në mënyrë të plotë dhe të barabartë të gjitha të drejtat të njeriut dhe liritë themelore.
2. Shtetet palë duhet të marrin të gjitha masat e duhura për të siguruar zhvillimin, përparimin dhe fuqizimin e plotë të grave, me qëllim që t'u garantohet ushtrimi dhe gëzimi i të drejtave të njeriut dhe liritë themelore, të përcaktuara në këtë Konventë.

Neni 8 – Ndërgjegjësimi

1. Shtetet palë marrin përsipër të ndërmarrin masa të menjëhershme, efektive dhe të përshtatshme:

- (a) për të rritur ndërgjegjësimin e shoqërisë, përfshirë edhe brenda familjes, lidhur me personat me aftësi të kufizuara, dhe të nxisin respektimin për të drejtat dhe dinjitetin e personave me aftësi të kufizuara;
- (b) për të luftuar stereotipat, paragjykimet dhe praktikat e dëmshme lidhur me personat me aftësi të kufizuara, përfshirë dhe ato për shkak të gjinisë dhe moshës, në të gjitha fushat e jetës;
- (c) për të nxitur rritjen e ndërgjegjësit lidhur me aftësitë dhe kontributin e personave me aftësi të kufizuara.

2. Masat për këtë qëllim përfshijnë:

- (a) ndërmarrjen dhe zhvillimin e fushatave efektive për ndërgjegjësimin e publikut me qëllim:
 - (i) përmirësimin e botëkuptimit në lidhje me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara;
 - (ii) nxitjen e perceptimit pozitiv dhe një ndërgjegjësimi më të madh të shoqërisë ndaj personave me aftësi të kufizuara;
 - (iii) promovimin e njohjes së aftësive, meritave dhe mundësive të personave me aftësi të kufizuara, si edhe të kontributeve të tyre në vendin e punës dhe tregun e punës;
- (b) nxitjen e mendësisë së respektit për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha nivelet e sistemit arsimor, përfshirë edhe tek të gjithë fëmijët që në moshë të hershme;
- (c) nxitjen e të gjitha organeve të mediave për të portretizuar personat me aftësi të kufizuara në mënyrë të tillë që të jetë në pajtim me këtë Konventë;
- (d) nxitjen e programeve të trajnimit në lidhje me rritjen e ndërgjegjësit për sa u takon personave me aftësi të kufizuara dhe të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.

Neni 9 - Aksesi

1. Me qëllim që të gjithë personat me aftësi të kufizuara të mund të jetojnë në mënyrë të pavarur dhe të marrin pjesë plotësisht në të gjitha aspektet e jetës, shtetet palë do të marrin masat e duhura për të siguruar që personat me aftësi të kufizuara, ashtu si gjithë të tjerët, të kenë akses në ambientet fizike, ndaj transportit, informacionit dhe komunikimit, përfshirë edhe teknologjitë dhe sistemet e informacionit dhe komunikimit, si dhe ndaj lehtësive apo shërbimeve të tjera të hapura apo të ofruara për publikun, si në zonat urbane ashtu edhe në ato rurale. Këto masa, të cilat do të përfshijnë evidentimin dhe eliminimin e pengesave dhe barrierave ndaj aksesit, do të zbatohen, ndër të tjera:

- (a) në ndërtesa, rrugë, transport dhe në ambiente të tjera të brendshme apo të jashtme, përfshirë dhe shkollat, strehimin, qendrat shëndetësore dhe mjediset e punës;
- (b) në informacion, komunikim dhe shërbime të tjera, përfshirë dhe shërbimet elektronike dhe ato të urgjencës.

2. Gjithashtu, shtetet palë duhet të marrin masat e duhura:
 - (a) për të zhvilluar, miratuar dhe monitoruar zbatimin e udhëzimeve dhe standardeve minimale në lidhje me aksesin ndaj lehtësive dhe shërbimeve të hapura apo të ofruara për publikun;
 - (b) për t'u siguruar që subjektet private, të cilat ofrojnë lehtësi dhe shërbime të hapura apo të ofruara për publikun, të marrin parasysh të gjitha aspektet e aksesit për personat me aftësi të kufizuara;
 - (c) për të ofruar trajnim për aktorët e interesit lidhur me problemet që kanë të bëjnë me aksesin për personat me aftësi të kufizuara;
 - (d) për t'u siguruar që ndërtesat dhe objektet e tjera publike të përmbajnë shenja në alfabetin Braille dhe në forma lehtësisht të lexueshme dhe të kuptueshme;
 - (e) për të siguruar forma asistence direkte dhe të ndërmjetme, përfshirë edhe guida, lexues dhe interpretë profesionistë të gjuhës së shenjave, për të mundësuar aksesin në ndërtesa dhe objekte të tjera të hapura për publikun;
 - (f) për të inkurajuar forma të tjera të përshtatshme të asistencës dhe mbështetjes për personat me aftësi të kufizuara, për t'u siguruar atyre akses ndaj informacionit;
 - (g) për të nxitur aksesin e personave me aftësi të kufizuara ndaj informacioneve të reja dhe sistemeve të teknologjive e reja të komunikimit, përfshirë dhe internetin;
 - (h) për të promovuar projektimin, zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e teknologjive dhe sistemeve të aksesueshme të informacionit dhe komunikimit në një fazë të hershme, në mënyrë që këto teknologji dhe sisteme të bëhen të aksesueshme me një kosto minimale.

Neni 12 - Njohje e barabartë përpara ligjit

1. Shtetet palë riafirmojnë se personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtën e njohjes kudo si persona përpara ligjit.
2. Shtetet palë pranojnë që personat me aftësi të kufizuara gëzojnë zotësinë juridike njësoj si pjesa tjetër e popullsisë në të gjitha aspektet e jetës.
3. Shtetet palë do të marrin masat e duhura për t'u siguruar personave me aftësi të kufizuara akses në lidhje me mbështetjen që ata mund të kërkojnë në ushtrimin e zotësisë së tyre juridike.
4. Shtetet palë duhet të sigurohen që të gjitha veprimet që lidhen me ushtrimin e zotësisë juridike, të parashikojnë masa mbrojtëse të përshtatshme dhe efikase për të parandaluar abuzimin, në përputhje me legjislacionin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut. Këto masa mbrojtëse do të bëjnë të mundur që masat që lidhen me ushtrimin e zotësisë juridike të respektojnë të drejtat, vullnetin dhe preferencat e personit, të mos kenë konflikt interesi dhe ndikim të panevojshëm, të jenë në proporcion dhe t'u përshtaten rrethanave të personit, të zbatohen brenda periudhës më të shkurtër të mundshme dhe të jenë objekt i shqyrtimit të rregullt nga një autoritet kompetent, i pavarur dhe i paanshëm apo një organ gjyqësor. Masat mbrojtëse duhet të jenë në përputhje me shkallën në të cilën këto masa cenojnë të drejtat dhe interesat e personit.

Neni 13 - Aksesit në organet e drejtësisë

1. Shtetet palë duhet të sigurojnë akses efektiv në organet e drejtësisë për personat me aftësi të kufizuar njësoj si pjesa tjetër e popullsisë, përfshirë edhe përshtatshmëri procedurale dhe sipas përkatësisë së moshës, me qëllim lehtësimin e rolit të tyre si pjesëmarrës të drejtpërdrejtë dhe jo të drejtpërdrejtë, përfshirë edhe në rolin e dëshmitarit, në të gjitha procedurat ligjore, përfshirë edhe fazat hetimore dhe faza të tjera paraprake.

Neni 19 – Jetesa e pavarur dhe përfshirja në komunitet

Shtetet palë në këtë Konventë njohin të drejtën e barabartë të të gjithë personave me aftësi të kufizuar për të jetuar në komunitet, me zgjedhje të barabarta me të tjerët, dhe duhet të marrin masat e duhura dhe efektive për të bërë të mundur që personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë plotësisht këtë të drejtë, si dhe përfshirjen e pjesëmarrjen e tyre të plotë në komunitet, përfshirë edhe duke u siguruar që:

- (a) Personat me aftësi të kufizuar të kenë mundësinë për të zgjedhur vendbanimin e tyre si dhe ku dhe me kë do të jetojnë, njësoj si të tjerët, dhe të mos jenë të detyruar të jetojnë në një mënyrë të veçantë jetese;
- (b) Personat me aftësi të kufizuar të kenë akses ndaj një game të gjerë shërbimesh mbështetëse në shtëpi, shërbimesh rezidenciale dhe shërbimesh të tjera në komunitetet, përfshirë dhe asistencën personale që është e nevojshme për të mbështetur të jetuarit dhe përfshirjen në komunitet, dhe për të parandaluar izolimin apo veçimin e tyre nga komuniteti;
- (c) Shërbimet dhe lehtësitë që ekzistojnë në komunitet për popullatën e përgjithshme duhet të jenë njëjloj të disponueshme edhe për personat me aftësi të kufizuar dhe t'u përgjigjen nevojave të tyre.

Neni 29 - Pjesëmarrja në jetën politike dhe publike

Shtetet palë duhet t'u garantojnë personave me aftësi të kufizuar të drejtat politike dhe mundësinë për t'i gëzuar ato njësoj si pjesa tjetër e popullsisë dhe duhet të marrin përsipër:

- (a) t'u garantojnë personave me aftësi të kufizuar pjesëmarrjen e plotë dhe efektive në jetën politike dhe publike, njësoj si gjithë të tjerët, drejtpërsëdrejti apo nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur, përfshirë edhe të drejtën dhe mundësinë e personave me aftësi të kufizuar për të votuar dhe për t'u zgjedhur, ndër të tjera:
 - (i) duke siguruar që procedurat, ambientet dhe materialet e votimit të jenë të përshtatshme, të aksesueshme dhe të thjeshta për t'u kuptuar dhe përdorur;
 - (ii) duke mbrojtur të drejtën e personave me aftësi të kufizuar për të votuar me votë të fshehtë në zgjedhje dhe referendume publike pa u ndikuar nga asnjë kërcënim dhe për të kandiduar në zgjedhje, për t'u zgjedhur në detyrë dhe për të ushtruar të gjitha funksionet publike në të gjitha nivelet e qeverisë, duke lehtësuar përdorimin e teknologjive ndihmëse dhe të reja, ne rastet e përshtatshme;
 - (iii) duke garantuar shprehjen e vullnetit të lirë të personave me aftësi të kufizuar si zgjedhës dhe për këtë qëllim, kur është e nevojshme, me kërkesën e tyre, duke lejuar ndihmën në votim nga një person i zgjedhur prej tyre;
- (b) garantimin në mënyrë aktive të një mjedisi në të cilin personat me aftësi të kufizuar mund të marrin pjesë në mënyrë efektive dhe të plotë në kryerjen e punëve publike, pa diskriminim dhe njësoj si të tjerët, dhe të inkurajojë pjesëmarrjen e tyre në çështjet publike, duke përfshirë:

- (i) pjesëmarrjen në organizatat joqeveritare dhe shoqatat, që kanë të bëjnë me jetën publike dhe politike në vend, dhe në aktivitetet dhe administrimin e partive politike;
- (ii) krijimin apo pjesëmarrjen në organizata të personave me aftësi të kufizuar për të përfaqësuar personat me aftësi të kufizuar në nivel ndërkombëtar, kombëtar, rajonal dhe vendor.

Neni 31 - Statistikat dhe grumbullimi i të dhënave

“1. Shtetet palë marrin përsipër të mbledhin informacionin e duhur, përfshirë edhe të dhëna statistikore dhe kërkimore, për të bërë të mundur që ato të hartojnë dhe zbatojnë politika për të vënë në jetë këtë Konventë. Procesi i mbledhjes dhe ruajtjes së këtij informacioni:

- (a) duhet të jetë në përputhje me masat mbrojtëse ligjore, përfshirë edhe ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, për të siguruar konfidencialitetin dhe respektimin e jetës private të personit me aftësi të kufizuar;
- (b) duhet të jetë në përputhje me normat ndërkombëtare të pranuar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, si edhe me parimet etike për mbledhjen dhe përdorimin e statistikave.

2. Informacioni i mbledhur sipas këtij neni do të ndahet në të dhëna, sipas rastit, dhe do të përdoret për t’u ardhur në ndihmë shteteve palë në vlerësimin e zbatimit të detyrimeve të tyre që rrjedhin nga Konventa, si edhe për të identifikuar dhe eliminuar pengesat me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuar gjatë ushtrimit të së drejtave të tyre.

3. Shtetet palë marrin përgjegjësinë për shpërndarjen e këtyre statistikave dhe sigurojnë që ato të jenë të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuar dhe nga të tjerët.”

Objektivat për zhvillimin e qëndrueshëm

Në nivel politik, Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm, të miratuara nga krerët e shteteve dhe qeverive në samitin e OKB-së në shtator 2015, përfshijnë referencën për aftësinë e kufizuar.⁷² Në lidhje me uljen e pabarazisë, Objektivat për Zhvillimin e Qëndrueshëm i kanë ngarkuar shtetet me angazhimin që “Deri në vitin 2030, të fuqizojnë dhe promovojnë përfshirjen sociale, ekonomike dhe politike të të gjithëve, pavarësisht... aftësisë së kufizuar...”. Në lidhje me promovimin e paqes, drejtësisë dhe institucioneve të fuqishme, një tregues është raporti i posteve në institucionet publike të mbajtura nga personat me aftësi të kufizuar në krahasim me atë të popullatës kombëtare.

Deklarata Interpretuese e Rishikuar e Komisionit të Venecias, 2011

Deklarata Interpretuese e Rishikuar e Komisionit të Venecias, 2011 “Për pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuar në zgjedhje”⁷³

I. KODI I PRAKTIKËS SË MIRË NË ÇËSHTJET ZGJEDHORE, i miratuar nga Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias) në tetor 2002, deklaroi se: “Pesë parimet në themel të trashëgimisë zgjedhore evropiane janë votimi i

⁷² (A/RES/70/1). Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm njihen zyrtarisht si “Transformimi i botës sonë: axhenda për zhvillim të qëndrueshëm 2030”.

⁷³ Gjetendet në: [http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2011\)045-e](http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2011)045-e).

përgjithshëm, i barabartë, i lirë, i fshehtë dhe i drejtpërdrejtë” (pika I). Më tej në pikën I. 1.1 Kodi shprehet se: “Votim i përgjithshëm do të thotë, në parim, që të gjithë njerëzit kanë të drejtë të zgjedhin dhe të zgjidhen”.

1. Prandaj personat me aftësi të kufizuar duhet të jenë në gjendje të ushtrojnë të drejtën e tyre për të votuar dhe për të marrë pjesë në jetën politike dhe publike si përfaqësues të zgjedhur në mënyrë të barabartë me shtetasit e tjerë. Pjesëmarrja e të gjithë shtetasve në jetën politike dhe publike dhe procesi demokratik është thelbësore për zhvillimin e shoqërive demokratike.

II. PJESA NË VIJIM PLOTËSON PARIMET E PËRCAKTUARA NË KËTË KOD

1. Karakteri i përgjithshëm i votës

2. Karakteri i përgjithshëm i votës është një parim themelor i Trashëgimisë Zgjedhore Evropiane. Në përputhje me nenin 29 të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar⁷⁴ dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, personat me aftësi të kufizuar nuk mund të diskriminohen në këtë drejtim.⁷⁵

3. Procedurat dhe qendrat e votimit duhet të jenë të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuar në mënyrë që ata të jenë në gjendje të ushtrojnë të drejtat e tyre demokratike, dhe të mundësojnë, sipas nevojës, ofrimin e ndihmës në votim, duke respektuar parimin se votimi duhet të jetë individual (Kodi, pika I. 4.b).

4. Zbatimi i parimeve të Projektimit Universal⁷⁶ dhe pjesëmarrja e drejtpërdrejtë dhe/ose jo e drejtpërdrejtë e përdoruesit në të gjitha fazat e projektimit, janë mjete efektive për përmirësimin e aksesueshmërisë së qendrave të votimit dhe procedurave zgjedhore për hedhjen e votës dhe për sigurimin e aksesit ndaj informacionit mbi zgjedhjet.

2. Barazia e votës

5. Parimi që “midis partive dhe kandidatëve duhet të krijohen shanse të barabarta” (Kodi, pika I. 2.3.a). Zbatimi i këtij parimi duhet të shtrihet për të përfshirë barazinë e mundësisë për personat me aftësi të kufizuar të cilët konkurrojnë në zgjedhje.

3. Liria e votës

6. Si detyrim për “t’u mundësuar zgjedhësve njohjen me listat dhe kandidatët për zgjedhje” (Kodi, pika I. 3.1.b.ii), autoritetet publike duhet të marrin masa që informacioni i mësipërm të jetë i disponueshëm dhe i aksesueshëm, në masën më të madhe të mundshme dhe

74 Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar u miratua nga Kombet e Bashkuara, në Nju Jork, më 13 dhjetor 2006.

75 Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në çështjen “Kiss kundër Hungarisë”, kërkesa nr. 38832/06, vendimi gjyqësor i datës 20 maj 2010. Shih, në veçanti, paragrafët 43-44, me referim ndaj nenit 29 të Konventës së OKB-së.

76 Rekomandimi CM/Rec (2009) 8 i Komitetit të Ministrave i Shteteve Anëtare për arritjen e pjesëmarrjes së plotë përmes Projektimit Universal: Projektimi Universal është një strategji që synon t’i bëjë projektimin dhe përbërjen e mjediseve të ndryshme, produktet, komunikimin, teknologjinë e informacionit dhe shërbimet të arritshme dhe të kuptueshme, si dhe të përdorshme për çdokënd, sa më shumë që të jetë e mundur, në mënyrën më të pavarur dhe më të natyrshme që të jetë e mundshme, në rastin më të mirë pa nevojën për të bërë përshtatje ose zgjidhje të veçanta. Termat “projektim për të gjithë”, “aksesueshmëri integrale”, “projektim i aksesueshëm”, “projektim përfshirës”, “projektim pa pengesa”, “projektim me vlerë për shumë breza” dhe “aksesueshmëri për të gjithë” konsiderohen që përkojnë me termin “Projektim Universal” që përdoret në këtë tekst.

duke marrë në konsideratë parimin e përshtatjes së arsyeshme,⁷⁷ në të gjitha formatet alternative të nevojshme në bazë të kufizimit të kompensueshmërisë, rregullimit ligjor dhe realizueshmërisë konkrete. Informacioni i dhënë duhet të jetë lehtësisht i lexueshëm dhe i kuptueshëm.

4. Fshehtësia e votës

7. E drejta e personave me aftësi të kufizuar për të votuar në fshehtësi duhet të jetë e mbrojtur, ndër të tjera, duke “garantuar shprehjen e lirë të vullnetit të personave me aftësi të kufizuar si zgjedhës dhe, për këtë qëllim, sipas nevojës, me kërkesë të tyre, duke i lejuar ata të përdorin teknologji ndihmëse dhe/ose të ndihmohen në votim nga një person i zgjedhur prej tyre,⁷⁸ ” në kushte ku garantohet se personi i zgjedhur nuk ushtron ndikim të paligjshëm.

77 Neni 2 - Përkufizimet e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara; “përshtatje e arsyeshme” do të thotë çdo modifikim dhe rregullim i nevojshëm dhe i duhur, që nuk vendos asnjë barrë të tepruar apo të panevojshme, për t’u siguruar personave me aftësi të kufizuar gëzimin apo ushtrimin, në kushte të barabarta me të tjerët, e të gjitha të drejtave të njeriut dhe lirive themelore.

78 (Neni 29 (iii) i Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara; krahaso pikën II.2 sipër dhe Kodin, pika I. 4. b).

Shtojca C – Burime të dobishme

Në këtë shtojcë faqet e internetit ndahen në:

1. Dokumente ligjore dhe të politikave
2. Hulumtime
3. Faqe dhe materiale burimore
4. Organizata përkatëse

1. Dokumente ligjore dhe të politikave

“Qasje ndaj të dhënave e bazuar në të drejtat e njeriut, duke mos lënë askënd pas në axhendën e zhvillimit të vitit 2030”, Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut, 2016.

<http://www.ohchr.org/Documents/Issues/HRIndicators/GuidanceNoteonApproachtoData.pdf>

Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar

<http://www.ohchr.org/EN/HRBodies/CRPD/Pages/ConventionRightsPersonsWithDisabilities.aspx>

Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

<http://www.ohchr.org/EN/HRBodies/CRPD/Pages/CRPDIndex.aspx>

Strategjia e Këshillit të Evropës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar për periudhën 2017-2023

<https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016806fe7d4>

Rezoluta 2155 (2017) e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës “Për të drejtat politike të personave me aftësi të kufizuar: çështje demokratike” dhe raporti i Komitetit për Barazinë dhe Mosdiskriminimin i Asamblesë Parlamentare (Dok. 14268), 2017.

<http://assembly.coe.int/nw/xml/XRef/Xref-DocDetails-EN.asp?FileID=23491&lang=EN>

Rekomandimi CM/Rec (2011)14 i Komitetit të Ministrave për Shtetet Anëtare “Për pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuar në jetën politike dhe publike”.

https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=09000016805b150c

Strategjia evropiane e BE-së për personat me aftësi të kufizuar 2010-2020.

<http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52010DCo636&from=en>

Direktiva e BE-së për aksesueshmërinë e faqeve të internetit dhe aplikacioneve celulare të organeve të sektorit publik (Direktiva për internetin).

<http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:32016L2102>

Rezoluta e parlamentit evropian “Gjuha e shenjave dhe interpretët profesionistë të gjuhës së shenjave”, 23 nëntor 2016 (2016/2952[RSP]).

<http://www.europarl.europa.eu/sides/getDoc.do?pubRef=-//EP//TEX-T+TA+P8-TA-2016-0442+0+DOC+XML+Vo//EN>.

“Treguesit e të drejtave të njeriut: udhëzues për vlerësimin dhe zbatimin”, Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut, 2012.

http://www.ohchr.org/Documents/Publications/Human_rights_indicators_en.pdf

“Monitorimi i Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar”, Udhëzues për Monitoruesit e të Drejtave të Njeriut, Seria nr. 17 e trajnimit profesional, ZKLDNJ, 2010.

http://www.ohchr.org/Documents/Publications/Disabilities_training_17EN.pdf

Komiteti i OSHA-së për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Personave me Aftësi të Kufizuar

http://www.oas.org/en/sedi/ddse/pages/index-4_committee.asp

Raport i Raportuesit të Posaçëm për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, 2016. Këshilli i OKB-së për të Drejtat e Njeriut.

http://www.ohchr.org/EN/HRBodies/HRC/RegularSessions/Session31/_layouts/15/Öopi-Frame.aspx?sourcedoc=/EN/HRBodies/HRC/RegularSessions/Session31/Documents/A_HRC_31_62_E.doc&action=default&DefaultItemOpen=1

Paraqitje në studimin tematik të Zyrës së Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut “Mbi pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuar në jetën politike dhe publike”, Komisioneri i Lartë për të Drejtat e Njeriut, 2011.

<http://www.ohchr.org/EN/Issues/Disability/Pages/StudyPoliticalAndPublicLife.aspx>

Studimi tematik i Komisionerit të Lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut “Mbi pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuar në jetën politike dhe publike”, 2011.

http://www.ohchr.org/Documents/HRBodies/HRCouncil/RegularSession/Session19/A-HRC-19-36_en.pdf

Deklarata Interpretuese e Rishikuar e Komisionit të Venecias për Kodin e Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore mbi pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuar në zgjedhje, 2011

[http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=C-DL-AD\(2011\)045-e](http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=C-DL-AD(2011)045-e)

Udhëzime të Konsorciumit të WorldWideWeb për aksesin në internet

<http://www.w3.org/TR/WCAG20/>

2. Hulumtime

“Krimet për shkak të urrejtjes ndaj personave me aftësi të kufizuar”, Raportim mbi krimin për shkak të urrejtjes, OSBE/ODIHR, 2016.

<http://www.osce.org/odihr/290021>

“Promovimi i barazisë dhe mosdiskriminimit për personat me aftësi të kufizuar”, Këshilli i Evropës, 2017.

<https://edoc.coe.int/en/people-with-disabilities/7279-pdf-promoting-equality-and-non-discrimination-for-persons-with-disabilities.html>

“Studim mbi njohjen e barazisë përpara ligjit”, Këshilli i Evropës, 2017.

<https://edoc.coe.int/en/people-with-disabilities/7277-pdf-a-study-on-the-equal-recognition-before-the-law-contribution-towards-the-council-of-europe-strategy-on-the-rights-of-persons-with-disabilities.html>

“Pjesëmarrja politike e personave me aftësi të kufizuar në Evropë: të drejtat, aksesit dhe aktivizimi”, Priestley, Stickings, Loja, Grammenos, Lawson, Waddington dhe Fridriksdottir, 2016. “Studime për zgjedhjet” 42 (2016) 1-9, Elsevier.

“E drejta për pjesëmarrje politike e personave me aftësi të kufizuar”, Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore, 2014.

<http://fra.europa.eu/en/publication/2014/indicators-right-political-participation-people-disabilities>

Raport për aftësinë e kufizuar në botë, 2011

http://whqlibdoc.who.int/publications/2011/9789240685215_eng.pdf?ua=1

3. Faqe dhe materiale burimore

ACE, Rrjeti i Njohurive Zgjedhore, Fokusi mbi Zgjedhjet dhe Aftësinë e Kufizuar

<http://aceproject.org/ace-en/focus/disability/about>

DOTCOM: mjet online mbi aftësinë e kufizuar i Komisionit Evropian

<http://www.disability-europe.net/dotcom>

Election Access, i menaxhuar nga Fondacioni Ndërkombëtar për Sistemet Zgjedhore (IFES).

<http://www.electionaccess.org/en/>

“Akses i barabartë: si të përfshihen personat me aftësi të kufizuar në zgjedhje dhe procese politike”, IFES dhe Instituti Kombëtar Demokratik (NDI) 2014.

http://www.ifes.org/~media/Files/Publications/Books/2014/Equal%20Access_How%20to%20include%20persons%20with%20disabilities%20in%20elections%20and%20political%20processes.pdf

4. Organizata përkatëse

AGENDA – Rrjeti i përgjithshëm zgjedhor për aksesin e personave me aftësi të kufizuar

<http://www2.agendaasia.org/index.php/homepage>

Këshilli Ndërkombëtar për Aftësinë e Kufizuar

<http://disabilitycouncilinternational.org>

Forumi Evropian për Aftësinë e Kufizuar

<http://www.edf-feph.org>

Inclusion Europe

<http://inclusion-europe.eu>

Aleanca Ndërkombëtare për Aftësinë e Kufizuar

<http://www.internationaldisabilityalliance.org>

Qendra e Mbrojtjes së Aftësisë së Kufizuar Mendore

<http://mdac.info/en>

Shtojca D – Përkufizime të termave kyç

Kjo bazohet në përkufizimin e termave tek “Akses i barabartë: si të përfshihen personat me aftësi të kufizuara në zgjedhje dhe procese politike”, IFES dhe NDI, 2014.⁷⁹

Termi	Përkufizimi	Shembull(j)
I aksesueshëm	Një vend, objekt, ambient pune, shërbim ose program që është i lehtë për t’iu qasur, për të hyrë, vepruar, marrë pjesë dhe/ose për t’u përdorur në mënyrë të sigurt, të pavarur dhe me dinjitet nga ana e personave me aftësi të kufizuara.	Qendër votimi ku zgjedhësi me aftësi të kufizuara fizike mund të manovrojë pa ndihmë.
Formate të aksesueshme	Informacion i printuar, në audio ose vizual që është i përdorshëm nga personat me aftësi të kufizuara.	Formatet në alfabetin Braille, me relief (të printuara me termoform), me shkrim me shkronja të zmadhuara, në gjuhën e shenjave dhe ato lehtësisht të lexueshme.
Mjet ndihmës	Pajisje që ndihmon në kryerjen e një detyre apo funksioni tjetër, pa ndihmën e së cilës kjo gjë mund të jetë e vështirë ose e pamundur.	Shablloni me prekje (i printuar me profil) ose lupa për votim.
Alfabeti Braille	Sistem shkrimi i përbërë nga pika në relief të ngritur, që përdoren nga persona që janë të verbër ose kanë shikim të dobët.	[Duhet figura]
Shabllon në alfabetin Braille për votim ose shabllon me relief (i printuar me termoform)	Dosje ku mund të vendoset fleta e votimit, që përdorin simbole të alfabetit Braille ose simbole me prekje për të identifikuar kandidatët/partitë.	
Organizatë e personave me aftësi të kufizuara	Organizatë e shoqërisë civile, që drejtohet nga personat me aftësi të kufizuara dhe i shërben atyre.	

79 “Akses i barabartë: si të përfshihen personat me aftësi të kufizuara në zgjedhje dhe procese politike”, IFES dhe NDI, 2014. Gjetet në: http://www.ifes.org/~media/Files/Publications/Books/2014/Equal%20Access_How%20to%20include%20persons%20with%20disabilities%20in%20elections%20and%20political%20processes.pdf.

Lehtësisht i lexueshëm	Tekst në të cilin përmbajtja, gjuha, ilustrimet dhe paraqitja grafike janë thjeshtuar për lehtësi përdorimi nga ana e personave me aftësi të kufizuar intelektuale dhe/ose folës jovendas të një gjuhe.	Rekomandimet e Inclusion Europe për zgjedhje të aksesueshme në Evropë.
Përfshirja	Procesi përmes së cilit personat me aftësi të kufizuar përfshihen në të gjitha veprimtaritë zgjedhore në kushte të barabarta me shtetasit e tjerë, përfshirë edhe pozicionet udhëheqëse, dhe jo vetëm sigurimin e përshtatshmërisë, që mund t'i ndajë personat me aftësi të kufizuar nga shtetasit e tjerë.	Përveçse të ketë një kuti të lëvizshme votimi dhe fletë votimi që dërgohen në shtëpinë e zgjedhësit, qendra e votimit duhet të jetë gjithashtu e aksesueshme, në mënyrë që zgjedhësi të ketë mundësi të votojë në të njëjtin vend si shtetasit e tjerë, nëse ai/ajo e dëshiron këtë gjë.
Aftësi e kufizuar intelektuale apo aftësi e kufizuar në mësimnxënje	Term që përdoret kur ka kufizime në aftësinë e personit për të mësuar në një nivel të pritshëm dhe për të funksionuar në jetën e përditshme.	Sindroma Down ose autizmi.
Integrimi	Procesi përmes së cilit personat me aftësi të kufizuar integrohen si pjesëmarrës dhe udhëheqës të barabartë në programet e ndihmës dhe në shoqëri.	Hartimi i një njoftimi për shërbimin publik që përfshin aktorë me aftësi të kufizuar në reklama televizive.
Aftësia e kufizuar psikosociale ose probleme të shëndetit mendor	Sëmundje që prekin njohjen, emocionet dhe sjelljen.	Depresioni ose skizofrenia.
Përshtatje e arsyeshme	Sigurimi i materialeve apo i mjedisit që i mundëson një personi me aftësi të kufizuar të marrë pjesë dhe të kontribuojë në baza të barabarta me të tjerët. Përshtatja e arsyeshme kërkon një qasje më të personalizuar sesa projektimi universal.	Shablloni me relief (i printuar me termoform), është një përshtatje e arsyeshme, pasi ai u jep votuesve që janë të verbër apo kanë shikim të dobët të njëjtën mundësi për të votuar në fshehtësi dhe pa ndihmë.
Dëmtim/aftësi e kufizuar shqisore	Përfshin humbjen e shikimit (përfshirë verbërinë dhe humbjen e pjesshme të shikimit), humbjen e dëgjimit (përfshirë të gjitha shkallët) dhe dëmtimin e shumë shqisave (që do të thotë të pasurit e një dëmtimi të diagnostikuar të shikimit dhe dëgjimit, me të paktën një humbje të lehtë në secilën prej tyre).	Humbja e shikimit apo e dëgjimit.

Shabllon me prekje (i printuar me termoform)	Simbole në relief të ngritur që mund të përdoren në rastet ku personat nuk përdorin rrjedhshëm alfabetin Braille.	[Duhet figura]
Grupim ombrellë	Organizatë e personave me aftësi të kufizuar që përbëhet nga organizata anëtare të përqendruara në një lloj të veçantë të aftësisë së kufizuar apo grup personash me aftësi të kufizuar.	
Projektimi universal	Kur të gjitha ndërtesat, materialet dhe proceset janë konceptuar që në fillim që të jenë të aksesueshme si për persona me ashtu edhe pa aftësi të kufizuar.	Dhomë e fshehtë votimi e konceptuar për të qenë e Dhomë e fshehtë votimi e konceptuar për të qenë e aksesueshme nga të gjithë.

Parimet kyç për vëzhguesit e ODIHR-it

- Pjesëmarrja e plotë dhe efektive e personave me aftësi të kufizuar përbën një komponent thelbësor të angazhimeve të OSBE-së dhe standardeve ndërkombëtare, duke pasqyruar të drejtën universale dhe të barabartë të votës. Barazia dhe mosdiskriminimi janë parime themelore për pjesëmarrjen politike dhe pjesëmarrjen në zgjedhje të personave me aftësi të kufizuar.
- Personat me aftësi të kufizuar nuk duhet të konsiderohen si një grup homogjen. Personat me aftësi të kufizuar të ndryshme kanë nevoja të ndryshme dhe mund të kenë nevojë për forma të ndryshme ndihme dhe mbështetjeje.
- Organizatat e personave me aftësi të kufizuar duhen konsultuar ngushtësisht dhe të përfshihen aktivisht në hartimin dhe zbatimin e legjislacionit dhe të politikave.
- Është e papranueshme të hiqet dhe/ose të kufizohet e drejta për të votuar apo kandiduar për shkak të çfarëdo lloj aftësie të kufizuar, përfshirë edhe aftësitë e kufizuar intelektuale dhe psikosociale.
- Vendimmarrje e asistuar do të thotë që një person mund të marrë ndihmën e nevojshme për të marrë vendime të caktuara në jetë, përfshirë edhe ushtrimin e të drejtës së votës. Këto mekanizma duhet të zëvendësojnë mekanizmat e vendimmarrjes me zëvendësim, duke iu dhënë personave me aftësi të kufizuar mbështetjen e nevojshme për ushtrimin e të drejtave të tyre të pjesëmarrjes në zgjedhje dhe në politikë pa asnjë kufizim të panevojshëm.
- Informacioni kryesor për zgjedhjet duhet të vihet në dispozicion në formate të shumëllojshme dhe të aksesueshme, të cilat mund të përfshijnë shkrimin në alfabetin Braille, tekstet me shkronja të mëdha, në audio, versione lehtësisht të kuptueshme dhe gjuhën e shenjave. Këtu përfshihen informacionet rreth mënyrës se si mund të merret pjesë në zgjedhje, si paraqiten ankimet dhe apeli, si dhe rreth rezultateve dhe përditësimeve nga administrata zgjedhore.
- Fushata zgjedhore duhet të jetë e aksesueshme për personat me të gjitha llojet e aftësive të kufizuar. Duhet të bëhen përpjekje që aktivitetet e fushatës zgjedhore dhe materialet zgjedhore të jenë të disponueshme për të gjithë. Mediat publike duhet të sigurojnë akses të barabartë ndaj informacionit dhe mundësi të barabarta për dhënien e mesazheve për personat me aftësi të kufizuar.
- Të gjitha proceset zgjedhore duhet të bëhen të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuar. Kjo kërkon "projektim universal", me anë të të cilit mjediset dhe shërbimet bëhen të aksesueshme në mënyrë proaktive për të gjithë njerëzit, sa më shumë që të jetë e mundur, pa qenë nevoja për rregullime. Gjithashtu, kjo kërkon që të bëhen "përshtatje të arsyeshme" për nevoja të veçanta që nuk mundësohen nga projektimi universal, për t'u siguruar personave me aftësi të kufizuar mundësinë që t'i ushtrojnë të drejtat e tyre njësoj si të tjerët.
- Personat me aftësi të kufizuar duhet të kenë mundësinë ta hedhin votën e tyre pa ndihmë, ose me ndihmën e një personi të zgjedhur prej tyre, në fshehtësi dhe në qendrat e zakonshme të votimit. Vetëm nëse kjo nuk është e mundur, duhet të shihet mundësia e metodave alternative të votimit, si votimi i lëvizshëm ose votimi me postë. Metodot alternative nuk duhet të promovohen si zëvendësuese të masave për përmirësimin e aksesueshmërisë në qendrat e votimit, dhe nëse përdoren, duhet të parashikohen garancitë e nevojshme.
- Në ditën e zgjedhjeve, vëzhguesit duhet të shqyrtojnë nëse informacioni është i disponueshëm në formate të shumëllojshme, nëse qendrat e votimit janë fizikisht të aksesueshme, nëse disponohen mjete ndihmëse dhe nëse zgjedhësi mund të zgjedhë vetë se kush do ta ndihmojë. Akses fizik do të thotë që zgjedhësit me aftësi të kufizuar të mund të hyjnë në qendrën e votimit pa ndihmën e askujt, të mund të manovrojnë lehtësisht në të gjithë qendrën e votimit dhe të mund të shënojnë në fletën e votimit dhe të votojnë në fshehtësi dhe me dinjitet. Mjetet ndihmëse mund të përfshijnë shabllonet me prekje, shabllonet në alfabetin Braille dhe lupat.
- Të gjithë anëtarët e misioneve të ODIHR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve vlerësojnë përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar, përfshirë edhe përmes analizës së legjislacionit dhe praktikës përpara, gjatë dhe pas ditës së zgjedhjeve.
- ODIHR-i nxit pjesëmarrjen efektive të personave me aftësi të kufizuar përmes vlerësimeve dhe rekomandimeve të tij për zgjedhjet, si dhe përmes përfshirjes aktive të organizatave të personave me aftësi të kufizuar në aktivitetet e tij paszgjedhore për mbështetjen e ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve.